

Projekt Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet

Për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, **Drin-Bunë 4, 5 dhe 6** (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës)

2023 – 2028

qershor 2022

TË DHËNAT E BOTIMIT

Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës), me periudhë implementimi 2023 – 2028

Qershor 2022

Përgatitur në kuadër të projektit: "Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike përmes menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në Ballkanin Perëndimor" zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH,

Në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)



Përgatitur nga përfaqësuesit qendrorë, rajonalë dhe vendorë



Mbështetur nga konsulentët:

INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner,
Darmstadt, Gjermani



Një publikim i realizuar me mbështetjen e Qeverisë Federale Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e aktorëve të përfshirë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ dhe të Qeverisë Federale Gjermane.

PARATHËNIE

Të nderuar kolegë, ekspertë të ujit dhe mjedisit si dhe palë interesi,

*Në vijim të **procesit të startuar**, në qershor - shtator të vitit 2021, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), së bashku me mbështetjen e Qeverisë Gjermane, përmes GIZ, ka hartuar Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësisë administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës)”*

Plani është hartuar në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet” dhe Direktivën e Bashkimit Evropian mbi Përmbytjet (Directive 2007/60/EC), dhe do të mbulojë periudhën 2023-2028, duke përcaktuar objektivat për rajonin e mbulimit në përputhje edhe me objektivat e Planit të Menaxhimit të Basenit ujq Drin-Bunë (miratuar me Vendimin nr.849, datë 4.11.2020 të Këshillit të Ministrave), duke mbajtur parasysh dokumentet e Vlerësimit Paraprak, hartat e Rrezikut dhe ato të Riskut, karakteristikat hidrolgjike, si edhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Objektivat kryesore të këtij dokumenti janë përmirësimi i kapaciteteve organizative dhe profesionale për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, parandalimi i rreziqeve të reja në zonat e rrezikuara nga përmbytjet, reduktimi i rreziqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmbytjet si dhe reduktimi i pasojave negative pas një ngjarjeje përmbytjeje, ku qëllimi kryesor është parandalimin dhe reduktimi i pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në zonat respektive.

Bazuar në VKM Nr.1015/2020, por edhe në vullnetin për të siguruar mbështetjen më të gjerë për politikën dhe për të rritur efikasitetin e përpjekjeve për zbatim, çdo anëtar i publikut mund të komentoj projektin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet brenda periudhës 6 mujore nga data e botimit.

Komentet mund të jenë në formë të shkruar ose elektronike dhe duhet t'i drejtohen AMBU-së.

Duke marrë parasysh sa më lart, do ta vlerësonim shumë përfshirjen tuaj, sipas fushës suaj të ekspertizës dhe njohurive, në identifikimin e çështjeve që ju i shihni të rëndësishme dhe në propozimin e masave të mundëshme për zgjidhjen e tyre, pasi mendimet dhe sugjerimet tuaja, konsiderohen si mjaft të vlefshme, pasi shprehin përkushtimin e secilit prej nesh, duke besuar që Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet do të zbatohet gjatë periudhës 2023-2028.

Drejtori i Përgjithshëm, AMBU

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbytjet janë fenomene natyrore të cilat nuk mund të parandalohen, të cilat kanë potencial për të shkaktuar fatkeqësi, zhvendosjen e njerëzve dhe dëmtimin e mjedisit dhe që rrezikojnë dhe dëmtojnë zhvillimet ekonomike.

Me synimin për të shmangur dhe reduktuar ndikimet negative të përmbytjeve është e nevojshme të hartohen dokumente planifikuese menaxhimi, në nivel baseni apo territoresh të një baseni ujor, dokumente këto që parashikojnë masat e nevojshme brenda sipërfaqeve që preken nga përmbytjet, për të garantuar sigurinë e njerëzve, gjësë së gjallë dhe të pronave duke trajtuar të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit, përfshirë parandalimin, mbrojtjen dhe gatishmërinë.

Direktiva 2007/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 Tetor 2007, “Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet” parashikon ngritjen e një kuadri për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, duke synuar zvogëlimin e pasojave negative për shëndetin njerëzor, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik që lidhet me përmbytjet në komunitet.

Direktiva nuk është detyruese për shtetet që nuk janë anëtare të BE-së, por është një standard gjerësisht i pranuar dhe kontribut për procesin e aderimit në BE, për rrjedhim Qeveria shqiptare ka përafuar Direktivën 2007/60/KE nëpërmjet miratimit të VKM-së nr. 1015, datë 16.12.2020, “Për Përmbytjen, Zhvillimin dhe Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet”.

Qasja tradicionale ishte mbrojtja e njerëzve, të mirave ekonomike dhe tokës bujqësore nga përmbytjet (që zakonisht dështon kur përmbytjet ekstreme kalojnë punimet mbrojtëse), ndërkohë qasja moderne e Direktivës është bashkëpunimi me të gjithë aktorët përkatës ndaj “jetës me përmbytjet” për tu mbrojtur duke përshtatur përdorimet dhe punimet ndaj rrezikut nga përmbytjet në zonat respektive dhe veçanërisht për tu përgatitur për përmbytjet me një qasje gjithëpërfshirëse me të gjithë njerëzit, organizatat, administratat dhe bizneset e prekura.

Referuar legjisllacionit në fuqi, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) në bashkëpunim me zyrat e administrimit të baseneve ujore harton planin/planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, të cilat fokusohen në parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë, përfshirë parashikimin e përmbytjeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm.

AMBU, me mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, nëpërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), në kuadër të projektit “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në Ballkanin Perëndimor”, së bashku me grupin ndërinstitucional të punës, hartoi Projektplanin e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësisve administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës (projekt-PMRP).

Projekti i zbatuar nga GIZ, me objektiv përforsimin e menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në lidhje me ndryshimet klimatike në Ballkanin perëndimor, kishte synim implementimin e Direktivës së Përmbytjeve të BE-së nëpërmjet forcimit të kapaciteteve vendore dhe kombëtare për të bërë vlerësime kuptimplota të rrezikut nga përmbytjet, për të prioritetuar vendimet teknike, financiare dhe politike në fushën e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, mbrojtjen civile dhe paralajmërimin e hershëm, nga e cila gjithashtu përfitojnë aktorët e tjerë dhe popullata në zonat e rrezikuara dhe forcon kapacitetet e tyre përshtatëse.

Projekti në fjalë ka filluar veprimtarinë e tij në nëntor 2018 dhe përfundon në korrik 2022, me finalizimin e mbështetjes për AMBU në paraqitjen e projekt-PMRP për miratim paraprak në Këshillin Kombëtar të Ujit.

Mbështetur në legjislacionin e zbatueshëm, projekt-PMRP i hartuar duhej dërguar për koordinim me institucionet qendrore pasi ai të ishte hartuar, ndërkohë AMBU vlerësojë se qasja më rezultative ishte hartimi i vetë dokumentit në bashkëpunim me këto institucione si dhe ente të tjera publike të cilat lidhen me fushën apo zotërojnë njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të kontribuar.

Për rrjedhim projekt-PMRP u hartua në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të krijuar me urdhrin nr. 75 prot., datë 10.09.2021 të Kryeministrit, në të cilin u përfshinë 35 anëtarë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale të specifikuar (ministri, agjenci qendrore dhe vendore) dhe 19 anëtarë të ftuar nga ente publike të cilat kontribuojnë në mbështetje (bashki, fakultete, institute, etj.).

OBJEKTIVI I PLANIT

Objektivi kryesor i PMRP është ngritja e nivelit aktual të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, duke u përqendruar veçanërisht në masat jo strukturore, si paralajmërimi, informimi, gatishmëria dhe planifikimi si dhe masat strukturore, të indentifikuara dhe parashikuara për zbatim në bashkëpunim me të gjithë aktorët përkatës përfshirë këtu edhe njerëzit, organizatat, administratat dhe bizneset.

Dokumenti i shërben institucioneve shtetërore, enteve publike e private për të menaxhuar në mënyrë të harmonizuar rrezikun nga përmbytjet dhe marrjen e masave efektive, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në zonat respektive.

Përpos objektivit të vetë dokumentit të PMRP, në proceset që kanë paraprirë hartimin e tij (vlerësimi paraprak i rrezikut, indentifikimi i zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, krijimi i hartave të rrezikut dhe riskut) kanë qënë në fokus dhe janë arritur edhe objektivat në lidhje me, rritjen e kapaciteteve vendore dhe kombëtare për të bërë vlerësime të rrezikut nga përmbytjet, rritjen e kapacitetit strategjik të institucioneve qendrore dhe lokale për të menaxhuar rrezikun nga përmbytjet, forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit dhe ndërveprimit të institucioneve, si edhe përforsimin e menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet

Proceset e ndjekura dhe dokumentet janë hartuar sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar, në përputhje me përcaktimet e Direktivës së BE-së, legjislacionit shqiptar dhe praktikave më të mira të referuara nga ekspertët e përfshirë në proces. Kjo qasje do të shërbejë si garanci që PMRP, i cili përfshin periudhën 6-vjecare (2023-2028), do të zbatohet dhe nëpërmjet zbatimit do të shmangë ose minimizojë pasojat që përmbytjet shkaktojnë.

Plani dhe më konkretisht plani masave që ai parashikon për zbatim, i shërben arritjes së objektivave kryesorë të përcaktuar:

- Përmirësimi i kapaciteteve organizative dhe profesionale për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet;
- Parandalimi i rreziqeve të reja në zonat e rrezikuara nga përmbytjet;
- Reduktimi i rreziqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmbytjet;
- Reduktimi i pasojave negative gjatë një ngjarjeje përmbytjeje;
- Reduktimi i pasojave negative pas një ngjarjeje përmbytjeje;

si edhe objektivave specifike në funksion të tyre.

PROCESI I HARTIMIT TË PROJEKT-PMRP, MIRATIMI DHE VËNIA NË ZBATIM

Procesi i përgatitjes së projekt-PMRP është realizuar i udhëhequr nga detyrimet e Direktivës të Përmbytjeve 2007/60/KE, si edhe përcaktimet e VKM-së nr. 1015/2020.

Hartimi i projekt-PMRP është paraprirë nga proceset dhe dokumentet e:

- Vlerësimi Paraprak i rrezikut nga përmbytjet dhe identifikimi i zonave me rrezikshmëri të miratuara me Vendimin nr.1, datë 15.6.2021 të KKKU;
- Me Vendimin nr.1, datë 15.06.2021 të Këshillit Kombëtar të Ujit është miratuar, ndër të tjera Raporti i Vlerësimi Paraprak të rreziqeve nga përmbytjet për Basenin Ujorë Drin-Bunës edhe janë shpallur 8 zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje në këtë basen;
- Hartave të rrezikut nga përmbytjet të miratuara me Vendimin nr.3, datë 15.6.2021 të KKKU-së; ndër të tjera edhe hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën e Shkodrës që korrespondon me disa nga zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje në Basenin Ujor Drin-Bunë.
- Hartave të riskut nga përmbytjet të cilat miratohen me vendim të KKKU-së;
- Krijimit të grupit ndërinstucional me urdhrin nr. 75 prot., datë 10.09.2021 të Kryeministrit;

Hartimi është realizuar duke mbajtur në konsideratë edhe objektivat e Planit të Menaxhimit të Basenit ujor Drin-Bunë (miratuar me Vendimin nr.849, datë 4.11.2020 të Këshillit të Ministrave).

Njëkohësisht, mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)” dhe Vendimit nr.219 datë 11.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimi strategjik mjedisor”, me ekspertizën e ofruar nga projekti, nëpërmjet GIZ, projekt-PMRP është plotësuar edhe me Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Plani i masave i parashikuar në projekt-PMRP, që për nga tipologjia e masave i është referuar katalogut të masave që lidhen me “Llojet e masave” të BE-së, është plotësuar dhe përshtatur nga aktorët dhe palët e interesuara duke iu referuar karakteristikave rajonale.

Këto produkte, së bashku me dokumentin e hartuar në vitin 2015 në lidhje me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet për qarkun e Shkodrës, ishin baza për përgatitjen e projekt-PMRP.

Projekt-PMRP është zhvilluar në një proces me pjesëmarrje të gjerë, me përfshirjen e institucioneve të përcaktuara në VKM nr.1015/2020, të cilat kontribuan sipas fushave të përgjegjesisë, bashkinë Shkodër, bashkinë Vau Dejës, universitetet, ekspertë ndërkombëtar, ekspertë lokal, përfaqësues të organizatave jo fitimprurëse dhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në fushën e menaxhimit të përmbytjeve.

PMRP është plani i parë, me të gjitha parametrat sipas kërkesave të Direktivës kuadër të Përmbytjeve, që do të zhvillohet dhe miratohet në Shqipëri dhe ai do të mund të shërbejë edhe si model për hartimin e planeve për basenet e tjera.

Dokumenti, pas miratimit paraprak në Këshillin Kombëtar të Ujit, do të publikohet për një periudhë 6 mujore, si edhe masat e përcaktuara në dokument për tu zbatuar, do të koordinohen me organet respektive të Malit të Zi për të përmbushur detyrimin e legjislacionit të zbatueshëm që në një plan të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet propozohet të përfshihen masa, që për nga shkalla dhe ndikimi i tyre, rrisin ndjeshëm rreziqet nga përmbytjet me drejtim nga lart ose poshtë të shteteve të tjera në të njëjtin basen ose nënbasen lumenjsh, AMBU-ja nuk duhet t'i përfshijë këto masa në planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet derisa këto masa të koordinohen me dhe të aprovohen nga shtetet e përfshira.

Në vijim të komenteve të cilat do të trajtohen dhe vlerësohen, do të hartohet Plani përfundimtar i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, për territorin në fjalë, i cili pas miratimit paraprak në Këshillin Kombëtar të Ujit do të miratohet në Këshillin e Ministrave dhe do të përcaktojë piketat në të cilat do të mbështetet menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet për periudhën 2023-2028.

Zbatimi i PMRP, do të monitorohet në vazhdimësi nga AMBU në lidhje me zbatimin e masave si dhe nivelin e arritjes së objektivave të PMRP, si dhe do të raportohet periodikisht në Këshillin Kombëtar të Ujit për ecurinë e zbatimit.

SFIDAT E HASURA DHE ATO QË PRITEN NË VIJIM

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria është përballur me situata përmbytjesh në disa territore por ndër ato me një rrezik më të madh janë zonat e nën-Shkodrës, të cilat janë përballur me pasoja negative për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.

Përmbytjet i kalojnë kufijtë institucionalë dhe administrative dhe për rrjedhim menaxhimi i rrezikut të tyre kërkon bashkëpunim dhe veprime të koordinuara dhe të harmonizuara ndërmjet të gjithë organeve përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në nivel lokal dhe qendror, por jo vetëm.

Ndonëse përgatitja e PMRP-së është përgjegjësi e AMBU-së dhe Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, proceset e ndjekura dhe hartimi i dokumentit kërkoi si domosdoshmëri përfshirjen e të gjitha palëve të interesit si edhe ekspertizën profesionale në fusha të ndryshme.

Pavarësisht se krijimi dhe funksionimi i një grupi ndërinstitucional u formalizua me urdhër të Kryeministrit, gjetja e mekanizmave funksionalë për bashkëpunim dhe koordinim ishte sfidë.

Me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara, me fokus reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, PMRP përmban masat që janë vlerësuar se do të ndikojnë në uljen e rrezikut dhe risqeve që vijnë nga përmbytjet në territorin e njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës.

Sfida kryesore për periudhën e implementimit 2023-2028 është niveli i zbatimit të masave të parashikuara në PMRP, zbatim i cili është përgjegjësi e intitucioneve qëndrore dhe lokale, respektivisht të përcaktuara për çdo masë të parashikuar. Sfida në vetvete përmban të gjithë elementët e vështirësive që parashikohet të hasen në parashikimin, detajimin dhe projektimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit, si dhe çka është më e rëndësishmja financimin.

Monitorimi i zbatimit të masave është një proces relativisht i thjeshtë, por kompleks dhe i vështirë është “përkthimi” i nivelit të zbatimit të masave në nivelin e përbushjes së objektivave kryesorë dhe specifik të cilat përgjithësisht ndërvaren nga niveli i plotësimit të disa masave njëkohësisht.

ÇFARË PLANI PËRMBAN

Si në të gjithë proceset e zbatuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6, edhe përmbajtja e planit është bazuar në përcaktimet e Direktivës 2007/60/KE dhe në përcaktimet e VKM-në nr. 1015/2020.

Projekt-PMRP, në mënyrë të përmbledhur përmban:

- Historikun dhe objektivat;
- Karakteristikat e zonës së projektit;
- Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet si dhe vlerësimin e rrezikut për zonën e projektit;
- Objektivat e përshtatshme për menaxhimin e rrezikut në përmbytje në zonë;
- Masat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet;
- Vlerësimi strategjik mjedisor;
- Aspektet e ndikimit ndërkufitar të menaxhimit të rrezikut;
- Koordinimi me Direktivën e BE;
- Informimin e publikut dhe publikimin e masave;
- Anekset:
 - o Katalogu i tipit të masave të BE;
 - o Lista e masave për zbatim/Plani veprimit;
 - o Sistemi i monitorimit të ndikimeve të rëndësishme mjedisore referuar VSM-së;
 - o Rekomandime dhe udhëzime për zbatimin e masave të PMRP referuar rekomandimeve të VSM-së;
 - o Hartat e rrezikut dhe te riskut.
- Tabelat dhe figurat që argumentojnë dhe plotësojnë kapitujt e projekt-PMRP.

PLANI I MASAVE PËR PERIUDHËN E ZBATIMIT 2023-2028

Plani i masave i projekt-PMRP-së, i cili i referohet tipologjisë së masave të përcaktuara në katalogun e masave të BE-së, është hartuar në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet qendrore dhe lokale të cilat kanë fushë të përgjegjësive të tyre komponentë të menaxhimit të përmbytjeve ose/edhe kanë përgjegjësinë, sipas sektorëve që administrojnë, zbatimin e këtyre masave.

Referuar tipologjisë masat janë grupuar në:

1. Aspekti: Parandalimi i rreziqeve.
 - 1.1 Instrumentet administrative për shmangien e risqeve;
 - 1.2 Përshtatja e përdorimit të tokës;
 - 1.3 Parandalimi i rrezikut me anë të ndërtimit të përshtatur për përmbytjen;
2. Aspekti: Mbrojtja Natyrore nga Përmbytjet
 - 2.1 Menaxhimi i përmbytjeve natyrore, rregullimi i rrjedhës së ujit;
3. Aspekti: Mbrojtja teknike nga përmbytjet.
 - 3.1 Rregullimi i rrjedhës së ujit / veprat në fushat aluvionale (masat mbajtëse);
 - 3.2 Rregullimi i rrjedhës së ujit / kanalet (pritat, digat, muret mbrojtëse ndaj përmbytjeve dhe mbrojtja e lëvizshme ndaj përmbytjeve);
 - 3.3 Rregullimi i rrjedhës së ujit / kanalet (masat në lumenj / drejtimin e lumit);
 - 3.4 Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore (Masat e menaxhimit të ujërave të ndotura urbane);
 - 3.5 Mbrojtja e objekteve / ndërtesave;
 - 3.6 Masat e tjera mbrojtëse;
4. Aspekti: Gatishmëria dhe informimi.
 - 4.1 Gatishmëria ekonomike / financiare;
 - 4.2 Gatishmëria informative;
 - 4.3 Gatishmëria në lidhje me sjelljen;
 - 4.4 Përgatitja dhe post-përpunimi i kontrollit të rrezikut.

Për shmangjen apo uljen e rrezikut nga përmbytjet, në teritorin e projektit, janë parashikuar gjithësej 128 masa nga të cilat 41 për parandalimin e rreziqeve, 24 për mbrojtja natyrore nga përmbytjet, 45 për mbrojtjen teknike nga përmbytjet dhe 18 për gatishmërinë dhe informimin.

Ndër 128 masat e parashikuara, 64 janë masa jo strukturore (direktiva e BE-së për përmbytjet i jep përparësi masave jostrukturore pasi ato janë më kosto-efektive), 60 janë masa strukturore (nga të cilat 19 janë masa të cilat kanë lidhje me pastrimin/sistemimin apo mirëmbajtjen e periodike të parashikuar nga sektorët përgjegjës), si dhe 4 masa kanë të ndërthurur komponentë strukturorë dhe jo strukturorë.

Në lidhje me aspektin e ndikimit ndërkuftar, 30 nga 128 masat janë konsideruar me ndikim të mundshëm ndërkuftar (2 me ndikim të mundshëm negativ, 12 me ndikim të mundshëm pozitiv dhe 16 me ndikim të papërcaktuar ose të ndërthurur).

LISTA E INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA

Aktorë të përfshirë në procesin e hartimit të projekt Planit për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet:

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (WRMA, <http://www.ambu.gov.al/>) **.

Të përfshirë në grupin ndërinstitucional të punës dhe/ose në takime në terren/në zonën e Shkodrës:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (<https://bujqesia.gov.al/>) **;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (<http://turizmi.gov.al/>) **;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (<https://www.infrastruktura.gov.al/>) **;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (<http://shendetesia.gov.al/>) **;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (<http://arsimi.gov.al/>) **;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (<https://www.mod.gov.al/>) **;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (<https://www.planifikimi.gov.al/>) **;
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit (<http://azht.gov.al/>) **;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar (<https://www.arrsh.gov.al/>) **;
- Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (<http://www.akum.gov.al/>) **;
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve (<http://turizmi.gov.al/>) **;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (<http://www.akm.gov.al/>) **;
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (<https://www.gsa.gov.al/>) **;
- Instituti i Shëndetit Publik (<http://www.ishp.gov.al/>) **;
- Instituti i Statistikave (<http://www.instat.gov.al/>) **;
- Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Buna **;
- Prefekti i Qarkut Shkodër (<https://prefektishkoder.gov.al/>) **;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër (<https://akzm.gov.al/>) **;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit (<https://www.albaniandf.org/>) **;
- Bashkia Shkodër (<http://www.bashkiaShkodër.gov.al/>) *;
- Bashkia Vau Dejes (<http://www.bashkiavaudejes.gov.al/>) *;
- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (<https://fin.edu.al/>) *;
- Universiteti Bujqësor i Tiranës; (<https://ubt.edu.al/>) *;
- Instituti i Gjeoshkencave (<https://www.geo.edu.al/>) *;
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (<https://www.fshn.edu.al/>) *;

- Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (<https://unishk.edu.al/universiteti/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-te-natyres/>) *;
- Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (<https://www.kesh.al/>) *;
- Komuniteti Kombëtar i Digave të Mëdha (<https://albcold.gov.al/>) *;
- Këshilli i Qarkut Shkodër (<https://qarkushkoder.gov.al/>);
- Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër (Ana e Malit; Berdicë; Dajç; Guri i Zi; Rrethinat; Shkodër; Velipojë);
- Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau i Dejes.

SHËNIM:

** - *institucionet e ngarkuara me Urdhër të Kryeministrit për të hartuar projekt-Planin.*

* - *institucionet mbështetëse dhe konsultuese në hartimin e projekt-Planit.*

LISTA E PJESËMARRËSVE KRYESORË NË PROCES

- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore:

Znj. Gerta Lubonja, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë

Z. Hermon Bonati, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Performancës

Z. Arduen Karagjozi, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik

Znj. Margarita Lutaj, Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Riskut dhe Mbrojtjes së Burimeve Ujore

Znj. Anisa Pashaj, Specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Riskut dhe Mbrojtjes së Burimeve Ujore

Z. Amarildo Guri, Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit dhe Inovacionit të Ujit

- Prefekti i Qarkut Shkodër:

Znj. Majlinda Angoni, Prefekte e Qarkut

Z. Pëllumb Dani, Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile

Z. Vehbi Gruda, Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban

- Këshilli i Qarkut Shkodër;

Z. Hilmi Lakti, Kryetar i Këshillit të Qarkut

- Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë:

Z. Sead Sadiku, Drejtor i Zyrës

- Bashkia Shkodër

Znj. Aida Shllaku, Drejtore Drejtorisë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

Z. Erkam Boriçi, Specialist Mjedisi

Z. Gjergji Nika, Specialist Mjedisi

- Bashkia Vau Dejes

Znj. Valjeta Nikaj, Përgjegjëse Sektorit të Emergjencave Civile

- Njësi Administrative Ana e Malit

Z. Arben Ceni, Administrator

- Njësi Administrative Berdicë

Z. Aleksander Pashuku, Administrator

- Njësi Administrative Dajç

Z. Gjovalin Darragjati, Administrator

- Njësi Administrative Guri i Zi

Z. Pjerin Marku, Administrator

- Njësi Administrative Rrethinat

Z. Erion Selgjakaj, Administrator

- Njësi Administrative Velipojë

Z. Altin Kaçi, Administrator

- Njësia Administrative Bushat

Znj. Nurije Celepija, Administratore

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Z. Arben Muka, Përgjegjës Sektori i Programeve dhe Administrimit të Ujitje Kullimit

Z. Çesk Lleshi, Përgjegjës i Sektorit Teknik

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Z. Ylli Hoxha, Përgjegjës Sektori i Pyjeve dhe Kullotave

Z. Ermal Halimi, Sektori i Programit të Mbrojtjes Mjedisore dhe Biodiversitetit

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Znj. Laureta Sinani, Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjetës Kanalizimeve

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Z. Benon Memaga, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Emergjencave Civile

- Ministria e Arsimit dhe Sportit

Znj. Arta Tani, Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Znj. Kristina Prishka, Sektori i Koordinimit Ndërinstit. dhe Zvogëlimit të Risqeve dhe Fatkeqësive

Z. Besmir Kullolli, Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional dhe Zvogëlimit të Risqeve dhe Fatkeqësive

Znj. Anisa Seferi, Sektori i Koordinimit Ndërinstitucional dhe Zvogëlimit të Risqeve dhe Fatkeqësive

- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Znj. Adelina Greca, Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Nensi Lalaj, Drejtore, Drejtorja e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor

Znj. Megelina Dajti, Përgjegjëse në Drejtorinë e GSI për Planifikimin e Territorit

- Agjencia e Zhvillimit të Territorit

Znj. Orlanda Karamuco, Drejtor, Drejtorja e Monitorimit të Zhvillimit të Territorit

Znj. Floralda Alimehmenti, Përgjegjëse në Sektorin e Legjislacionit

- Autoriteti Rrugor Shqiptar

Znj. Ariana Hasani, Sektori i Mirëmbajtjes së Rrugëve

Z. Fatbardh Sokoli, Sektori i Mirëmbajtjes së Rrugëve

- Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Z. Flauers Shoshi, Zëvendës Drejtor i Agjencisë

- Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Znj. Bilena Hyseni, Sektori i Gjendjes së Pyjeve, Ndërgjegjësimit dhe Promovimit

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Znj. Enkeleda Shkurta, Përgjegjëse e Sektorit të Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisore

- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Znj. Sonila Marku, Drejtore, Drejtorja e Hidrologjisë

- Instituti i Shëndetit Publik

Znj. Edjona Bici, Sektori i Ujit dhe Sanitetit

- Instituti Statistikave

Z. Ervin Shameti, Drejtor, Drejtorja e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit

Z. Denis Kristo, Drejtor, Drejtorja e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Z. Ledjo Seferkolli, Sektori i Gjeoinformacionit

- Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër

Z. Agim Dardha, Drejtor i Administratës së Zonave të Mbrojtura Qarku Shkodër

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Znj. Greta Gjonçaj, Përgjegjëse e Njesisë së Hartimit të Projekteve dhe Koordinimit të Marrëdhënieve me Donatorët

- Korporata Elektroenergjitike Shqiptare

Z. Orlando Muca, Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimeve Hidro-Meteorologjike

Znj. Desareta Gjeci, Sektori i Përgjegjshmërisë Sociale e Mjedisore

Z. Erjon Qosja, Sektori i Sigurisë së Digave

- Instituti i Gjeoshkencave

Z. Klodian Zaimi, Ekspert Hidrolog

- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Prof. Aleko Miho, ekspert i ekologjisë ujore

Prof. Aurel Nuro, ekspert për analizat e ndotësve organikë në matrica mjedisore

Prof. Sonila Vito, eksperte e trajtimit të ujërave të ndotur

Prof. Ferdinand Bego, ekspert për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin

Prof. Kludjo Peqini, ekspert për dinamikën e fluideve

- Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Znj. Aurora Dibra, eksperte në ekologji dhe mbrojtjen mjedisore, biodiversitetin dhe edukimin mjedisor

- Komuniteti Kombëtar i Digave të Mëdha

Z. Arjan Jovani, anëtar në Bordin e Komitetit

- Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar Deutsche (Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GIZ)

Z. Gerrit Bodenbender, Drejtori i Programit

Znj. Rrezearta Ago, Koordinatore Programi Shqipëri-Kosovë

Dr.-Ing. Peter Heiland, Ekspert në hartimin e projekt

Znj. Anna Goris, Eksperte në hartimin e projekt-PMRP

Znj. Hue Linh Tu, Eksperte në hartimin e projekt-PMRP

Znj. Fationa Sinojmeri, Këshilltare Teknike

Z. Arben Guraj, Ekspert Lokal

Z. Andrian Vaso, Ekspert për vlerësimin strategjik mjedisor

Znj. Gentiana Gjonca, Eksperte për analizën kosto-përfitim

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	XVII
LISTA E FIGURAVE	XVIII
LISTA E SHKURTESAVE / AKRONIMEVE	XX
1 Historiku dhe objektivat	1
1.1 Kuadri i direktivës evropiane për përmbytjet	1
1.2 Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional i Shqipërisë	4
1.3 Institucionet e përfshira për zhvillimin e planit MRP	8
1.4 Hapat e punës dhe metodat.....	10
2 Karakteristikat e zonës së projektit	14
2.1 Zona e projektit në basenin lumor Drin-Buna	14
2.2 Klima, hidrologjia dhe origjina e përmbytjeve	18
2.3 Përmbytje të konsiderueshme që kanë ndodhur në të shkuarën.....	23
2.4 Veprimet/investimet madhore për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në zonën e projektit.....	25
2.5 Ndikimi i ndryshimeve klimatike në rajon	28
2.6 Popullsia, shpërndarja gjinore, minoritetet dhe grupet e marginalizuara.....	30
2.7 Përdorimi i tokës dhe aktivitet ekonomike në zonën e projektit	32
2.8 Përdorimi i tokës dhe ndryshimet në përdorimin e tokës në basenin lumor...	33
2.9 Planifikimi i territorit në zonën ripariante të basenit lumor Drin-Bunë.....	36
2.10 Zonat e mbrojtura	41
3 Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet	44
3.1 Metodologjia	44
3.2 Llojet e konsideruara të përmbytjeve	46
3.3 Rëndësia e rrezikut nga përmbytjet.....	49
3.4 Rezultatet e VPRRP për zonën e projektit	50
4 Vlerësimi i rrezikut nga përmbytjet në zonën e projektit	52
4.1 Rëndësia e përmbytjeve të kaluara për të ardhmen.....	52
4.2 Hartat e rrezikut nga përmbytjet.....	53
4.3 Hartat e riskut nga përmbytjet.....	55
4.4 Përshkrimi dhe vlerësimi i rrezikut ekzistues nga përmbytjet.....	59
4.4.1. Përmbledhje:Përdorimi i tokës që preket potencialisht në zonën me risk	59

4.4.2. Shëndeti i njeriut	60
4.4.3. Mjedisi	65
4.4.4. Trashëgimia kulturore	67
4.4.5. Aktiviteti ekonomik	68
4.5 Rreziku nga përmbytjet nga hidrocentralet në zonën e projektit	72
5 Objektivat e duhura për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në qark.....	73
5.1 Objektivat e përgjithshme për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në zonë	73
5.2 Objektivat specifike	74
5.2.1. Objektivat e përgjithshme për organizimin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet	76
5.2.2. Objektivat për parandalimin e rreziqeve të reja në zonat e rrezikuara nga përmbytjet	77
5.2.3. Objektivat për reduktimin e rreziqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmbytjet	77
5.2.4. Objektivat për reduktimin e pasojave negative gjatë përmbytjeve	78
5.2.5. Objektivat për reduktimin e pasojave negative pas përmbytjeve	78
5.3 Ndërlidhjet e objektivave specifike dhe receptorët e riskut	78
5.3.1. Shëndeti i njeriut	79
5.3.2. Mjedisi	79
5.3.3. Trashëgimia kulturore	79
5.3.4. Aktiviteti ekonomik	80
6 Masat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet	81
6.1 Katalogu i llojeve të masave	81
6.2 Statusi i zbatimit të masave	833
6.3 Masat e përzgjedhura në zonë.....	844
6.3.1. Aspekti 1: Parandalimi i rrezikut	911
6.3.2. Aspekti 2: Mbrojtja natyrore nga përmbytjet	92
6.3.3. Aspekti 3: Mbrojtja teknike nga përmbytjet	94
6.3.4. Aspekti 4: Përgatitja dhe informimi	97
6.4 Masat sipas Zonave me Rrezikshmëri dhe masat e përzgjedhura dhe statusi i zbatimit për territoret e NjQV.....	98
6.5 Prioritetet për zbatimin e masave.....	101
6.6. Përgjegjësia e zbatimit.....	102
6.7 Zbatimi dhe monitorimi.....	103
6.7.1. Kalendar i zbatimit.....	103
6.7.2. Mundësi financimi për zbatim.....	104

6.8	Monitorimi	105
7	Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedis (VSM)	107
8	Aspektet e menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet	110
8.1	Ndikimet e mundshme ndërkufitare të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet	110
8.2	Masa specifike me ndikim të mundshëm ndërkufitar	111
8.3	Statusi dhe perspektiva e menaxhimit ndërkufitar të rrezikut.....	113
9	Koordinimi me direktivën kuadër të ujit 2000/60/KE	113
10	Informacion publik dhe masat e publicitetit	117
10.1	Përmbledhje e procesit të konsultimit.....	117
10.2	Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe aktivitetet informuese	118
11	Referencat.....	119
12	Fjalorth	123

SHTOJCAT

- A – Katalogu i llojeve të masave sipas direktivës së BE-së për përmbytjet
- B – Lista e masave të përzgjedhura / planit të veprimit
- C – Koordinimi me direktivën kuadër të BE-së për ujërat 2000/60/KE
- D – Sistemi i monitorimit të ndikimeve të konsiderueshme në mjedis sipas VSM dhe Deklaratës mjedisore të MTM
- E – Rekomandimet dhe udhëzimet për zbatimin e masave të planit të MRP-së sipas rekomandimeve të VSM dhe të Deklaratës mjedisore të ministrit MTM
- F – Hartat e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet për Qarkun e Shkodrës

LISTA E TABELAVE

Tabela 1:	Projektimi i niveleve të kurorës së digave (Mott MacDonald, 2012a)	22
Tabela 2:	Investimet e rëndësishme të fundit në zonën e projektit (listë e përzgjedhur).....	26
Tabela 3:	Reshjet 24-orëshe të prithshme në [mm] për periudha të ndryshme përsëritjeje për rajonin verior të Shqipërisë (KTK, 2016, i miratuar)	29
Tabela 4:	Popullsia rezidente sipas gjinisë, grupmoshës dhe njësisë administrative sipas të dhënave të censusit 2011 nga INSTAT	30
Tabela 5:	Përdorimi i tokës totale në qarkun e Shkodrës	32
Tabela 6:	Përdorimi i tokës në basenin lumor Drin-Bunë (gjeneruar nga CLC 2012 dhe Copernicus 2016)	34
Tabela 7:	Llojet e përmbytjeve / burimeve (nga: Udhëzimet për raportim sipas direktivës së BE-së për përmbytjet; BE 2013)	47
Tabela 8:	Receptorët e riskut dhe treguesit e riskut (VPRRP, 2018)	49
Tabela 9:	Kriteret e përcaktimit të nivelit të riskut për VPRRP (VPRRP, 2018).....	49
Tabela 10:	Zonat me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet në Shqipëri në basenin lumor Drin-Bunë (AL-4 deri në AL-7 për zonën e projektit) (VPRRP, 2018)	51
Tabela 11:	Kategoritë e objekteve të rrezikuara me vlera të cenueshmërisë (1 = e ulët, 2 = mesatare, 3 = e lartë)	58
Tabela 12:	Përdorimi i tokës në zonën potencialisht të prekur në basenin e lumit Drin të qarkut të Shkodrës	59
Tabela 13:	Banorët që preken potencialisht (nga skenarët e përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500)	60
Tabela 14:	Ndërtesat që preken të prekura (nga skenarët e përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500)	61
Tabela 15:	Objektet e rrezikuara që preken potencialisht të receptorit të riskut “trashëgimia kulturore” të diferencuara sipas skenarëve të përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500..	67
Tabela 16:	Njerëzit e rrezikuar në rrjedhën e poshtme të digave të Vaut të Dejës në skenarin më të keq (KESH, 2015)	72
Tabela 17:	Lista e objektivave të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në qarkun e Shkodrës	75
Tabela 18:	Fushat e veprimit: Katalogu i llojeve të masave për MRP në qarkun e Shkodrës	82
Tabela 19:	Përshkrimi i statusit të zbatimit të masave në planin e veprimit	83
Tabela 20:	Shpërndarja e të gjitha masave për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në trajtimin e MRP në nivel BE-je	84
Tabela 21:	Numri i masave të përzgjedhura në nivel vendor dhe rajonal (Alokimi për NjQV).....	87
Tabela 22:	Numri i masave të përzgjedhura në nivel vendor dhe rajonal (alokim për ZRRPKP)..	89
Tabela 23:	Numri i masave të përzgjedhura sipas aspekteve kryesore dhe përcaktimit të tyre në ZRRPKP	91
Tabela 24:	Mjetet e monitorimit të sugjeruara.....	106
Tabela 25:	Shpërndarja e masave me ndikim të mundshëm ndërkuftar në aspektet e BE-së të MRP	111
Tabela 26:	Karakteristikat e ndikimeve të mundshme ndërkuftare të masave në këtë plan MRP	112
Tabela 27:	Statusi dhe perspektiva e bashkëpunimit ndërkuftar në qark	113

LISTA E FIGURAVE

Figura 1:	Cikli i MRP sipas Direktivës së BE-së për përmbytjet [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT, projekt i BE-së STRIMA 2014, i modifikuar].....	1
Figura 2:	Hapat dhe fazat e MRP-së sipas Direktivës së BE-së për Përmbytjet (referencat e neneve të direktivës janë dhënë në kllapa).....	2
Figura 3:	Hartimi i planit të MRP-së sipas Direktivës së BE-së për menaxhimin e riskut nga përmbytjet.....	4
Figura 4:	Struktura e proceseve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në Shqipëri [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT, bazuar në prezantimin e z. Arduen Karagjozi (AMBU), Qershor 2018]	7
Figura 5:	Aktorët kombëtarë, rajonalë dhe vendor të përfshirë në planin MRP (Qarku Shkodër)	9
Figura 6:	Hapat e punës për planin e MRP-së	11
Figura 7:	Njësitë administrative të zonës së projektit: Bashkia e Shkodrës (e verdhë) me 7 NJQV dhe bashkia e Vaut të Dejës me 1 NJQV në zonën e rrezikuar nga përmbytjet	14
Figura 8:	Harta e rrezikut nga përmbytjet në HQ500 e qarkut të Shkodrës me 8 njësitë administrative të këtij projekti - zona e bashkimit të Drinit dhe Bunës në jug të Shkodrës	15
Figura 9:	Nën-basenet e basenit lumor Drin-Bunë [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT, bazuar në të dhëna me burim të hapur].....	16
Figura 10:	Baseni i lumenjve Drin dhe Bunë - rrjeti lumor (LWI, 2014).....	17
Figura 11:	Harta e reshjeve - reshjet mesatare vjetore 1980-1990 (GIZ)	18
Figura 12:	Zona e degëve në ultësirën Drin-Bunë(INFRASTRUKTUR & UMWELT, 2013)	19
Figura 13:	Rrjedha e lumit Drin dhe Gjadër para devijimit në vitin 1848 dhe kaskada e hidrocentralit të Drinit duke përfshirë hidrocentralin e lumit në Ashtë (INFRASTRUKTUR & UMWELT, 2013)	21
Figura 14:	Përmbytjet e mëdha historike që prej vitit 1851 [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT bazuar në Mott MacDonald, 2012a, e modifikuar]	25
Figura 15:	Projektimet për reshjet vjetore [mm] pa dhe me ndryshimet klimatike (skenari mesatar) në rajonin bregdetar verior të Shqipërisë (KTK, 2016)	29
Figura 16:	Zhvillimi demografik sipas gjinisë bazuar në popullsinë më 1 janar në periudhën 2016-2021 në qarkun e Shkodrës bazuar në të dhënat e INSTAT	31
Figura 17:	Harta e përdorimit të tokës të basenit lumor Drin-Bunë [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT bazuar në të dhënat evropiane me burim të hapur Copernicus dhe CORINE]	35
Figura 18:	Sistemi i planifikimit të territorit i Shqipërisë në nivel kombëtar dhe vendor (PPK, 2016)	37
Figura 19:	Pamje e bajpasit perëndimor (në ndërtim) të qytetit të Shkodrës [foto: INFRASTRUKTUR & UMWELT].....	39
Figura 20:	Pamje e Urës së Re e cila lidh SH1 dhe SH41 me kufirin malazez [foto: INFRASTRUKTUR & UMWELT].....	39
Figura 21:	Vendndodhja e zonave të mundshme të ndërhyrjes në peizazh (PPV Shkodër, 2017, f. 59)	40
Figura 22:	Hartë e zonës së mbrojtur në zonën e projektit (MM, 2005).....	43
Figura 23:	Hapat e punës së vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet për identifikimin e zonave me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet (VPRRP, 2018)	45

Figura 24:	Hapat për vlerësimin e rreziqeve potenciale të konsiderueshme (VPRRP, 2018)	46
Figura 25:	Paraqitja gjeografike (harta) e ZRRPKP në basenin lumor Drin-Bunë duke përfshirë Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, dhe Shqipërinë (VPRRP, 2018)	51
Figura 26:	Hartat e rrezikut nga përmbytjet për qarkun e Shkodrës (2021): tre llojet e hartave sipas direktivës së BE-së për përmbytjet dhe dy lloje shtesë sipas ligjit kombëtar	54
Figura 27:	Përmbajtja / legjenda e hartave të rrezikut nga përmbytjet	55
Figura 28:	Hartë ilustruese e riskut nga përmbytjet për një pjesë të zonës së Shkodrës (2021) .	57
Figura 29:	Tokë e kultivuar potencialisht e përmbytur për skenarë të ndryshëm të përmbytyeve HQ010, HQ100 dhe HQ500 për çdo njësi administrative të qarkut të Shkodrës	60
Figura 30:	Popullsia që preket potencialisht nga përmbytjet e qarkut të Shkodrës e ilustruar për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytyjeje	61
Figura 31:	Ndërtesat që preken potencialisht nga përmbytjet të qarkut të Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytyjeje	62
Figura 32:	Vendndodhja e ndërtimeve informale dhe e grupeve të marginalizuara brenda zonës së projektit, e ilustruar për skenarin e përmbytyjes HQ500	633
Figura 33:	Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "shëndeti i njeriut" për qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytyjeje	64
Figura 34:	Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "mjedisi" për qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytyjeje	66
Figura 35:	Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "trashëgimia kulturore" për qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytyjeje	68
Figura 36:	Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "aktiviteti ekonomik" qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytyjeje	70
Figura 37:	Rrugët dhe hekurudhat që preken potencialisht nga përmbytjet në qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytyjeje	71
Figura 38:	Objektivat e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet (sipas direktivës së BE-së nga përmbytjet)	74
Figura 39:	Masat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe statusi i tyre i zbatimit	84
Figura 40:	Masat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në fushat specifike të veprimit dhe statusi i tyre i zbatimit	86
Figura 41:	Masa për parandalimin e rrezikut dhe statusi i tyre i zbatimit	92
Figura 42:	Masat natyrore për mbrojtjen nga përmbytjet dhe statusi i tyre i zbatimit	94
Figura 43:	Masat teknike për mbrojtjen nga përmbytjet dhe statusi i tyre i zbatimit	96
Figura 44:	Masat e përgatitjes dhe të informimit dhe statusi i tyre i zbatimit	98
Figura 45:	Masat sipas Zonave me rrezikshmëri nga përmbytjet	99
Figura 46:	Masat dhe statusi i zbatimit në fushat e veprimit në NjQV të ndryshme	100
Figura 47:	Numri i masave të përzgjedhura sipas aspekteve kryesore për çdo prioritet	102
Figura 48:	Përgjegjësitë në nivel kombëtar, rajonal apo vendor	103
Figura 49	Hapat e përgjithshëm të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)	109

LISTA E SHKURTESAVE / AKRONIMEVE

ADZM	Administrata e Zonave të Mbrojtura
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit Territorial
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ZRRPKP	Zonat me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
AREB	Agjencia e Ekstensionit Bujqësor Shkodër
BMZ	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
BSH	Bashkia e Shkodrës
BVD	Bashkia e Vaut të Dejës
CCAWB	Përshtatja me ndryshimet klimatike në Ballkanin Perëndimor
CIS	Strategjia e Përbashkët e Zbatimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
DEM	Modelet Digjitale të Lartësisë
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
ZRF	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë
DUK	Drejtoria e Ujitjes dhe e Kullimit
EIA	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
EU	Bashkimi Evropian
EU-WFD	Direktiva Kuadër e BE-së për Ujin
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
HRrRP	Hartat e Rrezikut dhe Riskut nga Përmbytjet
MRP	Menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet
GEF	Instrumenti Global i Mjedisit
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim)
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
HEC Ashta	Hidrocentrali i Ashtës
HEC Fierzë	Hidrocentrali i Fierzës
HEC Koman	Hidrocentrali i Komanit
HEC Vau i Dejës	Hidrocentrali i Vaut të Dejës
IGEO	Instituti i Gjeoshkencave
INSTAT	Instituti i Statistikave

IPA CBC	Instrumenti për Asistencën e Para-Aderimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
NJQV	Njësi e qeverisjes vendore
MBZHR	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PKEC	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
KKDM	Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
NGO	Organizatë Joqeveritare
NJA	Njësi administrative
NJAD	Të gjithë njësitë administrative të bashkisë
NWC	Këshilli Kombëtar i Ujit
OSM	Harta Open Street
P	Prefektura (<i>prefektura</i>)
VPRRP	Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet:
Q	Këshilli i Qarkut Shkodër (<i>qarku</i>)
RAEA	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër
SEA	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
SHPP	Hidrocentral i Vogël
SKMIBU	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2018-2027
KTK	Komunikimi i tretë kombëtar i Shqipërisë për ndryshimet klimatike
UK Shkodër	Ujësjiellësi i Shkodrës
UK Vau i Dejës	Ujësjiellësi i Vaut të Dejës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
GP	Grupi i Punës
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
ZABU	Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin Buna

1 Historiku dhe objektivat

1.1 Kuadri i direktivës evropiane për përmbytjet

Direktiva Evropiane 2007/60/KE "Për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet" (në vijim referuar si: Direktiva e BE-së për përmbytjet) kontribuon për përcaktimin e një kuadri ligjor për menaxhimin e integruar të ujërave, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, për të gjithë shtetet anëtare evropiane. Ajo i shtohet ndryshimit të strategjisë për të luftuar risqet që vijnë nga përmbytjet: qasja fillestare ka qenë mbrojtja e njerëzve, e të mirave ekonomike dhe e tokave bujqësore nga përmbytjet (gjë e cila dështon kur përmbytjet ekstreme tejkalojnë veprat mbrojtëse). Qasja e re e Direktivës së BE-së për përmbytjet është bashkëpunimi me të gjithë aktorët përkatës për të "jetuar me përmbytjet", për t'u mbrojtur nëse është e mundur, për t'i përshtatur ndryshimet dhe ndërtimet në zonat përkatëse kundrejt rrezikut nga përmbytjet, dhe veçanërisht për t'u përgatitur për përmbytjet, me një qasje tërësore me të gjithë njerëzit, organizatat, administratat dhe bizneset që preken potencialisht.

Ndaj, qëllimi i Direktivës së BE-së për përmbytjet është të krijojë një kornizë për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, duke synuar reduktimin e pasojave negative në shëndetin e njerëzve, në mjedis, në trashëgiminë kulturore dhe në aktivitetin ekonomik të lidhura me përmbytjet në komunitet. Sipas Direktivës së BE-së për përmbytjet, menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet duhet të adresojë të gjitha aspektet e përmbytjeve, duke përfshirë parandalimin, mbrojtjen dhe gatishmërinë. Veprimet dhe masat e planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të prekin të gjithë fazat e ciklit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet (shih Figura 1).




Figura 1: Cikli i MRP sipas Direktivës së BE-së për përmbytjet
[grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT, projekt i BE-së STRIMA 2014, i modifikuar]

Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet do të përfshijnë masat për parandalimin e përmytjeve, për mbrojtjen parandaluese ndaj përmytjeve dhe për gatishmërinë. Ato do të përfshinë gjithashtu masa për periudhat përpara se të ndodhë një përmytje, për kohën kur ndodh një përmytje, si dhe për periudhën e rikuperimit pasi ka ndodhur një përmytje.

Direktiva e BE-së për përmytjet duhet të zbatohet në koordinim me akte të tjera ligjore, kryesisht me Direktivën e BE-së 2000/60/KE (Direktiva Kuadër për Ujin, EU-WFD), dhe kërkon zbatim ciklik. Direktiva e BE-së për përmytjet përqendrohet në integrimin e të gjithë sektorëve përkatës, duke përfshirë menaxhimin e përdorimit të tokës, mbrojtjen civile, menaxhimin e digave, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe strategjik, kuadrin ligjor për mjedisin, konsultimin publik etj. Një objektivi i madh është koordinimi përgjatë basenit lumor, duke përfshirë kërkesat për koordinim ndërkuftar.

Në përgjithësi, Direktiva e BE-së për përmytjet parashikon tre hapa (shihni Figura 2) të cilët duhet të zbatohen nga të gjitha shtetet anëtare brenda afatit të dhënë për të gjitha basenet lumore:

Hapi i parë: Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmytjet (VPRRP) i cili çon në identifikimin e zonave me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmytjet (ZRRPKP);

Hapi i dytë: Hartëzimi i rreziqeve dhe risqeve nga përmytjet (HRrRP);

Hapi i tretë: Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga përmytjet.




Figura 2: Hapat dhe fazat e MRP-së sipas Direktivës së BE-së për Përmytjet (referencat e neneve të direktivës janë dhënë në kllapa)

Për projektin në qarkun e Shkodrës në Shqipëri, Direktiva e BE-së për përmbytjet nuk është detyruese, pasi Shqipëria nuk është ende pjesë e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Megjithatë, midis partnerëve është rënë dakord që gjatë specifikimit të projektit do të ndiqet sa më afër të jetë e mundur Direktiva e BE-së për përmbytjet, për të kontribuar në procesin e përafrimit për integrimin evropian.

Për zonën e projektit, hapi i parë (Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet dhe identifikimi i zonave me rrezik potencial nga përmbytjet) është finalizuar në prill 2019 gjatë vlerësimit për rajonin ndërkufitar të basenit lumor Drin-Bunë, duke rezultuar në katër ZRRPKP të mëdha për rajonin e projektit në Shkodër (4, 5 dhe 6). Detajet jepet në kapitullin 3. Vlerësimi paraprak është miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 1, datë 15.06.2021, "Për miratimin e raporteve të vlerësimit paraprak të rreziqeve nga përmbytjet për basenet ujore Drin-Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin Seman, Vjosë dhe shpalljen e zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhë përmbytje".

Hapi i dytë (Zhvillimi i hartave të rrezikut nga përmbytjet ose i hartave të shtrirjes së përmbytjeve) është ndërmarrë në projektin "Hartëzimi i rreziqeve dhe risqeve nga përmbytjet në basenin lumor të Drinit" ku janë zhvilluar HRrRP për qarkun e Shkodrës. Versionet përfundimtare janë të disponueshme nga marsi i vitit 2022. Hartat për zonat 4,5 dhe 6 janë miratuar nga Vendimi nr. 3 i Këshillit Kombëtar të Ujit, datë 15.06.2021, "Për miratimin e hartave të rrezikut nga përmbytjet për disa zona të basenit ujor Drin-Bunë".

Bazuar në këto hapa, hapi i tretë (Zhvillimi i planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet) është fokusi i aktiviteteve në këtë projekt, shih kapitullin 1.4. Këto përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave VKM nr. 1015, datë 16.12.2020, "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet".

Objektivi kryesor i këtij plani për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet është të përmirësojë menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet (MRP) duke u fokusuar në veçanti në masat jo-strukture, të tilla si paralajmërimi, gatishmëria dhe planifikimi i territorit. Kjo përfshin marrjen në konsideratë të të gjithë llojeve të përshtatshme të masave për gatishmërinë, menaxhimin e fatkeqësive, fazat e rikuperimit dhe zhvillimin e kuadrit për menaxhimin rajonal të rrezikut nga përmbytjet, si dhe planet vendore për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet për qarkun e Shkodrës.

Imazhi i mëposhtëm tregon hapat e nevojshëm në procesin e planifikimit të MRP-së, duke përfshirë përshkrimin / vlerësimin e riskut, vlerësimin e mangësive / nevojës për veprim, identifikimin e masave të mundshme, planifikimin e masave dhe dokumentimin.




Figura 3: Hartimi i planit të MRP-së sipas Direktivës së BE-së për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet

Projekti i PMRP-së i Shkodrës ndjek në përgjithësi hapat dhe qasjet metodologjike të BE-së për të zbatuar direktivën. Detajet e mëtejshme janë dokumentuar në dokumentet e grupit të punës së BE-së për përmbytjet dhe në dokumentet e grupeve të punës të cilat koordinojnë procesin e CIS (Strategjia e Përbashkët e Zbatimit)¹.

1.2 Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional i Shqipërisë

Në kuadër të procesit të përafimit me BE-në, Shqipëria po punon për të harmonizuar legjisllacionin për të përmbushur kërkesat e direktivës së BE-së për përmbytjet. Autoriteti kryesor përgjegjës në Shqipëri është Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).

Në lidhje me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, ekzistojnë katër fusha kryesore të legjisllacionit dhe politikave në Shqipëri (Mott MacDonald, 2012a):

- Legjisllacioni për mbrojtjen civile i cili lidhet me planifikimin dhe përgjigjen ndaj emergjencave;
- Rregulloret dhe politikat për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (ZRF);
- Mbrojtja nga përmbytjet dhe

¹ Dokumentet udhërrëfyese të CIS janë publikuar në http://ec.europa.eu/environment/water/flood_risk/implem.htm

- Planifikimi i zhvillimit, i cili rregullon dhe kontrollon zhvillimin e infrastrukturës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet.

Ndaj, menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet aktualisht rregullohet nga ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, i miratuar më 18 korrik 2019, duke zëvendësuar ligjin nr. 8756/2001 “Për shërbimet e emergjencave civile”. Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” përbën kuadrin kryesor ligjor, prezanton konceptim e zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë (ZRF) dhe promovon mbrojtjen civile. Ai parashikon zhvillimin e

- strategjive kombëtare dhe vendore për ZRF²,
- vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar dhe vendor, dhe
- planet e emergjencave në të gjitha nivelet në përputhje me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC)³.

Aktualisht, është në progres puna për përgatitjen e dokumenteve të mëposhtme. Janë ngritur tre grupe pune ndërinstucionale nën kujdesin e kryeministrit për zhvillimin e secilit dokument. Më pas, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) duhet të verifikojë dokumentet.

Strategjia Kombëtare për ZRF: Ky është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë i cili përcakton politikën dhe aktivitetet e institucioneve, të strukturave qendrore dhe vendore, si dhe të të gjithë strukturave të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë

Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë: Ky dokument identifikon llojet, karakteristikat dhe origjinën e risqeve të fatkeqësive, nivelin e ekspozimit dhe vulnerabilitetit, faktorët të cilët shkaktojnë apo rrisin nivelin e riskut, si dhe pasojat e mundshme për jetën e njerëzve, qeniet e gjalla, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin

Planet e emergjencave civile: Planet e emergjencave civile përcaktojnë masat dhe aktivitetet për parandalimin e fatkeqësive dhe përgjigjen/reagimin ndaj tyre, të tilla si kapacitetet, angazhimi dhe veprimet e organizuara gjatë emergjencave për të mbrojtur jetët e njerëzve, qeniet e gjalla, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Planet e qarkut (në nivel qarku) dhe planet vendore për emergjencat civile harmonizohen me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEM)

Për sa i përket mbrojtjes nga përmbytjet, kuadri ligjor bazohet edhe në politikën kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet dhe erozionin, nën kujdesin e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHR). Në këtë aspekt, ligji nr. 24/2017, i miratuar më 9 maj 2017, “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, lehtëson


² Në bashkëpunim me UNDP, Shqipëria po përgatit një strategji kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

³ PKEC është miratuar më 3 dhjetor 2004 me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 835/2004

caktimin dhe zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi kryesore të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit, duke pasur kështu si synim ngritjen e kuadrit institucional dhe funksional në përputhje me politikat kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Një nga tre objektivat e ligjit nr. 24/2017 është rritja e produktivitetit bujqësor duke përmbytur nevojat për ujë të fermerëve, si dhe duke përmirësuar kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet në të gjithë zonat të cilat mund të kullohen.⁴ Gjithashtu, në Strategjinë e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri të vitit 2017⁵ përcaktohen synimet e politikës dhe objektivat strategjikë. Nga katër objektivat, mbrojtja nga përmbytjet është një nga fushat kryesore të fokusit.

Për sa i përket çështjeve të planifikimit, ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” citon se planet për zhvillimin urban duhet të hartohen në përputhje me dokumentet dhe strategjitë e vlerësimit të risqeve nga fatkeqësitë (Ligji 45/2019, neni 12). Kështu, midis 43 bashkive, bashkia Shkodër ka hartuar dhe miratuar edhe Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV)⁶. PPV nuk specifikon vetëm përdorimin e tokës dhe planifikimin e territorit për të gjithë territorin administrativ të bashkisë, si për shembull toka bujqësore dhe zonat me ujë, por ai përfshin gjithashtu elementë të ZRF-së, identifikimin e zonave të rrezikuara nga rreziqet natyrore dhe riskun e tyre. (Shih kapitullin 2.9 për më shumë informacion rreth strukturave të planifikimit të territorit dhe implikimit të tyre në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.)

Sigurisht, ka lidhje me fusha të tjera të legjislacionit dhe politikave siç janë çështjet financiare dhe ekonomike, mjedisi, burimet natyrore, bujqësia dhe turizmi.



⁴ Ekziston një plan veprimi për përmirësimin e shërbimit të kanaleve kulluese në bashkinë Shkodër i vitit 2017 që gjendet në: http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plan_veprimi_per_sherbimin_e_kullimit_1373.pdf

⁵ Për më shumë informacion referohuni në https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Strategjia_U_K_korrik_2017_konsultim-1.pdf

⁶ PPV për bashkinë e Shkodrës është në fuqi për periudhën 2015-2030 me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5, datë 16.10.2017. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 9, datë 28.12.2020, miratoi rishikimin e PPV-së të bashkisë Shkodër.

Figura 4: *Struktura e proceseve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet në Shqipëri [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT, bazuar në prezantimin e z. Arduen Karagozi (AMBU), Qershor 2018]*

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi ndërinstitucional kryesor përgjegjës për miratimin e politikave dhe planeve për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i cili vepron në bazë të ligjit nr. 111/2012, datë 08.02.2018 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Ai kryesohet nga kryeministri i Shqipërisë dhe përbëhet nga shtatë ministri kryesore të përfshira. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është institucioni ekzekutiv përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të lidhura me burimet ujore, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit. Si rrjedhojë, AMBU është gjithashtu përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet, në zbatim të ligjit nr. 111/2012.

Sipas nenit 70 të ligjit nr. 111/2012, AMBU, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, kontribuon në koordinimin e zbatimit të politikave të menaxhimit të baseneve lumore dhe të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për emergjencat civile dhe PKEC. Përveç kësaj, AMBU koordinon aktivitetet të cilat i referohen integritet të planeve të MRP-së në planin e menaxhimit të basenit lumor (shih kapitullin 0).

Praktikisht, AMBU është ngarkuar për MRP-në, përfshirë edhe HRRP, dhe për koordinimin e procesit me institucionet e tjera. MBZHR është institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe stacionet e kullimit, bazuar në planet e MRP-së. Bashkitë janë përgjegjëse për mbrojtjen e zonave urbane nga risqet e përmytjeve, gjithashtu e bazuar në planin e MRP-së. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) koordinon punën për hartimin e PKEC dhe zbaton politikat e Këshillit të Ministrave në fushën e ZRF-së dhe mbrojtjes civile, si për shembull PKEC, të cilat koordinohen me planet e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet.

Institucionet përgjegjëse për planifikimin dhe politikat:

- AMBU-ja është përgjegjëse për politikat dhe planifikimin në nivel qendror;
- KKU dhe më pas Këshilli i Ministrave janë përgjegjës për miratimin e planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmytjet;
- AKMC është përgjegjëse për koordinimin e përgatitjes dhe zbatimin e PKEC-së (miratimi i PKEC-së bëhet nga Këshilli i Ministrave);
- Bashkitë dhe ministritë janë autoritetet zyrtare për planifikimin e territorit në Shqipëri;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është përgjegjëse për koordinimin që PPV të jetë në përputhje me planin MRP.

Institucionet përgjegjëse për investimet për mbrojtjen nga përmbytjet dhe masat për zvogëlimin e riskut:

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për infrastrukturën për mbrojtjen nga përmbytjet në tokat bujqësore;
- Bashkitë janë përgjegjëse për investimet për mbrojtjen nga përmbytjet të zonave urbane dhe masat për zvogëlimin e riskut.

Institucionet përgjegjëse për situatat emergjente nga përmbytjet:

- Ministria e Mbrojtjes dhe AKMC janë përgjegjëse për koordinimin e veprimeve dhe ndërhyrjes për të mbrojtur jetën e njerëzve dhe pronën;
- Prefektura është përgjegjëse për koordinimin e institucioneve vendore gjatë ngjarjeve të emergjencave në nivel qarku;
- Bashkitë janë përgjegjëse për koordinimin e strukturave të tyre për të mbrojtur jetët e njerëzve dhe pronat.

1.3 Institucionet e përfshira për zhvillimin e planit MRP

Partnerët kryesorë të projektit janë njësitë të qeverisjes rajonale dhe vendore, njësitë e tyre administrative dhe grupet e tjera të aktorëve përkatës të sektorit privat dhe shoqërisë civile, p.sh.

- Ministritë, institutet kombëtare dhe agjencitë;
- Prefektura e Shkodrës, Këshilli i Qarkut Shkodër, administratat rajonale, bashkitë dhe njësitë administrative;
- Departamentet e planifikimit të territorit, shërbimet e shpëtimit/sigurisë publike, menaxhimi i emergjencave;
- Akademikët (fakultetet e shkencave të natyrës, inxhinierisë së ndërtimit, inxhinierisë së mjedisit)
- Prodhuesit e energjisë/ operatorët e hidrocentraleve

Gjithashtu, është ngritur një grup pune ndërinstitucional për të mbështetur zhvillimin dhe miratimin e planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në nivel kombëtar. Takimi i tij i parë u zhvillua më 2 nëntor 2021.




Figura 5: Aktorët kombëtarë, rajonalë dhe vendor të përfshirë në planin MRP (Qarku Shkodër)

Projekti fokusohet në zhvillimin e planit rajonal për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet për njësitë administrative që preken në Shkodër dhe rreth saj. Plani përfshin ekzaminim e njësive administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethina, Shkodër dhe Velipojë në Bashkinë e Shkodrës dhe të Bushatit në Bashkinë e Vaut të Dejës (shih kapitullin 0) për një përshkrim gjithëpërfshirës të zonës së projektit).

Procesi mbështetet në punën që është bërë tashmë në të shkuarën dhe në kontributet e administratave rajonale dhe vendore përkatëse dhe të grupeve të tjera të interesit.

Aspektet kryesore të përfshirjes së aktorëve në zhvillimin e planit MRP janë:

- Plani MRP udhëhiqet nga parimet e direktivës së BE-së për përmbytjet dhe në VKM nr. 1015, datë 16.12.2020; të dyja kërkojnë procese me shtytje të forta nga aktorët.
- Plani MRP përfshin një katalog masash të lidhura me “llojet e masave” të BE-së, të përshtatura me karakteristikat rajonale; katalogu është një propozim, i cili duhet të plotësohet dhe të përshtatet nga aktorët dhe grupet lokale të interesit.
- Aktivitetet përfshijnë masat e trajnimit për njësitë e qeverisjes vendore me fokus në zvogëlimin e riskut, parandalimin e dëmit dhe rritjen e ndërgjegjësimit;

- Faktet dhe shifrat e përdorura për planifikimin e masave bazohen në njohuritë institucionale dhe praktike të specialistëve qendrorë dhe vendorë në çdo grup pune, të udhëhequra dhe të verifikuara në maksimumin e mundshëm nga ekspertët e projektit.

1.4 Hapat e punës dhe metodat

Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet fokusohen në parandalim, mbrojtje dhe gatishmëri. Me synimin për t'u dhënë lumenjve më shumë hapësirë, të gjithë aktorët përkatës duhet të marrin në konsideratë ku është e mundur mirëmbajtjen dhe/ose restaurimin e fushave aluvionale, si dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e dëmtimit të shëndetit të njerëzve, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe aktivitetit ekonomik. E rëndësishme për një qasje moderne në MRP është ngritja e masave parandaluese dhe mbrojtëse që mbulojnë të gjithë ciklin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, nga përgatitja dhe menaxhimi i fatkeqësive deri në fazën e rikuperimit. Në procesin e hartimit të planit të MRP-së u përfshinë të gjithë aktorët e mundshëm të cilët mund të kontribuonin në zbutjen e riskut.

Procesi përfshiu:

- Identifikimin e NJQV-ve që preken bazuar në përmbytjet e kaluara, hartat e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet, vlerësimin dhe analizimin e dokumenteve dhe studimeve të tjera të planifikimit;
- Ngritjen e një grupi pune ndër-institucional për MRP duke përfshirë të gjithë aktorët vendorë, rajonalë dhe kombëtarë;
- Vlerësimin dhe diskutimin mbi situatën e riskut, vendet kryesore të rrezikuara dhe nevojat e përgjithshme për veprim për qarkun e Shkodrës, bashkë me autoritetet vendore dhe rajonale dhe grupet e interesit;
- Zhvillimin dhe marrëveshjen për objektivat e duhura për MRP, proceset e projektit dhe hapat e veçantë, duke përfshirë edhe përgjegjësitë për hapat përkatës;
- Zhvillimin dhe marrëveshjen e masave për reduktimin e riskut, vlerësimin e statusit të zbatimit të çdo mase dhe marrëveshjen për listën e masave në planin e MRP-së, duke përfshirë një panoramë të përbashkët të prioritetëve të masave për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe veprime të tjera për komunitetet rajonale dhe vendore;
- Hartimin e raportit të planit të MRP-së, publikimin e draftit dhe konsultimin me grupim ndër-institucional të punës (drafti 1) dhe publikun (drafti 2);
- Përfundimi i planit MRP 2023-2028.

Fokusi kryesor në këto detyra ishte identifikimi dhe klasifikimi në një proces pjesëmarrës me aktorët përkatës i masave dhe përgjegjësive të mundshme për lloje të ndryshme

masash. Një vlerësim i përbashkët tregues i masave në lidhje me kriteret e thjeshta (ndikimi i përgjithshëm i masave, pengesat e realizimit, burimet e nevojshme), i cili është dokumentuar në kapitullin “prioritetet”, tregon qartë se ka shumë aktorë të ndryshëm të përfshirë dhe se duhen përcaktuar qartë përgjegjësitë për secilën masë. Jo vetëm masat strukturore me kosto të lartë i zgjidhin problemet, dhe shumë masa mund të merren pa përpjekje të mëdha brenda hapave “normalë” të planifikimit.




Figura 6 – Hapat e punës për Planin

Figura 6, jep një pasqyrë të hapave të punës dhe afateve kohore të planit të MRP-së në qarkun e Shkodrës, duke marrë në konsideratë standardet e direktivës së BE-së për përmbytjet dhe VKM nr. 1015, datë 16.12.2020.

Në hapin e parë të punës, u analizuan hartat e rrezikut dhe hartat e riskut nga përmbytjet të vitit 2021 në lidhje me shtrirjen e përmbytjeve (hartat e rrezikut) dhe përdorimin e tokës, si dhe në lidhje me objektet e rrezikuara (hartat e riskut).

Në përputhje me direktivën e BE-së për përmbytjet janë vlerësuar risqet për objektet e grupeve të mëposhtme dhe ato jepen në hartat e riskut dhe në planin e MRP-së (shih kapitullin 4 për detajet):

- Shëndeti i njeriut (njerëzit, veçanërisht të moshuarit, fëmijët dhe invalidët, ndërtesat e banimit, objektet arsimore dhe furnizimet bazë ndër të tjera);
- Mjedisi (zonat e mbrojtura, zogjtë dhe kafshët e egra, flora dhe fauna e ndjeshme, si dhe cilësia e ujërave nëntokësore);
- Trashëgimia kulturore (gjithashtu kishat, varrezat);
- Aktivitetet ekonomike (bizneset, fermat, toka bujqësore).

Sipas direktivës së BE-së për përmbytjet u mor në konsideratë risku nga skenarët e mëposhtëm të përmbytjeve: përmbytja me këto statistika

- Periudhë përsëritjeje e shpeshtë (periudhë e shkurtër përsëritjeje, një herë në < 10 vjet);
- Periudhë përsëritjeje mesatare (një herë në 50 – 100 vjet);
- Përmbytje ekstreme apo një periudhë përsëritjeje e gjatë (përmbytje me probabilitetin më të lartë të mundshëm ose një herë në 200 apo 500 vjet ose më shumë).

Vlerësimi i situatës së rrezikut nga përmbytjet u bazua në dy hapat e parë të punës (VPRRP dhe HRrRP⁷) dhe ai nxori një përshkrim statistikor dhe të hartëzuar të shpërndarjes së risqeve në zonë. Bazuar në vlerësimin e riskut, u zhvilluan, u hartuan dhe u përshtatën

⁷ Përveç hartave të përditësuara të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet (të prodhuara në projektin CCAWB të GIZ në periudhën 2019-2021 në bashkëpunim me grupin ndërkufitar teknik të punës nga katër shtetet që lagen nga baseni lumor Drin-Buna), u analizuan edhe informacionet ekzistuese nga ngjarjet e përmbytjeve të kaluara. Në analizë u përfshi gjithashtu vlerësimi i ngjarjeve të vitit 2010 si përmbytjet më të mëdha në të shkuarën - shih gjithashtu studimin e MRP-së (2014) dhe Mott McDonald (2012a). Referojuni kapitullit 2.4 për më shumë informacion rreth projekteve përkatëse të shkuara dhe në vazhdim në zonën e projektit.

objektiva të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet, sipas konsultimeve të grupit të punës.

Në një hap qendror të punës, katalogu i masave (i cili bazohet në direktivën e BE-së për përmblytjet) u përdor si një listë kontrolli për të përzgjedhur dhe përcaktuar masat (instrumentet administrative, aspektet e mbrojtjes, aspektet teknike të mbrojtjes nga përmblytjet, aspektet e gatishmërisë, shih shtojcën A). Identifikimi pasues i masave përfshiu përzgjedhjen dhe përshkrimin e masave dhe përgjegjësitë përkatëse. Me rëndësi ishte vlerësimi i statusit të zbatimit sipas kategorive të masave (i nisur, në vazhdim dhe i përfunduar) sipas nomenklaturës së raportimit të BE-së. Gjithashtu, u përcaktuan prioritetet, bazuar në një vlerësim të përbashkët tregues të masave lidhur me kriteret e thjeshta përshkruese (ndikimi i përgjithshëm i masave, pengesat për realizim, burimet e nevojshme, kriteret mjedisore dhe kriteret sociale). Prioritetet e planit të veprimit tregojnë:

- cilat masa me kosto të ulët mund të merren në fillim,
- cilat vlerësime shtesë mund të jenë të nevojshme,
- cilët aktorë janë kryesisht përgjegjës dhe
- për cilat masa duhen mbledhur fonde shtesë.

Hapi i fundit ishte dokumentimi për sa i përket raportit përfundimtar dhe shtojcave plotësuese. Planet e MRP-së janë përmbledhja e vlerësimit të riskut dhe e planeve të veprimit.

Sipas legjislacionit kombëtar dhe gjithashtu sipas direktivave të BE-së, vlerësimi strategjik mjedisor (VSM) është i detyrueshëm gjatë hartimit të planit të MRP-së. Si rrjedhojë, u hartua një dokument VSM, u publikua për konsultim me grupin e punës dhe publikun dhe në fund u plotësua.

2 Karakteristikat e zonës së projektit

2.1 Zona e projektit në basenin lumor Drin-Buna

Zona e projektit ndodhet në Shqipërinë veriperëndimore në kufi me Malin e Zi. Ajo karakterizohet nga fushat aluvionale bregdetare të lumenjve Drin dhe Bunë, malet rrethuese, kodrinat e Alpeve Shqiptare - me lartësi deri në më shumë se 1700 m (Mali i Cukalit, në lindje të Shkodrës) dhe liqeni i Shkodrës, një liqen i madh i brendshëm që ndahet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Lumi Buna në skajin jugor të liqenit është rrjedha e vetme që derdhet në detin Adriatik pasi bashkohet me lumin Drin afër qytetit të Shkodrës.




Figura 7: Njësitë administrative të zonës së projektit: Bashkia e Shkodrës (e verdhë) me 7 NJQV dhe bashkia e Vaut të Dejës me 1 NJQV në zonën e rrezikuar nga përmbytjet

Përmbytjet janë të shpeshta gjatë periudhës nëntor-mars, kur rajoni merr rreth 80-85 për qind të reshjeve të tij vjetore (Bogdani, 2006). Kjo zonë me risk potencial në qarkun e Shkodrës mbulon njësitë administrative të bashkisë Shkodër Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethina, Shkodër, si dhe Velipojë dhe Bushat si të vetmet njësi administrative që preken të bashkisë Vau i Dejës, shih Figura 8.




Figura 8: Harta e rrezikut nga përmbytjet në HQ500 e qarkut të Shkodrës me 8 njësitë administrative të këtij projekti - zona e bashkimit të Drinit dhe Bunës në jug të Shkodrës

Ultësira Drin-Bunë është pjesë e Drinit të zgjeruar ndërkufitar me vendet që lagen prej tij të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Sipërfaqja totale ujëmbledhëse e basenit është rreth 20 380 km² (LWI, 2014) dhe përfshin Drinin e Zi, Drinin e Bardhë dhe lumin Buna, si dhe liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespës. Drini i Zi buron nga liqeni i Ohrit dhe rrjedh në veri duke kaluar kufirin midis Maqedonisë dhe Shqipërisë. Drini i Bardhë shtrihet në Kosovë. Të dy përrenjtë derdhen në liqenin e Fierzës. Prej aty, lumi Drin kalon

kaskadën e digave të tre liqeneve: Fierzë (73 km²), Koman (12 km²) dhe Vau i Dejës (25 km²) që operohen nga KESH (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare). Digat janë ndërtuar në vitin 1975 (diga më e ulët e Vaut të Dejës), në vitin 1978 (diga më e lartë e Fierzës) dhe në vitin 1985 (diga e Komanit) (LWI, 2014). Prodhimi i energjisë hidrike në lumin Drin është me rëndësi jetike për Shqipërinë, pasi prodhon rreth 90% të energjisë elektrike në Shqipëri. Më tej, në rrjedhën e poshtme Drini bashkohet me daljen nga liqeni i Shkodrës, me lumin Buna dhe e humbet emrin e tij.




Figura 9: Nën-basenet e basenit lumor Drin-Bunë [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT, bazuar në të dhëna me burim të hapur]

Lumi i Bunës shtrihet nga dalja në liqenin e Shkodrës deri në Detin Adriatik dhe ka një gjatësi prej 44 km. Në kilometrat e fundit - para se të bashkohet me detin - lumi i Bunës rrjedh pjesërisht përgjatë kufirit midis Malit të Zi dhe Shqipërisë. Ultësira Drin-Bunë përfaqëson një sistem ujor shumë kompleks, ku ndërveprojnë lumenjtë, liqenet, ligatinat dhe ujërat nëntokësore. Përveç shumë vlerave natyrore, baseni i Drinit është i rëndësishëm për ekonominë e shteteve ripariane. Përdoruesit kryesorë të ujit janë energjia, bujqësia dhe

blegtoaria, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, minierat dhe industria, mjedisi, peshkimi, turizmi dhe transporti.




Figura 10: Baseni i lumenjve Drin dhe Bunë - rrjeti lumor (LWI, 2014)

2.2 Klima, hidrologjia dhe origjina e përmbytjeve

Për shkak të reshjeve të mëdha gjatë sezonit të dimrit nga njëra anë dhe potencialit të kufizuar të shkarkimit nga ana tjetër, përmbytja është një fenomen natyror i zakonshëm në ultësinë Drin-Bunë. I gjithë baseni Drin-Bunë karakterizohet nga një klimë kryesisht mesdhetare, me deri në mbi 3000 mm reshje mesatare vjetore në pjesët malore të pellgut ujëmbledhës. Reshjet bien kryesisht nga nëntori deri në mars dhe ka një luhatje të gjerë të sasisë totale dhe shpërndarjes hapësinore të shiut në pjesë të ndryshme të basenit.




Figura 11: Harta e reshjeve - reshjet mesatare vjetore 1980-1990 (GIZ⁸)

⁸ Hartë e përgatitur nëpërmjet modelit hidrologjik të përgatitur për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm të Përmbytjeve sipas projektit CCAWB të GIZ bazuar në të dhënat e reshjeve të Shërbimeve Kombëtare Hidrometeorologjike të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi

Si rrjedhojë, intensiteti i përmbytjes varet shumë nga ndërhyrja e modelit të reshjeve në pjesë të ndryshme të të gjithë basenit. Shkrija e borës në pranverë është një tjetër kontribuues kryesor i përmbytjeve. Ultësira Drin-Bunë preket veçanërisht nga përmbytjet kur të gjithë përrenjtë kanë ngarkesa të larta ujore në të njëjtën kohë: Lumi Drin dhe Gjadër të cilët vijnë nga malet në lindje dhe juglindje të Shkodrës, lumi Kir i cili vjen nga verilindja dhe Buna e cila është e vetmja dalje e liqenit të Shkodrës, shih 12. Përveç kësaj, bilanci uhor i liqenit të Shkodrës (377-530 km²), i ndarë nga Shqipëria dhe Mali i Zi, është shumë i ndikuar nga lumenjtë Morača dhe Zeta, të cilët shkarkojnë vargun malor verior të nënbasenit të Malit të Zi.



Figura 12: Zona e degëve në ultësirën Drin-Bunë (INFRASTRUKTUR & UMWELT, 2013)

Risku i lartë nga përmbytjet në këtë rajon buron, përveç pasojave të tjera të shpyllëzimit, kaskadave dhe ndryshimeve klimatike, nga devijimi i rrjedhës së lumit Drin në shekullin e 19-të. Deri në vitin 1848 lumi Drin e kishte rrugën e tij drejt detit Adriatik përmes Bushatit, Gramshit (këtu bashkohet me lumin Gjadër) dhe më pas derdhej në det pranë Lezhës. Për shkak të përmbytjeve të viteve 1848, 1858 dhe 1896 rrjedha e Drinit u devijua (REC, 2010) Zhvendosja e kanalit natyror u mbështet më vonë nga ndërtimi i kanaleve për të përdorur energjinë hidrike për mullinjtë në jug të Shkodrës, si dhe nga mbyllja e pjesës së shtratit të mëparshëm të lumit Drin (Schwarz, 2009). Sot, lumi i Drinit derdhet kryesisht nëpërmjet lumit të Bunës.

Shtrati i tij i vjetër është pjesë e sistemit të kullimit, por pa një potencial të lartë shkarkimi, shih Figura 3. Sipas Miho et al. (2021) kompleksi ligatinor Kune-Vain është prekur nga devijimi. Në studimin e tyre, Miho et al. (2021), citojnë degradimin e ekosistemit të ish-Drinit të Lezhës dhe efektet negative në hidrologji dhe ekologji në të gjithë sistemin (Shkodër-Lezhë). Ndër masat e tjera për t'u marrë në konsideratë, ata theksojnë rigjallërimin (shkarkimin e kontrolluar) të Drinit të Lezhës si një përshtatje me bazë në ekosistem.

Sistemi ekzistues i mbrojtjes nga përmytjet në qarkun e Shkodrës daton në vitet '60 dhe mbështetet në një mori pritash dhe kanalesh kulluese (Mott MacDonald, 2012a). Këto janë ndërtuar kryesisht pas përmytjeve katastrofike të viteve 1962-1963. Në këtë periudhë, janë kryer investime të mëdha në pjesën e poshtme të lumenjve Drin dhe Bunë. Edhe pse shumë nga masat teknike të mbrojtjes nga përmytjet kanë qenë të dobishme gjatë përmytjeve të mëvonshme - si për shembull ato në dimrin e viteve 1970-1971, ato nxitën gjithashtu zgjerimin e mëtejshëm të vendbanimeve në fushat aluvionale të lumenjve, duke rritur kështu potencialin për dëmtime nga përmytjet. Kjo ultësirë e prirur për përmytje është një zonë ujëmbajtëse natyrore, por vendosja dhe kultivimi këtu u zbatua qëllimisht në kohën e regjimit socialist kur Shqipëria varej nga prodhimi i saj dhe çdo pjesë toke pjellore përdorej për qëllime bujqësore.

Në të njëjtën kohë u realizua kaskada e hidrocentraleve për të siguruar kërkesën e shqiptarëve për energji. Rrjedha e ujit të Drinit ka pësuar ndryshime të mëdha pas ndërtimit të digave të mëdha në rrjedhën e sipërme në fillim të viteve 1970, pas shfrytëzimit të tepërt të zhavorrit në zonën e rrjedhës së poshtme të digës kryesore në Vaun e Dejës dhe së fundi nga ndërtimi i hidrocentralit në Ashtë, shih 13. Ky i fundit e ndryshoi lumin e mëparshëm të gërshetuar në një të ashtuquajtur sistem lumor të degëzuar duke ndryshuar rrjedhat ujore, vendin e sedimenteve dhe duke pakësuar habitatet tipike (Schwarz, 2009).




Figura 13: Rrjedha e lumit Drin dhe Gjadër para devijimit në vitin 1848 dhe kaskada e hidrocentralit të Drinit duke përfshirë hidrocentralin e lumit në Ashtë (INFRASTRUKTUR & UMWELT, 2013)

Sot, kapaciteti hidraulik i shtratit të lumit aktual dhe të fushave të tij aluvionale natyrale lejojnë vetëm kalimin e përmbytjeve të vogla. Në shtrirjen e parë prej 9,5 km pa digë pas bashkimit me lumin Drin, lumi i Bunës ka një kapacitet transporti maksimumi 1500 m³/s (Mott MacDonald, 2012a). 32 km e poshtëm deri në deltën e Bunës janë të mbrojtura nga pritrat dhe kanë një kapacitet prej 2200 m³/s. Shkarkimi mesatar vjetor i lumenjve Drin-Bunë është rreth 680 m³/s, nga të cilat 360 m³/s vijnë nga vetë Drini dhe 320 m³/s nga Buna - nga Liqeni i Shkodrës (Mott MacDonald, 2011). Përmbytjet mesatare deri në të mëdha kanë sjellë dëme të mëdha nga përmbytjet edhe në të kaluarën.

Gjithashtu, krahas rrjedhave natyrore të ujit, zona është modifikuar në mënyrë të konsiderueshme nga njerëzit me qëllim rritimin e ultësirës me anë të kullimit dhe ujitjes intensive. Sistemi i kullimit në vetvete mund të konsiderohet si një sistem i menaxhimit të ujërave nëntokësore i cili lidhet me menaxhimin e përmbytjeve në rastet e niveleve të larta të ujit. Sistemi luan një rol të rëndësishëm në rrjedhën e ujit dhe çlirimin e presionit dhe mbron tokën dhe shtëpitë në të gjithë zonën nga rritja e ujërave nëntokësore. Kur sipërfaqja e zonës përmbytet në mënyrë hidraulike, kanalet më të vogla kulluese kanë një ndikim të vogël në rrjedhën e ujit sipërfaqësor. Kanalet kryesore që të çojnë drejt detit (nëpërmjet kanalit të Murtemzës në liqenin e Vilunit) mund të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e shkarkimit nga zona e ultësirës drejt detit dhe në këtë mënyrë të zvogëlojnë grumbullimin e ujit të përmbytjeve në fushën e Trushit (Mott MacDonald, 2012b).

Tabela 1 rendit disa nga ndërhyrjet kryesore nga dora e njeriut në ultësirën Drin-Bunë, shih gjithashtu Mott McDonald, 2012a.

Tabela 1: Projektimi i niveleve të kurorës së digave (Mott MacDonald, 2012a)

Lumi	Vendndodhja	Niveli i projektimit
Lumi i Drinit	Ashtë	19.0
	Juban	18,38 - 16,15
	Vukatanë	13,7 – 12,25
Lumi i Bunës	Shirq	8.5
	KK5	7.5
	Belaj	6.5
	Pentar	6.2
	Luarz	5.1
	Rec	4.8
	Pulaj	3.6
Kolektori i Murtemzës	Cas	6.5
	Viluni	5,24 - 4,15

Ky sistem përbëhet nga digat, pritat, barrierat dhe kanalet e mëdha kulluese. Këto ndodhen kryesisht përgjatë lumit të Bunës, në njësinë administrative Bushat dhe njësinë administrative Velipojë. Ndërhyrjet më të rëndësishme infrastrukturore janë pritat në njësinë administrative Dajç, kanalet primare të kullimit (kanalet K1) në Bushat, prita e Selmanaj në Velipojë, prita e Torovicës, kanali i Murtemzas në Velipojë dhe dy pritat e Casit dhe Vilunit.

Aftësia e këtij sistemi për të funksionuar si një sistem ndërveprues varet nga mirëmbajtja e kanaleve dhe pjesëve të tjera të tij. Nga përgjegjësit vendorë dhe fermerët është raportuar se për shkak të mungesës së mirëmbajtjes përmbytjet më të vogla shkaktojnë përmbytje të fushave në disa zona. Nga ana tjetër, ndërtimi i një prite në Cas për të mbrojtur tokën bujqësore në jug të kalimit të Murtemzës ka prerë zonën ujëmbajtëse dhe mund të shkaktojë pengesa shtesë.

Gjithashtu, ndryshimi i nivelit të detit është një tjetër faktor i cili ndikon në pjesën jugore të ultësirës Drin-Bunë. Fenomeni i erozionit detar është i dukshëm përgjatë bregut të lagunës së Vilunit deri në rrjedhën fundore të lumit të Bunës. Përgjatë bregut, hyrja e detit është rreth 2 metra veçanërisht afër deltës së lumit të Bunës. Për shkak të këtij avancimi të detit, humbja e bregut mund të jetë shumë më shumë dramatike se sa llogaritjet mesatare të 50 viteve të fundit të cilat e llogarisin 500 metra. Një nga faktorët të cilët favorizojnë avancimin e detit drejt tokës dhe intensifikimin e erozionit është bllokimi i aluvioneve të cilat vinin nga lumi Drin dhe ndërtimi i hidrocentraleve në shtratin e tij (REC, 2006).

Hydrocentrali i planifikuar i Skavicës

Nëse do të ndryshojë dhe si do të ndryshojë situata kur të përfundojë hydrocentrali i planifikuar i Skavicës në zonën e rrjedhës së sipërme të basenit të lumit Drin në afërsi të kufirit në veri të Malit të Zi nuk mund të vlerësohet ende. Pritet të mos ketë ndikime negative në riskun nga përmbytjet, duke pasur parasysh këtë fakt në procedurat e planifikimit dhe operimit. Planifikimi i detajuar për ndërtimin e tij filloi në vitin 2021 me investigime teknike, ndërtim paraprak të rrugëve dhe vlerësime për ndikimin mjedisor dhe social. HEC i Skavicës do të rregullojë centralet ekzistuese në kaskadën e Drinit dhe do të rrisë prodhimin vendas të energjisë elektrike nga hidrocentralet në Shqipëri. Sipas objektivave të publikuara të projektit, liqeni do të kontribuojë në minimizimin e përmbytjeve në zonën e Shkodrës, duke optimizuar kaskadën dhe duke kontrolluar të gjithë rrjedhën dhe shkarkimet gjatë periudhës së reshjeve nga vjeshta në pranverë.

2.3 Përmbytje të konsiderueshme që kanë ndodhur në të shkuarën

Ultësira Drin-Bunë në qarkun veriperëndimor të Shkodrës në Shqipëri rrezikohet nga përmbytjet e mëdha të cilat kanë ndodhur shpesh në vitet e shkuara dhe të cilat mund të bëhen më të shpeshta dhe intensive për shkak të ndryshimeve klimatike në rajon (shih kapitullin 2.5). Përmbytjet e rënda në qarkun e Shkodrës janë pasojë e kombinimit të faktorëve nga njeriu dhe natyra. Si shkaktarë të përmbytjeve të mëdha në ultësirën Drin-Bunë, disa studime listojnë aspekte të ndryshme, të cilat së bashku mund të çojnë në një situatë krize. Këto janë

faktorët natyrorë:

- reshjet e dendura dhe për një kohë të gjatë në stinën e dimrit shpesh së bashku me
- shkrirjen e dëborës në fund të dimrit / fillim të pranverës e cila shkakton përmbytje në lumin e Bunës, Drinit, Kirit dhe në liqenin e Shkodrës,
- zjarret të cilat dëmtojnë bimësinë në zonën e basenit.

faktorët njerëzorë:

- rritja e përdorimit të tokës vulnerabël (bujqësia, shtëpitë dhe vendbanimet, objektet ekonomike etj.) në zonat e rrezikuara nga përmbytjet që prej vitit 1950,
- ndryshimet strukturore (shpyllëzimi, përdorimi i dobët i tokës) në të gjithë zonën e basenit të cilat çojnë në shkarkime më të shpejta dhe të mëdha në degët e lumenjve të zonës së basenit,
- çlirimi i papritur i sasive të mëdha të ujit nga liqenet e hidrocentraleve, dhe
- mosfunksionimi si duhet i sistemit të kullimit në ultësirë.

Që prej disa dekadash, dëmtimi i madh i mbulimit të bimësisë në të gjithë zonën e basenit (shpyllëzimi, zjarret, mbikullotja, përdorimi i dobët i tokës etj.) ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e valëve të shkarkimit dhe të përmbytjeve. Zjarret natyrore dhe të shkaktuara nga dora e


njeriut në të gjithë qarkun sjellin pasoja negative gjatë përmytjeve, jo në zonën me risk, por në basenin lumor.

Brenda zonës së ultësirës, ndryshimet në strukturën e pronësisë së tokës (fragmentimi i tokës bujqësore) pas viteve '90 kanë sjellë dëme serioze në skemat e ujitjes dhe kullimit, të cilat janë një nga përbërësit e sistemit ekzistues të mbrojtjes nga përmytjet. Për shkak të mosmirëmbajtjes së sistemeve, veçanërisht kanalet e kullimit të nivelit të parë dhe të dytë nuk funksionojnë siç duhet (p.sh. kanalet nuk pastrohen ose janë bllokuar nga ndërtime pa leje) - sistemi i kullimit është në gjendje shumë të keqe (Mott MacDonald, 2011).

Në rast përmytjesh, uji mund të qëndrojë në fushën aluvionale duke filluar nga disa orë deri në disa javë. E para ndodh në rast se përmytja shkaktohet nga përmytje të menjëhershme, kur përmytja vjen nga reshje të dendura të përqendruara në një zonë të vogël. Kur rrjedhja është shumë e madhe, por volumi i ujit është krahasimisht i vogël. E fundit ndodh rregullisht nga përmytjet nga lumenjtë, veçanërisht gjatë dimrit dhe pranverës, kur periudha e reshjeve është më e gjatë apo nga shkrija e borës në të gjithë basenin lumor. Niveli i ujit i liqenit të Shkodrës rritet deri në 3 metra gjatë sezoneve të përmytjeve.

Përmytjet e fundit të mëdha në janar/ dhjetor 2010, mars 2018 dhe janar-shkurt 2021 rezultuan në humbje të mëdha ekonomike dhe mjedisore. Zona e dëmtuar e prodhimeve bujqësore në total ishte 2023,5 hektarë, e shkaktuar nga përmytjet në mars 2018. Vlera e llogaritur e dëmit ishte 303,730,000 Lekë. Për përmytjet në janar-shkurt 2021 vlera e llogaritur e dëmit ishte 801,700,000 Lekë në njësitë administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Rrethina dhe Velipojë.⁹

Në përmytjen e janarit të vitit 2010, ngarkesa ujore në Bunë ishte rreth 3600 m³/s (3000 m³/s vinin nga lumi i Drinit). Kjo përmytje u shkaktua kryesisht nga shkrija e borës në basenin e lumit Drin. Informacion i detajuar rreth ndikimeve të kësaj ngjarjeje mund të gjendet në raportin e DREF (Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Shoqatat e Gjysmëhënës së Kuqe) 2011¹⁰ dhe Mott MacDonald (2012b).



⁹ Për më shumë informacion shih http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/prvendim_demet_nga_permbytjet_3867.pdf

¹⁰ Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Shoqatat e Gjysmëhënës së Kuqe SHQIPËRIA: PËRMYTJET E SHKODRËS, 6 qershor 2011; <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/Albania%20MDRAL003dfr.pdf>

Figura 14: Përmbytjet e mëdha historike që prej vitit 1851¹¹ [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT bazuar në Mott MacDonald, 2012a, e modifikuar]

Edhe më dramatike ishte përmbytja e dhjetorit të vitit 2010, ku kishte reshje të dendura nga java e dytë e nëntorit deri në mes të dhjetorit. Gjatë kësaj periudhe, në qarkun e Shkodrës ranë rreth 900 mm reshje shiu, e cila është sa gjysma e reshjeve mesatare vjetore. Niveli i ujit të liqenit të Shkodrës arriti nivelin maksimal historik të regjistruar dhe ngarkesa ujore në Bunë ishte më e lartë se 4000 m³/s. Përmbytja ishte një nga përmbytjet më të mëdha të mbajtura mend për sa i përket shtrirjes hapësinore, thellësisë dhe kohëzgjatjes (Mott MacDonald, 2011).

Kaskada e hidrocentraleve, e përbërë nga tre liqene dhe diga të njëpasnjëshme (Fierzë, Komani dhe Vau i Dejës), shërben për prodhimin e energjisë elektrike. Autoriteti i digave synon të mbajë nivele të larta të ujit në liqene gjatë gjithë vitit. Ky kombinim nuk rrit riskun e përmbytjes nga përmbytjet natyrore në rrjedhën e poshtme, përveç rasteve kur duhen shkarkuar sasi të mëdha të ujit të depozituar ose për të ulur nivelin e ujit të liqeneve si një masë paraprake për gatishmërinë e rritjes së prurjes në liqen ose në rast se duhet të hapen portat pasi arrihet niveli maksimal i ujit si në dhjetor të vitit 2010.

Prurjet nga aktivitetet e shkarkimit nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, KESH, në mars 2018 ishin më të moderuara krahasuar me shkarkimet e pakontrolluara dhe të keqmenaxhuara në janar dhe dhjetor 2010. Në krahasim me përmbytjet e vitit 2010, nuk u shkaktuan përmbytje të rënda edhe pse sasia e reshjeve në mars 2018 ishte 54% më e lartë se reshjet e janarit të vitit 2010, dhe 10% më e lartë krahasuar me sasinë e reshjeve të dhjetorit të vitit 2010. (energjia, 2018)

Gjatë përmbytjeve të periudhës janar-shkurt 2021, reshjet në total në qarkun e Shkodrës kaluan 120 mm në 24 orë – reshje shumë intensive që shkaktuan rritje të ndjeshme të prurjeve të lumit Drin-Buna. Prurjet e Drin-Bunës dhe liqenit të Shkodrës ishin në nivelin e tyre maksimal. Një monitorim periodik në terren në mëngjesin e datës 13 janar 2021 vlerësoi 6,42 m në Dajç, 8,70 m në liqenin e Shkodrës dhe 7,05 m në hidrometrin e lumit Drin. (Bota Sot, 2021) Përmbytjet e periudhës janar-shkurt 2021 zgjatën 60 ditë.

2.4 Veprimet/investimet madhore për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në zonën e projektit

Gjatë viteve të fundit janë kryer disa investime të rëndësishme në zonën e projektit, ose për të parandaluar përmbytjet, ose si aktivitet menaxhimin e situatës pas fatkeqësisë. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të investimeve kombëtare për mbrojtjen ndaj përmbytjeve dhe

¹¹ Bazuar në të dhënat e disponueshme – nuk janë dokumentuar përmbytje të tjera të mëdha që prej vitit 1851

menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet. Përshkrimi gjithëpërfshirës i masave për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në kapitullin 0 tregon gjithashtu masat me statuse të ndryshme zbatimi, sipas skemave të raportimit të BE-së / procesit CIS.

Tabela 2: Investimet e rëndësishme të fundit në zonën e projektit (listë e përzgjedhur)

Nr.	Njësia Administrative	Viti i investimit	Përshkrimi i investimit
1.	Dajç	2015	Ndërtimi i argjinaturës në Darragjat
2.	Shkodër	2015	Studim projektimi për ndërtimin e bajpasit në pjesën perëndimore
3.	Lagjja Nr.1 NjA. Shkodër	2015	Ndërtimi i ujësjellësit zooteknik – Shtëpia e Mushkajës
4.	Guri i Zi	2015	Rindërtimi i argjinaturës dhe lidhja me urën e Spatharës
5.	Shkodër	2015	Ndërtimi i lotit 1 të bajpasit në pjesën perëndimore
6.	Shkodër	2015	Ndërtimi i lotit 2 të bajpasit në pjesën perëndimore
7.	Ana e Malit	2015	Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare në fshatin Obot
8.	Shkodër	2015	Pajisje laboratorike për fakultetin e shkencave të natyrës (fizikë, kimi, biologji) të Universitetit të Shkodrës
9.	Bërdicë	2015	Rindërtimi i shkollës fillore në fshatin Berdicë e Madhe
10.	Bërdicë	2015	Punime në nënstationin elektrik për furnizimin me ujë në Trush
11.		2016	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të bardha në Kir
12.	Dajç	2016	Riparimi i argjinaturës Darragjati, në shtrirjen e lumit 1465-1550
13.	Shkodër	2017	Ndërtimi i godinës së re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër
14.	Shkodër	2017	Ndërtimi i godinës së re të Gjykatës së Apelit Shkodër
15.	Ana e Malit	2018	Mbrojtja nga erozioni i lumit të Bunës në fshatin Oblikë
16.	Bërdicë	2018	Rindërtimi i rrugës Shkodër-Velipojë (segmenti i harkut të Bërdicës, kryqëzimi i Baksit)
17.	Velipojë	2019	Rehabilitimi i argjinaturës së lumit Buna
18.	NjA. Shkodër	2019	Furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të përdorura në Shkodër
19.	Bërdicë	2019	Rindërtimi i rrugës në harkun e Berdicës
20.	Shkodër	2019	Rindërtimi i sheshit të Shirokës në breg të liqenit
21.	Shkodër	2020	Ndërtimi i rrugës së bajpasit në pjesën perëndimore të Shkodrës, loti I
22.	Shkodër	2020	Ndërtimi i rrugës së bajpasit në pjesën perëndimore të Shkodrës, loti II
23.	Shkodër	2020	Ndërtimi i rrugës së bajpasit në pjesën perëndimore të Shkodrës, loti III

Projektet ndërkombëtare / projektet e financimit

Plani i MRP-së është një nga të parët e llojit të tij që zhvillohet në Shqipëri. Zhvillimi i planit të MRP-së është integruar në programin “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike përmes

menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në Ballkanin Perëndimor” (CCAWB) në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Projekti parashikon tre fusha kryesore, duke përfshirë mbështetjen institucionale për aktorët kombëtarë dhe vendorë të basenit të lumit Drin në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut. Plani i MRP-së shënon fazën përfundimtare të projektit dhjetëvjeçar (2012-2021). Krahas kontributeve të tjera të rëndësishme, ky projekt rezultoi në një bashkëpunim ndërkufitar gjatë zhvillimit të HRrRP-ve (të disponueshme nga marsi i vitit 2022).

Projekti i UNDP-së “Menaxhimi i integruar ndërkufitar dhe i qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike të rrezikut nga përmbytjet në basenin e lumit Drin në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi)” 2019 - 2024, i financuar nga Fondi për Përshtatje të UNDP-së, synon po ashtu të ndihmojë vendet ripariane në zbatimin e një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në basene lumore.

Kjo përfshin

- Forcimin e rrjetit hidrometrik të monitorimit dhe të kapacitetit të modelimit të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet;
- Forcimin e kuadrit të politikave dhe të financimit të riskut për MRP;
- Investime rezistente ndaj klimës dhe me kosto efektive në mbrojtjen nga përmbytjet dhe masat për zvogëlimin e riskut (masat strukturore dhe jostrukturore të MRP-së);
- Rritjen e ndërgjegjësimit, kapacitetit të reagimit dhe përshtatjes së njerëzve duke përfshirë angazhimin e sektorit privat.

Përveç kësaj, disa projekte të tjera të rëndësishme për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet të cilat janë zbatuar në të shkuarën dhe vlejné për t'u përmendur, që lidhen me basenin e lumit Drin-Bunë në Shqipëri janë:

- “Fatkeqësitë nuk njohin kufij”, projekt i programit IPA CBC Mal i Zi dhe Shqipëri, 2014-2020, i cili synon mbrojtje më të mirë për njerëzit e zonës së prekur nga rreziqet, të tilla si rreziqet nga përmbytjet, përmes ngritjes së kapaciteteve, rritjes së ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit ndërkufitar për të zvogëluar riskun nga fatkeqësitë.
- “Analiza gjithëpërfshirëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sistemin e menaxhimit të bujqësisë në Shqipëri”, një rezultat i projektit të FAO-s “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe forcimi i rimëkëmbjes së fermerëve nga rreziqet natyrore në Ballkanin Perëndimor”, 2016-2017, i cili vlerësoi kuadrin ligjor dhe ndër-institucional për vlerësimin e riskut në Shqipëri në lidhje me ndikimin në sektorin bujqësor. Ky raport nënvizon disa nga rekomandimet e bëra në studimin e vitit 2014 për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet (shih më poshtë).

- Qeveria e Shqipërisë, e mbështetur financiarisht nga Banka Botërore, në kuadër të projektit “Zbutja dhe Përshtatja e Rrezikut nga Fatkeqësitë”, 2008-2013, nisi një program për studimin e menaxhimit të përmbytjeve dhe punët rehabilituese. Në këtë kontekst, janë rregulluar, ngritur dhe forcuar disa prita të ndërtuara për mbrojtjen nga përmbytjet përgjatë lumit të Bunës.
- Në një hap të mëvonshëm, është kryer një studim gjithëpërfshirës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, i autorizuar nga Banka Botërore. Qëllimi kryesor i studimit “Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për basenin e lumenjve Drin dhe Bunë” i cili u krye nga kompania konsulente ndërkombëtare Mott MacDonald, ishte të tregonte masat për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zvogëlimin e dëmit nga përmbytjet në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Masat e propozuara janë kryesisht të një natyre teknike dhe kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemit teknik të mbrojtjes nga përmbytjet në vende të ndryshme në zonën e rrezikuar nga përmbytjet (forcimi dhe ndërtimi i ri i pritave, kanaleve kulluese dhe stacioneve të pompimit). Por masat afatmesme të propozuara mbulojnë gjithashtu aspekte të zvogëlimit të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet (si p.sh. nga ndërtesa të përshtatura). Informacion më i detajuar rreth çështjeve teknike mund të gjendet në raportin përfundimtar të studimit, Mott MacDonald, 2012a.
- Në kuadër të projektit CCAWB të GIZ, është kryer një studim për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet për qarkun e Shkodrës (në vijim: Studimi MRP 2014) në vitin 2014. Gjatë disa konsultimeve midis grupeve të interesit në nivel vendor, me mbështetje të ekspertëve u zhvillua një draft për vlerësimin e riskut dhe planin e masave. Ky plan për MRP bazohet në studimin e MRP të vitit 2014.

2.5 Ndikimi i ndryshimeve klimatike në rajon

Për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në rajon, është analizuar progresi i temperaturës, reshjeve, erërave dhe ngjarjet ekstreme të motit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, në kuadër të Komunikimit të Tretë Kombëtar të Republikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike (KTK) drejtuar KKKBNK-së¹². Rezultati tregohet në skenarët e ndryshimeve klimatike¹³. Në krahasim me vitin 1990, projeksionet shfaqin temperatura vjetore në rritje, ulje vjetore të reshjeve vjetore dhe një rritje të nivelit të detit.

¹² Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Me mbështetjen e UNDP dhe GEF, KTK është publikuar dhe është dorëzuar në KKKBNK në qershor 2016.

¹³ Modelimi për modelet e temperaturës dhe reshjeve bazohet në rreze të ulët (50 km x 50 km).




Figura 15: Projektimet për reshjet vjetore [mm] pa dhe me ndryshimet klimatike (skenari mesatar) në rajonin bregdetar verior të Shqipërisë (KTK, 2016)

Sipas projekteve, reshjet vjetore do të jenë rreth 1300 mm për rajonin bregdetar verior. Edhe pse projektohet një rënie, pritet një ndryshueshmëri e lartë siç shihet në fushën gri të shfaqur te Figura 15.

Reshjet e dendura pritet të intensifikohen. Projektimet tregojnë se do të ketë një rritje të reshjeve të rrezikshme për qarkun e Shkodrës për rreth 1-2 ditë deri në vitin 2030, rreth 2-3 ditë deri në vitin 2050, 4-5 ditë deri në vitin 2100 në krahasim me vitin 1990. Projektimet e reshjeve 24-orëshe, siç shihen në tabelën e mëposhtme, rezultojnë mbi vlerat kufi që cilat konsiderohen të rrezikshme dhe në gjendje të shkaktojnë dëm ekonomik. Në projekte, nivelet e lumenjve në pjesët e sipërme të basenit pritet të rriten për shkak të rritjes së nivelit të detit, duke përkeqësuar riskun për përmbytje, ku sasi të mëdha të tokave bujqësore të punueshme parashikohet të bëhen të papërdorshme për shkak të rritjes së nivelit të lartë të kripës. Shtimi i tendencës së shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve të dendura mund të përkeqësojë cenueshmërinë e qarkut të Shkodrës ndaj përmbytjeve, duke kërkuar strategji afatgjata. (KTK, 2016)

Tabela 3: Reshjet 24-orëshe të pritshme në [mm] për periudha të ndryshme përsëritjeje për rajonin verior të Shqipërisë (KTK, 2016, i miratuar)

	Periudha e përsëritjes		
	10 vjet	50 vjet	100 vjet
Reshjet [mm]	158 ± 14	215 ± 21	239 ± 25

Temperaturat vjetore pritet të rriten deri në 15,9°C në veri të Shqipërisë. Deri në vitin 2100, temperatura vjetore ka të ngjarë të rritet deri në 17,8°C. Kjo nënkupton zvogëlimin e sasisë së reshjeve të borës dhe pritet shkrije e hershme e cila pritet të ndikojë në modelet e rrjedhës, si p.sh. reduktimi në pranverë dhe zhvendosja e vlerave maksimale gjatë muajve

të dimrit, pra, përmbytjet në dimër dhe thatësitrat në verë po bëhen gjithmonë e më të pranishme në Shqipëri (KTK, 2016).

2.6 Popullsia, shpërndarja gjinore, minoritetet dhe grupet e marginalizuara

Aktualisht, zona e projektit ka një popullsi totale rreth 139,000 banorë. Teksa bashkia e Shkodrës numëron rreth 125,000 banorë (89,2%), pjesa e mbetur numëron rreth 14,000 banorë të cilët jetojnë në bashkinë e Vaut të Dejës.

Krahasuar në nivel të njësive administrative, Njësia Administrative Shkodër është e populluar me më shumë se gjysma e popullsisë së zonës së projektit (rreth 77,000 banorë). Si rrjedhojë, njësitë administrative të Rrethinës (15,2%) dhe Bushatit (10,2%) përbëjnë popullsinë e dytë dhe të tretë më të madhe. Njësitë administrative më të vogla janë Ana e Malit dhe Dajçi me rreth 3900 banorë secila (shih Tabela 4).

Tabela 4: Popullsia rezidente sipas gjinisë, grupmoshës dhe njësisë administrative sipas të dhënave të censusit 2011 nga INSTAT

Njësia Administrative	Gjinia dhe grupmosha						Totali i njësive administrative	Përqindja e të gjithë popullsisë
	Mashkull			Femër				
	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+		
Bashkia Shkodër								
Ana e Malit	380	1249	280	372	1290	287	3858	≈ 2,8%
Bërdicë	661	1919	343	593	1891	366	5773	≈ 4,2%
Dajç.	310	1244	331	285	1354	361	3885	≈ 2,8%
Guri i Zi	946	2677	444	952	2567	499	8085	≈ 5,8%
Rrethinat	2870	6708	1040	2632	6836	1113	21199	≈ 15,2%
Shkodër	7823	25072	4735	7080	27034	5331	77075	≈ 55,4%
Velipojë	550	1662	310	494	1693	322	5031	≈ 3,6%
Bashkia e Vaut të Dejës								
Bushat	1473	4601	983	1409	4664	1019	14149	≈ 10,2%
Shuma	15013	45132	8466	13817	47329	9298		139 055
Përqindja e gjithë popullsisë	≈ 10,8%	≈ 32,5%	≈ 6,1%	≈ 10,0%	≈ 34,0%	≈ 6,7%		100%

Tabela 4 paraqet shpërndarjen e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës në zonën e projektit. Shpërndarja ndërmjet banorëve meshkuj dhe femra është përgjithësisht e barabartë. Sipas moshës, tek të rinjtë rezidentë deri në 14 vjeç vërehet një mbizotrim i lehtë i meshkujve, ndërsa me rritjen e moshës ka një rritje në numrin e femrave. Gjatë viteve të fundit, numri i përgjithshëm i banorëve është ulur, me një rritje diskrete të përqindjes së banorëve femra.




Figura 16: Zhvillimi demografik sipas gjinisë bazuar në popullsinë më 1 janar në periudhën 2016-2021 në qarkun e Shkodrës bazuar në të dhënat e INSTAT.

Në zonën e projektit, ka një pjesë e cila vlen të përmendet, me minoritete dhe grupe të marginalizuara. Kjo përfshin komunitetet rome në përgjithësi dhe ato të shpërngulura nga zonat malore. Shpërndarja e këtyre grupeve u nënshtrohet forcave dinamike dhe të nxitura nga luhatjet. Kështu që vlerësimi sasior i riskut për këto grupe njerëzish vulnerabël dhe për shtëpitë e tyre është shumë i vështirë dhe ai u nënshtrohet ndryshimeve të rregullta.

Aktualisht, ka një total prej rreth 170 familjesh të vendosura rreth zonës urbane, liqenit të Shkodrës dhe bregut të lumin Drin. Burimi kryesor i të ardhurave të tyre është grumbullimi dhe tregtimi i materialeve të ripërdorshme ose të riciklueshme nga mbetjet të tilla si metalet, letra, kartoni dhe plastika, krahas lëmshës dhe bamirësisë. Si vendbanime kryesisht informale, shërbimet publike që u ofrohen këtyre komuniteteve janë të pjesshme dhe po ashtu edhe instrumentet për parandalimin e riskut. Ato përfshihen rralë në sistemet e informacionit publik. Megjithatë, rreth 130 fëmijë nga këto familje frekuentojnë shkollën.

Përveç këtij informacioni të përgjithshëm mbi popullsinë në zonën e projektit, shihni edhe kapitullin 4.4.2 për më shumë informacion në lidhje me rrezikun nga përmbytjet të popullsisë dhe të këtyre grupeve vulnerabël. Kapitulli 4.4.2 jep informacion shtesë rreth shtëpive dhe vendbanimeve të popullsisë që preken.


2.7 Përdorimi i tokës dhe aktivitet ekonomike në zonën e projektit

Kategoritë kryesore të përdorimit të tokës në zonën e projektit tregohen tek Tabela 5 dhe në figurën përkatëse: thuajse gjysma e zonës së projektit (49%) në qarkun e Shkodrës klasifikohet si tokë e kultivuar. Një e katërta (25%) është kullotë. Pak më shumë se 10% është e mbuluar me zona vendbanimi. Pjesa më e madhe e mbetur është ujë, pyll, tokë kënetore dhe shkëmb. Vetëm 1% e sipërfaqes totale përdoret për infrastrukturën e trafikut dhe transportit dhe 1% për përdorimin industrial të tokës.

Rreth 40% e sipërfaqes totale është e rrezikuar nga përmbytjet. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së prirur për përmbytje është tokë e kultivuar dhe 25-30% e vendbanimeve, dhe toka për përdorim industrial është gjithashtu e rrezikuar nga përmbytjet. Për vlerësime të detajuara dhe informacion rreth tokës që potencialisht preket, si dhe për objektet në risk shihni kapitullin 4.4.1.

Tabela 5: Përdorimi i tokës totale në qarkun e Shkodrës

Kategoria e përdorimit të tokës	Sipërfaqja e përdorimit të tokës [ha]
tokë e kultivuar	22538
kullotë	11407
vendbanim	5055
ujë	2204
pyll	1244
kënetë	1221
gur	858
trafiku dhe transporti	603
industria	544
të tjera	106
vend parkimi	60
Totali	45840



Aktiviteti ekonomik në qarkun e Shkodrës dominohet nga bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, gjë e cila pasqyrohet në numrin e sipërmarrjeve aktive dhe të dhënat e përdorimit të tokës. Përdorimi i tokës është analizuar bazuar në grupin e të dhënave evropiane Corine për mbulesën e tokës (2012), e përmirësuar nga të dhënat Copernicus të Atlasit Urban (2012) dhe harta Open Street.

Qarku i Shkodrës me afërsinë e tij në liqenin e Shkodrës është një destinacion i njohur turistik për turistët vendas dhe të huaj. Ardhja e shtetasve të huaj është rritur vazhdimisht nga viti 2014 deri në vitin 2021 sipas INSTAT (me përjashtim të një rënieje në vitin 2020

dhe rimëkëmbjes së mëvonshme në 2021, për shkak të pandemisë së CODIV). Pra, infrastruktura turistike është rritur vazhdimisht në zonat përreth Shkodrës dhe Velipojës - shpesh urbanizim i pakontrolluar dhe i paqëndrueshëm në zonën e përmbytjeve (Miho, 2018).

2.8 Përdorimi i tokës dhe ndryshimet në përdorimin e tokës në basenin lumor

Prej dekadash, lumenjtë dhe përrenjtë në basenin lumor Drin/Bunë dhe përdorimi i tokës në zonat e tyre ujëmbledhëse i janë nënshtruar ndryshimeve të përgjithshme të shkaktuara nga kultivimi, vendbanimet, ndërtimi i infrastrukturës dhe shpyllëzimi, si dhe për pasojë nga erozioni. Duke qenë se sipërfaqja e tokës dhe sistemet lumore të pjesëve të mëdha të basenit lumor kanë qenë të ekspozuara ndaj ndërhyrjeve të gjera në të kaluarën, këto ndryshime në zonat ujëmbledhëse janë pjesë e shkaqeve të ngjarjeve ekstreme dhe ndikimeve të përgjegjësive njerëzore. Ndërhyrja në lumenj (ngushtimi), mbulimi i sipërfaqeve të tokës, përdorimi intensiv i tokës bujqësore, konsolidimi i tokës bujqësore dhe dëmtimi i pyjeve (si dhe prerja e pemëve) janë vetëm disa shembuj. Pasojat e këtyre ndërhyrjeve njerëzore në peizazhin në situatën e rrjedhës dhe rreziku i përmbytjeve kanë qenë objekt studimi, por ato vetëm mund të vlerësohen. Për shkak të shumëllojshmërisë së proceseve të përfshira dhe ndërveprimeve të tyre, ka vetëm vlerësime sesa ka ndryshuar situata e përmbytjeve si rezultat i këtyre ndikimeve dhe i këtyre ndërhyrjeve. Megjithatë, mund të thuhet se ndryshimet e përdorimit të tokës dhe trajtimi i tokës dhe i degëve të lumenjve mund të kenë ndikime të konsiderueshme në ndryshimet e bilanceve ujore dhe situatën e rrjedhjes në basen. Kështu, zvogëlimi i objekteve mbajtëse në përrenj dhe sipërfaqen e basenit, i shkaktuar nga ndryshimi i përdorimit të tokës, dheut, erozioni dhe shpyllëzimi janë pjesë e menaxhimit më të gjerë të rrezikut nga përmbytjet në basenin e lumit.

Tabela 6 dhe Figura 7 tregojnë përdorimin e tokës të basenit lumor Drin-Bunë sipas rezultateve të vlerësimit nga të dhënat e mbulimit të tokës Corine dhe të dhënat e Copernicus 2016.

Tabela 6: Përdorimi i tokës në basenin lumor Drin-Bunë (gjeneruar nga CLC 2012 dhe Copernicus 2016)

Përdorimi i tokës	Totali		Maqedoni		Kosovë		Shqipëri		Mal i Zi	
	km ²	%	km ²	%	km ²	%	km ²	%	km ²	%
Strukturë urbane	351.5	1,0%	32.7	1,0%	103.9	2,3%	115.2	1,5%	99.7	2,2%
Zonë industriale	36.5	0,08%	2.6	0,08%	21.6	0,47%	2.5	0,03%	9.8	0,21%
Infrastruktura e transportit	9.8	0,02%	0.7	0,02%	4.4	0,10%	2.9	0,04%	1.8	0,04%
Përdorime të tjera të tokës urbane	15.8	0,1%	1.7	0,1%	7.5	0,2%	0.7	0,01%	5.9	0,1%
Bujqësi	4718.9	16,9%	554.5	16,9%	717.2	15,6%	1466.2	18,7%	1981.0	42,7%
Pyje	6728.9	38,4%	1258.8	38,4%	1665.6	36,1%	2263.4	28,8%	1541.2	33,2%
Bimësi jo-pyjore	5958.4	28,8%	944.7	28,8%	1248.8	27,1%	2866.6	36,5%	898.2	19,4%
Trupa ujqorë	1316.9	14,0%	458.4	14,0%	409.2	8,9%	430.8	5,5%	18.5	0,4%
Tjetër	1231.7	0,7%	21.9	0,7%	431.0	9,4%	698.8	8,9%	80.0	1,7%
Totali	20368,5	100,0%	3276.0	100,0%	4609,2	100,0%	7.847.1	100,0%	4636.1	100,0%

Përdorimi i tokës në nënbasenin e basenit lumor Drin-Bunë në Shqipëri karakterizohet kryesisht nga zona gjysmë natyrore (kullota natyrore, bimësi sklerofile, shkurre pyjore kalimtare dhe zona me bimësi të rrallë). Rreth 29% e qarkut është pyll (kryesisht pyll gjethgjerë). Kultivimi fokusohet në basenin e Bunës dhe në rajonin e liqenit të Shkodrës.

Edhe pse pyjet përbëjnë mbulimin më të madh të tokës në basenin lumor Drin-Bunë në vitin 2016, në rajon ka dy tendenca kryesore kur bëhet fjalë për ndryshimin e tokës pyjore: “shpyllëzimi dhe degradimi në disa zona (të shkaktuara nga përdorimi intensiv/i pakontrolluar, si dhe urbanizimi) dhe braktisja e tokës në zona të tjera (terren i rifitimit të pyjeve). Vëzhgimet historike me CORINE tregojnë se rezultati neto është një ndryshim minimal në mbulesën pyjore në basen midis viteve 2006 dhe 2012 (-0,5%), dhe statistikat kombëtare tregojnë rritje të sipërfaqeve pyjore gjatë periudhës 2005-2015. [...] Kur bëhet fjalë për zonat e pyllëzuara, statistikat e vendit raportojnë tendenca të ndryshme: ato janë të qëndrueshme në Maqedoninë e Veriut, në rritje në Mal të Zi dhe Kosovë (sipas një raporti të fundit) dhe në rënie në Shqipëri.” (GWP 2020, Raport tematik mbi ndërlidhjen e burimeve)¹⁴.

Ekzistojnë prova historike dhe shkencore se ndryshimi i përdorimit të tokës në basenin lumor Drin-Bunë ndikon drejtpërdrejt në ndryshimet negative të kores së tokës dhe të dheut, të cilat shkaktojnë erozion dhe për pasojë bëhen shkaktarë të vërshimeve të forta dhe bartës të aluvioneve. Potencialisht, kjo shkakton përmbytje të shpejta kryesisht në basenet më të vogla të degëve të lumenjve, por mund të ketë edhe efekte akumulimi në zonën e projektit të qarkut të Shkodrës.

¹⁴ Partneriteti Global për Ujin (GWP), Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Vijës Ujore Ndërkufitare: Grupi i Punës për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Raport tematik mbi ndërlidhjen e burimeve (Faza I e vlerësimit të lidhjes ujë-ushqim-energji-ekosistem të basenit të Drinit), Gjenevë 2020 (faqe 23)




Figura 17: Harta e përdorimit të tokës të basenit lumor Drin-Bunë [grafiku: INFRASTRUKTUR & UMWELT bazuar në të dhënat evropiane me burim të hapur Copernicus dhe CORINE]

2.9 Planifikimi i territorit në zonën ripariane të basenit lumor Drin-Bunë

Planifikimi i territorit është një instrument i rëndësishëm për mbrojtjen dhe parandalimin e përmbytjeve. Duke u fokusuar në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, janë kryesisht katër kërkesa të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të planeve të zhvillimit:

- Mbajtja pastër e sistemit të kullimit: Mbrojtja afatgjatë e sipërfaqes për zonat ujëmbledhëse; asnjë ndërtim në zonat që janë të nevojshme për shkarkim;
- Zvogëlimi i riskut: Zhvillimi i zonave të ndërtimit është në përputhje me rrezikun nga përmbytjet (brenda dhe jashtë fushave kryesore aluvionale)
- Infrastruktura e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet: Shqyrtimi i procedurave të planifikimit rajonal/urban; mbrojtja e tokës për ndërtimin e këtyre infrastrukturave
- Mbledhja në ujëmbledhës: Rregullimi i përdorimit të tokës dhe izolimi, mbrojtja e zonave ujëmbajtëse

Si rrjedhojë, gjatë planifikimit të përdorimit të tokës në qark dhe zhvillimit të territorit, duhet të aplikohen të dhënat dhe informacioni i nxjerrë nga hartat e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet, pasi ato kanë një implikim jo vetëm në planifikimin për përshtatjen dhe menaxhimin e përmbytjeve, por gjithashtu në planifikimin e integruar të territorit.

Planifikimi i territorit i Shqipërisë bazohet në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, me sa më poshtë:

- Ligji nr. 73/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”
- Ligji nr. 28/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”
- Ligji nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”
- Ligji nr. 119/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”

Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, i ndryshuar, plotëson kuadrin rregullator për planifikimin e territorit në Republikën e Shqipërisë.

Figura 8 jep një panoramë të sistemit të planifikimit të territorit në nivel kombëtar dhe lokal. Në të gjitha nivelet, planifikimi i territorit koordinohet dhe mbështetet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT). AKPT është institucion i nivelit qendror sipas ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. AKPT-ja koordinon dokumentet e planifikimit në nivel vendor dhe qendror në mënyrë që të sigurojë që planet e përgjithshme vendore (PPV) të jenë në përputhje me planet e tjera sektoriale, të tilla si plani MRP. AKPT mundëson koordinimin ndërinstytucional duke përfshirë AMBU-në dhe të tjerë. Çdo lloj plani sektorial i hartuar apo i miratuar nga çdo ministri apo agjenci tjetër duhet të jetë në përputhje me ligjin nr. 107/2014.




Figura 18: Sistemi i planifikimit të territorit i Shqipërisë në nivel kombëtar dhe vendor (PPK, 2016)

Përmbajtja e detyrueshme për çdo lloj plani territorial, nga niveli kombëtar deri në nivelin vendor, rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”. Sipas kësaj VKM-je nr. 686, neni 26, pika 3, germa "c", Plani për mbrojtjen e mjedisit përfshin:

- parashikimet për mbrojtjen e peizazhit;

- parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e trupave ujorë;
- parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra, dhe
- parashikimet për zgjidhjen e problematikës mjedisore dhe vatrave të evidentuara, sipas rastit.

Specifikimet për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet gjenden në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër (PPV Shkodër, 2017). PPV për bashkinë Shkodër parashikon pesë objektiva strategjike ku njëra prej tyre në veçanti përcakton mbrojtjen e mjedisit dhe aftësinë për t'u përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore si pikë kryesore të zhvillimit të bashkisë për vitet e ardhshme.

Kërcënimi nga rreziqet natyrore si përmbytjet, erozioni dhe rrëshqitja e dheut janë të njohura. Kështu, tetë programe të ndryshme strategjike synojnë mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturave mbrojtëse ekzistuese kundër rreziqeve natyrore për të arritur objektivin strategjik. Këto programe janë si më poshtë:

- Programi Strategjik OS5PS1: Mbrojtja e mjedisit
- Programi Strategjik OS5PS2: Mbrojtja nga përmbytjet
- Programi Strategjik OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane
- Programi Strategjik OS5PS4: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja
- Programi Strategjik OS5PS5: Qendra e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet
- Programi Strategjik OS5PS6: Menaxhimi i rreziqeve natyrore
- Programi Strategjik OS5PS7: Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave
- Programi Strategjik OS5PS8: Ndryshimet klimatike

PPV Shkodër (2017) identifikon dy objektiva kryesore të cilat dukshëm lehtësojnë pasojat negative nga përmbytjet. Këto janë, nga njëra anë, ura e re në lumin e Bunës e cila lidh rrugën kombëtare SH1 nga qyteti i Shkodrës në Velipojë me rrugën kombëtare SH41 me kufirin malazez, e cila përbën një pikë ndërlidhëse të rëndësishme ndërkufitare; dhe nga ana tjetër, ndërtimin hidroteknik si bajpasi në pjesën perëndimore të Shkodrës, i cili në fakt u nis për të mbrojtur qytetin e Shkodrës nga përmbytjet (f. 90-91). Siç shihet në foton e mëposhtme, nuk ka mbrojtje të dukshme nga përmbytjet nga bajpasi.



Figura 19: Pamje e bajpasit perëndimor (në ndërtim) të qytetit të Shkodrës [foto: INFRASTRUKTUR & UMWELT]



Figura 20: Pamje e Urës së Re e cila lidh SH1 dhe SH41 me kufirin malazez [foto: INFRASTRUKTUR & UMWELT]

Nga kjo pikënisje, PPV identifikon masa parandaluese për konsiderim në lidhje me përmbytjet (f. 93):

- Konsultimi me inxhinierët ekspertë për të vlerësuar dy ndërtimet (Urën e re në lumin e Bunës dhe bajpasin në perëndim të Shkodrës) për të zbutur pasojat negative që vijnë në rast përmbytjeje




Figura 21: Vendndodhja e zonave të mundshme të ndërhyrjes në peizazh (PPV Shkodër, 2017, f. 59)

Veçanërisht për zonat nënurbane në jug të Shkodrës, PPV Shkodër (2017) përcakton konceptin e mëposhtëm ndërtimor si të rëndësishëm (f. 93-94):

- Ngritja e nivelit të katit përdhes në përputhje me rregulloret përkatëse për të garantuar aksesueshmërinë nga të gjithë
- Rritja e zonave të gjelbra që mund të sakrifikohen në raste përbytyjesh
- Gjelbërim dhe rregullim peizazhi për të mbajtur dhe infiltruar ujin e reshjeve në zonën mbajtëse larg qendrës ose për të drejtuar ujërat e përbytyjeve drejt vendeve të posaçme të caktuara për përbytyje
- Rrethimi i ndërtesave për mbrojtjen e tyre, p.sh. me anë të mureve kufizuese të papërshkueshme nga uji.

Gjithashtu, PPV Shkodër (2017) përcakton ndërhyrje në peizazh (Figura 21) të cilat përfshijnë ndërlidhjen strategjike të kufijve të qytetit të Shkodrës me trupat ujorë përkatës të qarkut, në veçanti me liqenin e Shkodrës, Drinin dhe lumin e Bunës. Katër zona janë identifikuar që përfitojnë nga transformimi në peizazhe multifunkionale në lidhje me ujin (f. 58):

- Zona e digës në bajpasin perëndimor
- Peizazhi lumor
- Bregu i liqenit
- Zona e përbytyjeve.

2.10 Zonat e mbrojtura

E gjithë zona e projektit në deltën e lumit të Bunës njihet kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht si zonë e mbrojtur. Ajo është gjithashtu një zonë ndërkufitare e mbrojtur e cila ndahet me Malin e Zi. Delta e Bunës bashkë me liqenin e Shkodrës është një zonë Ramsar e njohur ndërkombëtarisht, e përcaktuar në vitin 2006. Përcaktimi Ramsar aludon në mënyrë specifike lumin e Bunës, pyjet e lagështa, kënetat e ujërave të ëmbla dhe kullotat e lagështa. Kërcënimet kryesore për zonën e listuar në citimin Ramsar përfshijnë bonifikimin e tokës nëpërmjet kullimit, zhvillimit për bujqësinë dhe ndryshimet në regjimin e ujit. Llojet e bimëve të cituara në Ramsar përfshijnë dymbëdhjetë specie të rrezikuara, dymbëdhjetë specie vulnerabël dhe dhjetë specie të rralla. Ai gjithashtu mbështet 36 specie kafshësh të kërcënuara globalisht. Këneta e Domnit ngjitur me Kolektorin e Murtemzës njihet gjithashtu ndërkombëtarisht si një zonë e rëndësishme e shpendëve (Mott MacDonald, 2012a). Plani i mbrojtjes së biodiversitetit i bashkisë Shkodër (2017) thekson nëpërmjet miratimit të tij nga Këshilli Bashkiak, përdorimin e detyrueshëm të qëndrueshëm të zonave të përcaktuara si zona të mbrojtura për hir të ruajtjes së biodiversitetit.

Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” përcakton gjashtë kategori për menaxhimin e zonave të mbrojtura për mbrojtjen e habitateve apo specieve në përputhje me Bashkimin Ndërkombëtar për

Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Për të gjithë zonën përreth deltës së Bunës dhe liqenit të Shkodrës aplikohen kategoritë III, IV dhe V (PMBL, 2019):

- **Kategoria IV Rezervë natyrore e menaxhuar/ Park Natyror:** Liqeni i Shkodrës (26,535.00 ha)
- **Kategoria V Peizazh i mbrojtur:** Lumi Buna – Velipojë (23,027.00 ha)

Liqeni i Shkodrës si 'Rezervë natyrore e menaxhuar / Zonë e menaxhimit të habitateve dhe specieve të kategorisë IV është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 684 më 02.11.2005, ndërsa zona përreth deltës së Bunës (Lumi Buna - Velipojë) si një “peizazh i mbrojtur” i kategorisë V është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 682 më 02.11.2015.

Neni 9 i ligjit nr. 81/2017 përcakton objektivat për të gjitha zonat e mbrojtura mjedisore brenda ligjit. Neni 9e shpreh për shembull ndalimin e çdo "ndryshimi të gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të ligatinave".

Një status i tillë e bën të detyrueshëm vlerësimin e ndikimit në mjedis për çdo ndërhyrje në zonë, si në planifikim, ashtu edhe në investime. Kjo ndikon veçanërisht në planifikimin e masave për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen nga përmbytjet në lumin e Bunës, që janë pjesë e rregullave më të rrepta të mbrojtjes.

Situata e zonave të mbrojtura sipas direktivës kuadër të BE-së për ujin, për basenin lumor Drin-Bunë, përfshin jo vetëm zonat e sipërpërmendura të përcaktuara për mbrojtjen e habitateve apo specieve, por gjithashtu:

- **Zonat e mbrojtura sanitare:** Aktualisht, pusët që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm nga kompania e ujësjellësit dhe pusët private nuk janë të regjistruara si zona mbrojtëse sanitare për ujin e pijshëm. Kjo vlen për disa puse në zonat e projektit të tilla si pusët në Trush/Velipojë, Badica Zogaj, Badica Zues dhe në Oblikë. (PMBL, 2019)
- **Zona të përcaktuara për mbrojtjen e specieve ujore me rëndësi ekonomike:** Autoriteti përgjegjës është MBZHR, e cila nuk ka shpallur zona të mbrojtura peshkimi por ka përcaktuar dy zona bashkëmenaxhimi për të garantuar përdorim të qëndrueshëm të burimeve të peshkimit dhe për të mbrojtur biodiversitetin ujor, konkretisht liqenin e Shkodrës dhe liqenin e Ohrit (Liqeni i Ohrit nuk është pjesë e zonës së projektit). (PMBL, 2019)
- **Trupat ujorë të përcaktuar si ujëra rekreative dhe për banja plazhi:** Shpallja e zonave për banja plazhi është detyrë e qeverisë vendore, Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit; gjithashtu, menaxhimi i zonës është përgjegjësi e tyre. Në distriktin e basenit lumor Drin-Bunë, zonat kryesore të plazhit janë plazhi i Velipojës, plazhi i Shëngjinit (plazhi i Shëngjinit nuk është pjesë e zonës së projektit) dhe plazhi i Shirokës (Shirokë-Zogaj) (PMBL, 2019).




Figura 22: Hartë e zonës së mbrojtur në zonën e projektit (MM, 2005)

Shqipëria nuk ka transpozuar direktivën e BE-së për nitratat (91/676/KEE). Në vend të saj, ligji shqiptar i referohet ligjit nr. 9244/2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” dhe ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. I pari synon mbrojtjen e burimeve ujore nga inputet bujqësore, ndërsa i fundit përcakton përgjegjësitë institucionale të tilla si ngarkimi me përgjegjësi i AMBU-së për mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja bujqësore. (PMBL, 2019)

3 Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet

3.1 Metodologjia

Në përgjithësi, identifikimi i zonave me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet (ZRRPKP) ndjek tre hapa kryesorë të punës, të cilët janë në përputhje me proceset që ndjekin shtetet anëtare të BE-së:

1. Përcaktimi i rrjetit lumor fillestar: rrjeti lumor gjenerohet nga modelet digjitale të lartësisë (MDL) së basenit lumor, dhe nga verifikimi i të dhënave ekzistuese të rrjeteve lumore (të disponueshme vetëm për disa pjesë). Gjithashtu, verifikimi me të dhënat e gjeneruara nga harta Open Street (OSM) dhe me imazhet satelitore ka siguruar saktësinë e tyre. I gjithë rrjeti lumor përkatës përpunohet në një projekt GIS dhe vlerësohet për t'u përdorur për procesin e mëtejshëm të filtrimit.
2. Përcaktimi i rrjetit lumor i cili mund të jetë i rrezikuar nga përmbytjet (duke filtruar shtrirjet jo relevante lumore sipas kriterëve negative si madhësia e zonës ujëmbledhëse, gjatësia e shtrirjes apo karakteristikat e brigjeve të lumenjve apo fushave aluvionale (shumë të pjerrëta apo kanione, vetëm përdorime 100% të tokës rurale). Këtu pragu për zonën ujëmbledhëse përkatëse është përcaktuar duke përdorur një model 50 km², 30 km², 20 km² dhe 10 km². Rezultatet tregojnë se karakteristikat e basenit lumor Drin-Bunë 50 dhe 30 km² e zvogëlojnë rrjetin shumë, në mënyrë që përmbytjet lumore të kaluara të mos mbulohen. Pragu prej 10 km² rezulton në një rrjet lumor që përfshin shumë shtrirje që janë të thata për pjesën më të madhe të vitit. Në këtë mënyrë, 20 km² u përcaktuan si pragu i përshtatshëm për shtrirjet e lumenjve. Megjithatë, janë vlerësuar edhe pjesë më të vogla të lumit. Të gjitha përmbytjet përgjatë shtrirjes së lumenjve me ujëmbledhës < 20 km² mund të përkufizohen si përmbytje të shpejta apo reshje të dendura, ndërsa > 20 km² përkufizohen si përmbytje lumore.
3. Vlerësimi i rrjetit të mbetur të lumenjve për sa i përket aseteve të rrezikuara që preken potencialisht (për jetën ekonomike, njerëzore, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin), përdorimet e tokës apo rreziku i ndotjes në rast përmbytjesh dhe krahasimi me kriteret e miratuara të përcaktimit të nivelit të riskut. Rezultatet janë

shtrirjet e lumenjve në rrezik potencial, të quajtura: “zonat me rrezik potencialisht të konsiderueshëm nga përmytjet” (ZRRPKP).




Figura 23: Hapat e punës së vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmytjet për identifikimin e zonave me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmytjet (VPRRP, 2018)

Cilësia e hapave të veçantë varet jashtëzakonisht shumë nga të dhënat në dispozicion dhe informacionet e tjera. Direktiva e BE-së për përmytjet shpreh se vetëm informacionet dhe të dhënat ekzistuese përdoren për vlerësimin. Nuk është kryer asnjë modelim për VPRRP.

Përcaktimi i zonave me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmytjet bazohet në analizën e pjesëve të lumenjve (apo liqeneve), për të cilat, duke u bazuar në ngjarjet e kaluara, duhet të priten dëme të shtuara duke u bazuar në shtrirjen e rrjetit lumor ku përmytjet mund të sjellin pasoja negative për jetën e njerëzve, ekonominë, ekologjinë apo trashëgiminë kulturore.

Për asetet e vetme të rrezikuara, rëndësia e riskut verifikohet hap pas hapi. Hapat tregohet vizualisht në skemën e mëposhtme (Figura 24):

Për hapat e vlerësimit, përdoren kriteret e përcaktimit të nivelit të riskut sipas Tabela 9 të cilat mbulojnë të gjitha asetet e rrezikuara. Çdo hap (A-C si te Figura 24) lidhet me një kriter. Si rrjedhojë, rreziku potencial i konsiderueshëm në çdo zonë kontrollohet dhe dokumentohet sistematikisht me kriteret përkatëse në fletët informative. Shihni raportin e detajuar të VPRRP (2018) për këto fletë informative.




Figura 24: Hapat për vlerësimin e rreziqeve potenciale të konsiderueshme (VPRRP, 2018)

3.2 Llojet e konsideruara të përmbytjeve

Llojet e mëposhtme të përmbytjeve (apo: “burimet e përmbytjeve”) mund të konsiderohen gjatë identifikimit të zonave me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet në vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet (sipas udhëzimit të BE-së në direktivën e BE-së për përmbytjet; BE 2013; Raporti teknik (2013-071) (Tabela 7).

Fokusi i vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet u dakordësua të jetë në rreziqet e mundshme që rezultojnë nga përmbytjet përgjatë ujërave sipërfaqësore nga lumenjtë apo përrenjtë (përmbytje me origjinë fluviale). Llojet e tjera të mundshme të përmbytjeve të marra në konsideratë janë si më poshtë:

Përmbytjet me origjinë pluviale/ nga reshjet e dendura / të shpejta (gjithashtu: përmbytjet e rrëmbyeshme)

Për basenin lumor Drin-Bunë, përmbytjet me origjinë pluviale nuk janë modeluar dhe si rrjedhojë, vlerësimi sistematik i riskut nuk është ende i mundur bazuar në informacionin ekzistues. Por për shkak të rëndësisë së kësaj lloji përmbytjeje, si rrjedhojë e rritjes së dëmeve të shkaktuara gjatë viteve të fundit, të paktën rastet e përmbytjeve të shpejta të kaluara janë dokumentuar dhe konsideruar gjatë vlerësimit të zonave me risk potencial. Nëse ngjarjet e kaluara përsëritëse godasin një vendndodhje apo një qark, ky do të quhet rrezik i konsiderueshëm në lidhje me VPRRP.

Përcaktimi i përmbytjeve të shpejta në kontekstin e VPRRP bazohet në karakteristikat e vendndodhjes specifike ku ndodh përmbytja: nëse madhësia e zonës ujëmbledhëse që kullon ujin në këtë vend është < 20 km², dhe nëse nuk ekziston një lum apo përrua i përhershëm, kjo përkufizohet si një ngjarje e shkaktuar nga reshjet e dendura apo si përmbytje e shpejtë. Nëse zona ujëmbledhëse është > 20 km² dhe ekziston një lum apo përrua i përhershëm, përkufizohet si përmbytje lumore.

Tabela 7: Llojet e përmbytjeve / burimeve (nga: Udhëzimet për raportim sipas direktivës së BE-së për përmbytjet; BE 2013)

Lloji/ Burimi	Përshkrimi
Fluviale (lumore)	Përmbytje e tokës e shkaktuar nga ujëra që vijnë nga një pjesë e një sistemi kullimi natyror, duke përfshirë kanalet natyrore apo të modifikuara të kullimit. Ky burim mund të përfshijë përmbytjet nga lumenjtë, përrrenjtë, kanalet e kullimit, vërshimet e përrrenjve malorë dhe rrjedhat ujore të përkohshme, liqenet dhe përmbytjet që krijohen nga shkrija e borës.
Pluviale (nga shiu)	Përmbytje e tokës e shkaktuar drejtpërdrejt nga ujërat e shiut që bien apo qëndrojnë mbi tokë. Ky burim mund të përfshijë ujërat e stuhisë në qytet, rrjedhën tokësore rurale apo ujin e tepërt, ose përmbytjet tokësore që vijnë nga shkrija e borës.
Ujërat nëntokësore	Përmbytje e tokës nga ujërat nga nëntoka që ngrihen mbi sipërfaqen e tokës. Ky burim mund të përfshijë rritjen e nivelit të ujërave nëntokësore dhe të rrjedhës nëntokësore nga ujërat sipërfaqësore të lartë.
Uji i detit	Përmbytje e tokës nga uji i detit, grykëderdhjet apo liqenet bregdetare. Ky burim mund të përfshijë përmbytje nga deti (p.sh. niveli ekstrem i baticës dhe/ose stuhitë detare) apo përmbytje të cilat vijnë nga veprimi i valëve ose cunami bregdetar.
Infrastruktura ujëmbajtëse artificiale	Përmbytje e tokës nga ujëra të cilat vijnë nga infrastruktura ujëmbajtëse artificiale apo dëmtimi i infrastrukturave të tilla. Ky burim mund të përfshijë përmbytje të cilat vijnë nga sistemet e kanalizimeve (duke përfshirë ujin e stuhisë, kanalizimet e kombinuara apo të bllokuara), sistemet e ujësjellësit dhe të trajtimit të ujërave të ndotura, kanalet artificiale të lundrimit dhe bllokimet (p.sh. digat dhe rezervuarët).

Ujërat nëntokësore

Rreziqet nga ujërat nëntokësore shpesh ndodhin në zonat fushore, moçalore apo livadhe që në të njëjtën kohë përmbyten rregullisht nga lumenjtë (përmbytje lumore). Si rrjedhojë, zonat me risk potencial janë identifikuar tashmë nën përmbytjet lumore. Nëse sipërfaqe të mëdha të cilat nuk përmbyten nga lumenjtë, por janë përmbytur vetëm nga ujërat nëntokësore, dhe nëse këto ngjarje janë regjistruar, ato zona dokumentohen dhe vlerësohen gjithashtu sipas kritereve të përcaktimit të nivelit të riskut.

Uji i detit / përmbytjet bregdetare

Në basenin lumor Drin-Bunë, grykëderdhja e Bunës, ku lumenjtë Drin-Bunë derdhen në detin Adriatik, rreziku nga përmbytjet bregdetare është i madh. Nga përvoja vendase dhe dokumentacioni, përmbytjet përgjatë bregdetit nuk shkaktohen nga vetë uji i detit, por nga kombinimi i përmbytjeve lumore (nga lumi Buna) dhe niveleve të larta të ujit të detit. Burimet e rrezikut nga përmbytjet vijnë nga lumenjtë bregdetarë që nuk mund të derdhen në det për shkak të niveleve të larta të ujit të detit. Ndaj, nuk mund të identifikohen zona me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet vetëm me anë të rrezikut nga uji i detit.

Infrastruktura ujëmbajtëse artificiale

Rreziku i çarjes së digave konsiderohet si rrezik i ulët, sepse probabiliteti i çarjes së digave është më i ulët se 1/10.000, sipas projektit të digave dhe studimeve mbi çarjet e digave. Krahasuar me probabilitetin e përmbytjeve lumore (1/100, 1/500) ky nuk mund të quhet probabilitet i madh në metodologjinë e VPRRP për përcaktimin e ZRRPKP për MRP. Megjithatë, është diskutuar dhe duhet theksuar se ekziston një rrezik për çarjen e digave përreth dhe poshtë digave të shumta në rrjedhën e lumit Drin-Bunë, veçanërisht në Shqipëri. Ky risk duhet të vlerësohet rregullisht (studime për rrezikun e çarjes së digave) dhe të merret parasysh në planet e mirëmbajtjes dhe në skenarët e menaxhimit të riskut.

Efektet prapavepruese të menaxhimit të liqeneve në rrjedhën përpara liqeneve (rritja e niveleve të ujit në bjefin e sipërm si pasojë e konsumit të vogël të ujit në HEC-e në stinët e lagështa) konsiderohen si përmbytje lumore për shkak të rritjes së nivelit të liqenit/rezervuarit.

Efektet e menaxhimit të liqeneve në rrjedhën e poshtme (shkarkimi i ujit nga liqenet në situatat e përmbytjeve) konsiderohen gjithashtu në përmbytjet lumore, sepse kanalet në bjefin e poshtëm të liqeneve janë gjithashtu në fokus të rrezikut nga përmbytjet lumore poshtë digave.

Kanalet e kullimit (si në zonën e Shkodrës apo në zonën e deltës të lumenjve Drin-Bunë) konsiderohen si përmbytje lumore, pasi ato janë të lidhura ngushtë me nivelet e ujit dhe përmbytjet në kanalet kryesore të Drinit/Bunës dhe nuk krijojnë zona të tjera risku.

3.3 Rëndësia e rrezikut nga përmbytjet

Sipas specifikimeve të direktivës së BE-së për përmbytjet, katër grupe asetesh në rrezik duhet të konsiderohen në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe në vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet. Vlerësimi i riskut dhe masat vijuese për zvogëlimin e riskut duhet të synojnë të katër grupet e receptorëve dhe sipas treguesve (Tabela 8 dhe Tabela 9):

Tabela 8: Receptorët e riskut dhe treguesit e riskut (VPRRP, 2018)

Rreziku te:	Shembull i treguesve të rrezikut nga përmbytjet:
Shëndeti i njeriut	<ul style="list-style-type: none"> Numri i pronave për banim. Shërbimet kritike (spitalet, policia/zjarrfikësja/ambulanca, shkollat, azilet, etj.).
Aktiviteti ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> Numri i pronave jo për banim. Gjatësia e rrugës ose e hekurudhës. Sipërfaqja e tokës bujqësore.
Mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> Vendet e përcaktuara (zonat e mbrojtura ujore, zonat me substanca ndotëse për ujin) dhe flora/fauna sipas direktivës së BE-së për habitatet
Trashëgimia kulturore	<ul style="list-style-type: none"> Vendet e trashëgimisë kulturore (vende të trashëgimisë botërore).

Asetet në rrezik u përcaktuan për të identifikuar rreziqet potenciale të konsiderueshme për të gjithë receptorët e riskut. Kriteret e përcaktimit të nivelit të riskut dhe pragu përcaktojnë atë që identifikohet si "potencial i konsiderueshëm" (shih Tabela 9).

Tabela 9: Kriteret e përcaktimit të nivelit të riskut për VPRRP (VPRRP, 2018)

Assets at risk & significance criteria for PFRA	Receptors				Significance Criteria	Threshold of significance
	Human health	Economic activity	Environ- ment	Cultural heritage		
A) Human health, economic values						
<i>No. of houses</i>	x	x			existing objects or area in the flood area of the extreme event	≥10
<i>Settlement area</i>	x	x				≥0,5 ha
<i>Industrial objects</i>		x				≥1
<i>industrial area</i>		x				≥0,5 ha
<i>Critical / explicitly valuable agriculture assets</i>		x				case to case
B) Environmental risks						
B1) Water polluting substances / sites						
<i>Contaminated sites</i>			x		existing objects at risk (extreme event scenario)	≥1
<i>Locations that deal with such substances</i>			x			≥1
B2) : Protected areas (according to WRRL)						
<i>Protected areas (e.g. Natura 2000 etc.)</i>			x		existing assets at risk (extreme event scenario)	≥1
<i>Drinking Water supply areas</i>	x		x			≥1
<i>Bathing waters</i>	x					≥1
C) Risk for cultural heritage sites						
<i>UNESCO heritage sites</i>				x	existing assets at risk (extreme event scenario)	≥1
<i>Other relevant cultural heritage sites</i>				x		≥1

Për të gjitha zonat ku janë vëzhguar përmbytjet dhe ku rreziqet nga përmbytjet janë të pritshme, janë kryer vlerësime për të vlerësuar nëse rreziku për një nga receptorët tejkalon pragun (=i konsiderueshëm) ose jo (=jo i konsiderueshëm).

3.4 Rezultatet e VPRRP për zonën e projektit

Figura e mëposhtme, Figura 5 jep një pasqyrë të zonave të vlerësuara si rezultat i ekzaminimit të të gjithë rrjetit lumor në basenin lumor Drin-Bunë në lidhje me ngjarjet e kaluara dhe me njohuritë vendore mbi rreziqet potenciale.

Nga të gjitha vlerësimet e shtrirjeve të lumenjve, 43 zona u vlerësuan si zona me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet (ZRRPKP). 33 prej tyre përmbushën kriteret e përcaktimit të nivelit të riskut (ngjyra e kuqe në hartë). 10 prej tyre sapo kanë arritur kriteret e përcaktimit të nivelit të riskut, por u identifikuan si ZRRPKP sipas metodologjisë. Veçanërisht për to, përcaktimi si ZRRPKP mund të ekzaminohet dhe shqyrtohet në mënyrë kritike bazuar në vlerësime më të detajuara të riskut brenda planit të HRRRP dhe MRP.

Figura 5 jep një pasqyrë të zonave në të gjithë basenin e lumit Drin-Bunë dhe Tabela 10 ilustron ZRRPKP të zonës së projektit. Informacioni dhe të dhënat e detajuara për këto ZRRPKP janë të dokumentuara në fletët informuese në Shtojcën 4 të VPRRP (2018).




Figura 25: Paraqitja gjeografike (harta) e ZRRPKP në basenin lumor Drin-Bunë duke përfshirë Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, dhe Shqipërinë (VPRRP, 2018)

Tabela 10: Zonat me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet në Shqipëri në basenit lumor Drin-Bunë (AL-4 deri në AL-7 për zonën e projektit) (VPRRP, 2018)

Nr.	Shteti - nr.	Vendndodhja	Lum / Liqen	Lloji i përmbytjes	ZRRPK P
1.	AL - 1	Dibër	Drini i Zi	Përmbytje lumore	X
2.	AL - 2	Kukës	Drini i Zi	Menaxhimi i liqeneve të HEC	X
3.	AL - 3	Tropojë	Lumi i Valbonës (Dega e Drinit)	Përmbytje e shpejtë	X

Nr.	Shteti - nr.	Vendndodhja	Lum / Liqen	Lloji i përmbytjes	ZRRPK P
4.	AL - 4	Qyteti i Shkodrës	Lumi i Kirit	Përmbytje lumore	XX
	AL - 5	Liçeni i Shkodrës / Qyteti i Shkodrës, zona e Rrethinës	Liçeni i Shkodrës	Përmbytje liqenore	XX
5.	AL - 6	Qarku i Shkodrës	Drin, Buna	Përmbytje lumore	XX
6.	AL - 7	Lezhë	Lumi i vjetër i Drinit	Përmbytje lumore	XX

Shpjegime:

XX	ZRRPKP / Rreziku tejkalon ndjeshëm vlerën e 2 ose më shumë kritereve të përcaktimit të nivelit të riskut
X	ZRRPKP / Rreziku tejkalon lehtë vlerën e 1 ose 2 kritereve të të përcaktimit të nivelit të riskut
O	Jo ZRRPKP / Rreziku nuk tejkalon vlerën e kritereve të përcaktimit të nivelit të riskut
	Nuk është vlerësuar në këtë studim; cituar këtu për të plotësuar informacionin (burimi: Raporti i VPRRP Greqi; AEM, 2018)

Rreziku i prishjes së digës nuk është përfshirë në vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet, për shkak të përcaktimit të rrezikut të konsiderueshëm nga përmbytjet dhe periudhës së përsëritjes: prishja e digës ndjek një përkufizim tjetër të skenarëve të avarisë. Referojuni kapitullit 4.5 për rrezikun potencial nga digat/hidrocentralet, si në rajonin Koman-Vau i Dejës, brenda dhe jashtë zonës së projektit.

4 Vlerësimi i rrezikut nga përmbytjet në zonën e projektit

4.1 Rëndësia e përmbytjeve të kaluara për të ardhmen

Në kapitullin 2.3 janë listuar dhe përshkruar përmbytjet më të rëndësishme të kaluara. Gjatë vlerësimit të rrezikut nga përmbytjet në zonë dhe gjatë rishikimit të ngjarjeve të kaluara, mund të thuhet se ngjarje të ngjashme me atë të vitit 2010 apo të viteve të fundit, mund të ndodhin sërish në të ardhmen. Duke pasur parasysh ndikimet e pritshme të ndryshimeve klimatike (shih kapitullin 2.5) situata hidrometeorologjike do t'i bëjë përmbytjet lumore dhe përmbytjet si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm edhe më të mundshme, për sa i përket periudhave më të shkurtra të përsëritjes dhe intensitetit. Projektimet tregojnë se do të ketë një rritje të reshjeve të rrezikshme për qarkun e Shkodrës për rreth 1-2 ditë deri në vitin 2030, rreth 2-3 ditë deri në vitin 2050, 4-5 ditë deri në vitin 2100 në krahasim me vitin 1990 (TNC, 2016).

Duke qenë se përmbytja e vitit 2010 u ndikua ndjeshëm nga vala e përmbytjes që vinte nga zonat në rrjedhën e sipërme të basenit të lumit Drin¹⁵, eksperiencia e vitit 2010 mund të parandalohet apo të zbutet, kur mund të sigurohen skema operimi dhe parashikime më të sakta për rrethana të ngjashme në të ardhmen. Megjithatë, për sa kohë që skemat e parashikimit të përmbytjeve të konsiderueshme dhe përmirësimi i operimit i bazuar në parashikime nuk kryhet, situata të përmbytjeve si në vitin 2010 mund të ndodhin në të

¹⁵ Përmbytja nga veriu në drejtim të lindjes me origjinë nga baseni i lumit të Bunës, liçeni i Shkodrës dhe funksionimi i digave me domosdoshmërinë e shkarkimit të ujit në nivel maksimal, pasi degët kanë sjellë nivele të larta të ujit.

ardhmen dhe duhet të konsiderohen të ndodhin më shpesh dhe me intensitet më të lartë gjatë zhvillimit të masave për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet për zonat në rrezik.

Për sa i përket përmbytjeve të tjera të fundit, mund të supozohet se ato mund të ndodhin përsëri në të ardhmen me të njëjtën shtrirje apo më intensive, dhe mbi të gjitha më shpesh. Edhe pse janë kryer investime të rëndësishme për përmirësimin e brigjeve të lumenjve dhe pastrimin e vijave ujore, nuk u realizuan dot masa të mëdha apo themelore për mbrojtjen nga përmbytjet, të cilat mund të ndryshojnë ndjeshëm situatën e rrezikut në krahasim me përmbytjet e fundit. Pasojat negative të ndryshimeve klimatike mund të rrisin potencialisht rrezikun nga përmbytjet në zonë në krahasim me ngjarjet e shkuara.

4.2 Hartat e rrezikut nga përmbytjet

Hartat e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet janë një bazë e rëndësishme informacioni për të gjitha aktivitetet për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe për grupet e ndryshme të përdoruesve për të zvogëluar riskun dhe dëmet e shkaktuara nga përmbytjet. Ky plan i MRP-së bazohet në hartat më të fundit të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet, të cilat janë krijuar për zonën e projektit në vitin 2022. Përmbajtja, skenarët, qasjet e modelimit dhe metodat e hartëzimit përshkruhen në detaj në "Udhërrëfyesin për hartëzimin e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet për basenin lumor Drin-Bunë", i cili u hartua në kuadër të projektit CCAWB të GIZ, GIZ dhe grupit teknik të punës me ekspertë nga të katër shtetet të cilat ndajnë basenin e lumit Drin.

Përmbajtja e hartave të rrezikut nga përmbytjet është përcaktuar sipas direktivës së BE-së për përmbytjet (Parlamenti Evropian dhe Këshilli 2007):

"Kapitulli III Hartat e rreziqeve dhe risqeve nga përmbytjet"

Neni 6

3. Hartat e rrezikut nga përmbytjet mbulojnë zonat gjeografike të cilat mund të përmythen sipas skenarëve të mëposhtëm:

- (a) përmbytje me probabilitet të ulët, apo skenarë të ngjarjeve ekstreme;
- (b) përmbytje me probabilitet mesatar (periudha e mundshme e përsëritjes \geq 100 vjet);
- (c) përmbytje me probabilitet të lartë, sipas rastit.

4. Për çdo skenar të përmendur në paragrafin 3, jepen elementet e mëposhtme:

- (a) shkalla e përmytjes;
- (b) thellësia e ujit apo niveli i ujit, sipas rastit;
- (c) sipas rastit, shpejtësia e rrjedhës apo rrjedha përkatëse e ujit."




Figura 26: Hartat e rrezikut nga përmbytjet për qarkun e Shkodrës (2021): tre llojet e hartave sipas direktivës së BE-së për përmbytjet dhe dy lloje shtesë sipas ligjit kombëtar




Figura 27: Përmbajtja / legjenda e hartave të rrezikut nga përmbytjet

Për të tre skenarët, hartat e rrezikut nga përmbytjet kapin shkallën e përmbytjes, thellësinë e përmbytjes dhe sipas rastit shpejtësinë e përmbytjes (Neni 6 i direktivës së BE për përmbytjet, Parlamenti Evropian dhe Këshilli 2007). Këto parametra përshkruajnë intensitetin dhe natyrën e përmbytjes:

- Shkalla e përmbytjes tregon zonën e përmbytur për skenarë të ndryshëm përmbytjesh.
- Thellësia e përmbytjes tregon për shembull se deri në çfarë lartësie do të përmbytet një ndërtesë dhe se deri në çfarë kati nuk do të preken asetet dhe njerëzit nga përmbytja.
- Shpejtësia përshkruan se sa shpejt lëviz uji. Në varësi të shpejtësisë së rrjedhës mund të rritet edhe rreziku i pasojave negative në shëndetin e njerëzve, në mjedis, në trashëgiminë kulturore dhe në aktivitetet ekonomike. Në shpejtësi të larta, njerëzit dhe objektet kanë më shumë gjasa të preken nga përmbytjet. Sipas nenit 6 të direktivës së BE-së për përmbytjet, shpejtësia duhet të tregohet në hartat e rrezikut, sipas rastit, që do të thotë nëse ekzistojnë të dhëna dhe nëse shpejtësia është e madhe.

Figura 26 dhe Figura 27 tregojnë harta shembull të rrezikut nga përmbytjet të zonës së projektit të cilat janë baza e këtij plani për MRP: Tre harta me skenarë HQ10, HQ100, HQ500 u hartuan sipas direktivës së BE-së për përmbytjet; lloje shtesë me skenarë HQ50 dhe HQ200 u prodhuan sipas kërkesave kombëtare shqiptare.

4.3 Hartat e riskut nga përmbytjet

Hartat e riskut nga përmbytjet tregojnë pasojat negative të mundshme të lidhura me skenarët e përmbytjeve të përmendura në hartat e rrezikut nga përmbytjet (neni 6 i direktivës së BE-së për përmbytjet, Parlamenti Evropian dhe Këshilli 2007) dhe përshkruajnë ndikimet në shëndetin e njerëzve, në mjedis, në trashëgiminë kulturore dhe aktivitetet ekonomike:

- numri tregues i banorëve që preken potencialisht;

- lloji i aktivitetit ekonomik i zonës që preket potencialisht;
- instalimet e përmendura në shtojcën I të Direktivës së Këshillit 96/61/KE të datës 24 shtator 1996 në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes e cila mund të shkaktojë ndotje aksidentale në rast përmbytjesh dhe zonat e mbrojtura që kanë gjasa të preken të identifikuar në shtojcën IV, paragrafi 1, pika (i), (iii) dhe (v) e Direktivës 2000/60/KE;
- informacione të tjera të cilat shteti anëtar i konsideron të dobishme, të tilla si treguesit e zonave ku mund të ndodhin përmbytje me përmbajtje të lartë të sedimenteve dhe mbeturinave dhe informacione mbi burime të tjera të konsiderueshme të ndotjes.

Direktiva e BE-së për përmbytjet (Parlamenti Evropian dhe Këshilli 2007) përcakton përmbajtjen e hartave të riskut nga përmbytjet në nenin 6:

"Hartat e riskut nga përmbytjet duhet të tregojnë pasojat negative të mundshme të lidhura me skenarët e përmbytjes të përmendur në paragrafin 3 dhe të shprehur si më poshtë:

(a) numri tregues i banorëve që preken potencialisht;

(b) lloji i aktivitetit ekonomik i zonës që preket potencialisht;

(c) instalimet e përmendura në shtojcën I të Direktivës së Këshillit 96/61/KE të datës 24 shtator 1996 në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (1) e cila mund të shkaktojë ndotje aksidentale në rast përmbytjesh dhe zonat e mbrojtura që kanë gjasa të preken të identifikuar në shtojcën IV, paragrafi 1, pika (i), (iii) dhe (v) e Direktivës 2000/60/KE;

(d) informacione të tjera të cilat shteti anëtar i konsideron të dobishme, të tilla si treguesit e zonave ku mund të ndodhin përmbytje me përmbajtje të lartë të sedimenteve dhe mbeturinave dhe informacione mbi burime të tjera të konsiderueshme të ndotjes."

Figura 28 tregon një hartë shembull të riskut nga përmbytjet të zonës së projektit e cila është një nga bazat e këtij plani për MRP: Ashtu si për hartat e rrezikut nga përmbytjet, tre skenarë HQ10, HQ100, HQ500 janë hartuar sipas direktivës së BE-së për përmbytjet; llojet shpesh me skenarë HQ50 dhe HQ200 u prodhuan sipas kërkesave kombëtare shqiptare.

Hartat e riskut tregojnë të gjitha asetet e rrezikuara të njohura në zonë. Asetet jepen të listuara tek Tabela 11. Simbolet dhe ID janë emërtuar në harta. Të gjitha kategoritë kanë një nivel vulnerabël që është bazë për vlerësime të mëtejshme të cenueshmërisë. Ato janë gjithashtu pika fillestare për vlerësimin e riskut siç dokumentohet në kapitujt në vijim.




Figura 28: Hartë ilustruese e riskut nga përmbytjet për një pjesë të zonës së Shkodrës (2021)




Tabela 11: Kategoritë e objekteve të rrezikuara me vlera të cenueshmërisë (1 = e ulët, 2 = mesatare, 3 = e lartë)

Kategoria kryesore		ID (klasa)	Emri	Vlera e cenueshmërisë
100	Bujqësi	101	fidanishte, serë, ndërtesë bujqësore apo stallë	3
		102	plantacion, bujqësi, kultura të veçanta	2
		106	bagëti	2
400	Industri & Prodhim	401	aeroport, fushë aviacioni	3
		402	industri me teknologji të lartë, magazinë, fabrikë	2
500	Shërbime dhe tregti	501	restorant, kafene, bar	1
		502	hotel, bujtinë	1
		503	vend kampingu	2
		504	supermarket	2
		505	shkollë/ ndërtesë arsimit	2
		506	postë	1
		507	Komisariat policie	3
		508	qendër shëndetësore	3
		510	ujësjellës	2
		511	Kopsht fëmijësh	3
		512	administratë	3
		513	atraksion turistik, pikë informacioni	2
		514	stacion shërbimi, stacion karikimi elektrik	1
		515	antenë (radio dhe telekomunikacion)	2
		516	transformator	1
		517	trajtimi i ujërave të ndotura	2
		518	spital	3
		519	zjarrfikëse	3
		520	asgjësimi i mbetjeve	2
521	azil	3		
600	Trafiku dhe transporti	601	stacion treni	2
		606	hyrje tuneli	3
700	Funksione të ndryshme (vendbanime)	701	qendër kulturore dhe komunitare	1
		703	kishë	2
		704	trashëgimi kulturore, sit i UNESCO-s	3
		705	varreza	2
		706	banja/llixha, pishinë publike	1
		707	muze/ rrënoja	2
		708	far	1
		709	xhami	2
		710	pallat sporti	2

4.4 Përshkrimi dhe vlerësimi i rrezikut ekzistues nga përmbytjet

4.4.1. Përmbledhje: Përdorimi i tokës që preket potencialisht në zonën me risk

Një ilustrim i detajuar hartografik i bazuar te hartat e rrezikut potencial ekzistues nga përmbytjet në zonën e projektit disponohet në hartat gjithëpërfshirëse të riskut nga përmbytjet.

Përshkrimet e mëposhtme janë nxjerrë nga modelimi hidrologjik dhe kryqëzimi i tij me të dhënat e sipërpërmendura të përdorimit të tokës, censusit, ndërtesave dhe objekteve të cenushme brenda një analize statistikore (analiza GIS). Besueshmëria dhe disa korigjime janë bërë në bazë të konsultimeve me grupet e interesit, analizave të detajuara të fotove ajrore/imazheve satelitore për disa zona dhe të vizitave në terren.

Për zonën e projektit të qarkut të Shkodrës, tabela jep një pasqyrë të tokës që preket potencialisht të klasifikuar sipas përdorimit të tokës.

Tabela 12: Përdorimi i tokës në zonën potencialisht të prekur në basenin e lumit Drin të qarkut të Shkodrës

Kategoria e përdorimit të tokës	Sipërfaqja e përdorimit të tokës [ha]	Sipërfaqja e përdorimit të tokës që preket [ha]			Përqindja e përdorimit të tokës që preket [%]		
	-	HQ010	HQ100	HQ500	HQ010	HQ100	HQ500
tokë e kultivuar	22538	9485	12980	13524	42,1%	57,6%	60,0%
pyll	1244	830	960	1000	66,9%	77,1%	80,4%
kullotë	11407	970	1118	1165	8,5%	9,8%	10,2%
industria	544	70	147	160	12,9%	27,0%	29,4%
kënetë	1221	1088	1098	1100	89,1%	89,9%	90,1%
të tjera	106	11	28	31	10,0%	26,3%	29,4%
vend parkimi	60	4	6	6	7,5%	10,5%	10,8%
gur	858	91	111	118	10,6%	12,9%	13,7%
vendbanim	5055	411	1082	1174	8,1%	21,4%	23,2%
trafiku dhe transporti	603	75	166	179	12,4%	27,4%	29,7%
ujë	2204	1128	1179	1184	51,2%	53,5%	53,7%
Totali	45840	13333	17915	18643	29,1%	39,1%	40,7%

Kategoria e përdorimit të tokës që preket më shumë nga përmbytjet është toka e kultivuar - rreth 9500 ha në HQ010, 13,000 ha at HQ100 dhe 13,500 ha në HQ500 (shih Figura 29). Sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, të Bashkisë Shkodërnë qark, gjatë përmbytjes së fundit në mars 2018, toka e kultivuar dhe toka bujqësore u prekën shumë duke pësuar një dëm ekonomik prej 303,729,000 Lekë në Anën e Malit, Bërdicë, Dajç, Rrethina dhe Velipojë.

Duke shtuar kullotat për bagëtinë prej rreth 1100 ha, sipërfaqja e tokës që preket potencialisht në aktivitetet ekonomike bujqësore është përkatësisht 10,600 ha në HQ010, 13,100 ha në HQ100 dhe 13,600 ha në një skenar përmbytjeje HQ500. Në përmbytjen e dhjetorit të vitit 2010, edhe disa bagëti u rrethuan nga uji dhe u mbytën (rreth 32,634 kafshë u evakuuan).




Figura 29: Tokë e kultivuar potencialisht e përmbytur për skenarë të ndryshëm të përmbytjeve HQ010, HQ100 dhe HQ500 për çdo njësi administrative të qarkut të Shkodrës

Krahasuar me rezultatet e Studimit MRP 2014, rreziku i prodhimit të misrit ka rënë ndjeshëm, pasi nga njëra anë fermerët korrin misrin para sezonit të përmbytjeve dhe nga ana tjetër, për shembull, për njësinë administrative të Velipojës, ngritja e argjinaturës së Semanajit zbuti rrezikun nga përmbytjet.

Ekspozimi ndaj përmbytjeve është rritur për bimët zbukuruese dhe dekorative pasi ato janë shtuar në sipërfaqe, si për shembull në Anën e Malit dhe njësinë administrative Dajç. Në atë zonë është mbjellë bimësi hidrofile.

Nënkapitujt në vijim përshkruajnë situatën e rrezikut nga përmbytjet për receptorët përkatës të riskut sipas direktivës së BE-së për përmbytjet, në lidhje me shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik.

4.4.2. Shëndeti i njeriut

Për sa i përket përshkrimit të rrezikut nga përmbytjet në lidhje me receptorin e riskut "shëndeti i njeriut", rëndësi ka përcaktimi i banorëve, shtëpive dhe vendbanimeve që preken potencialisht. Ato janë si më poshtë.

Tabela 13: Banorët që preken potencialisht (nga skenarët e përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500)

Njësia Administrative	Banorët që preken		
	HQ010	HQ100	HQ500
Bashkia Shkodër			
Ana e Malit	490	510	510

Bërdicë	800	2990	3140
Dajç	700	3350	3390
Guri i Zi	340	1210	1350
Rrethinat	50	210	240
Shkodër	2730	9660	11140
Velipojë	850	1430	1690
Bashkia e Vaut të Dejës			
Bushat	470	1410	1720
Totali	6430	20770	23180
<i>Përqindja e të gjithë popullsisë (= 139,055 banorë)</i>	≈ 4,6%	≈ 14,9%	≈ 16,7%




Figura 30: Popullsia që preket potencialisht nga përmbytjet e qarkut të Shkodrës e ilustruar për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytjeje

Tabela 14: Ndërtesat që preken të prekura (nga skenarët e përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500)

Njësia Administrative	Ndërtesat që preken		
	HQ010	HQ100	HQ500
Bashkia Shkodër			
Ana e Malit	125	130	130
Bërdicë	223	830	871
Dajç	433	2065	2093
Guri i Zi	81	292	325
Rrethinat	19	88	99
Shkodër	672	2380	2743
Velipojë	770	1289	1520
Bashkia e Vaut të Dejës			
Bushat	282	856	1043
Totali	2605	7930	8824




Figura 31: Ndërtesat që preken potencialisht nga përmbytjet të qarkut të Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytjeje

Gjatë përmbytjes së dhjetorit të vitit 2010 (e konsideruar si përmbytje ekstreme) numri total i dokumentuar i banorëve të evakuuar në zonë ishte rreth 12,145 dhe numri i shtëpive të prekura ishte rreth 7120 (4540 shtëpi të përmbytura dhe 2580 shtëpi të rrethuara nga uji). Me këto të dhëna, vlerësimet GIS duken të besueshme.

Duke iu referuar të gjithë popullsisë së qarkut të Shkodrës, popullsia që preket në të gjithë skenarët e përmbytjeve është e lartë, ndonëse nga njëra anë vihet re një emigracion i lartë në zonat e Anës së Malit (fshatit Obot) dhe të Gurit të Zi (Kuç dhe Rrencë); nga ana tjetër, ndërtesat dhe banesat në vende si Bërdica dhe Dajçi janë përshtatur për të përballur përmbytjet. Aktualisht po vazhdon ngritja e themeleve të ndërtesave të reja në fshatrat Fshat i Ri, Mali i Jushit, Hoten Rranxa dhe Konej në njësinë administrative Bushat (shih kapitullin 0 për masat e tjera aktuale në vazhdim).

Ndërtimet e paligjshme dhe popullsia/grupet e veçanta vulnerabël

Shifrat e lartpërmendura bazohen në një vlerësim GIS duke mbivendosur të dhënat nga hartat OSM për ndërtesat me zonat e rrezikuara nga përmbytjet sipas 3 skenarëve. Si rrjedhojë, ato përfshijnë ndërtimet e paligjshme të cilat janë shtuar gjatë viteve të fundit, shpesh të vendosura në zonën e rrezikuar nga përmbytjet. Banesat janë shpesh shumë të cenueshme nga përmbytjet, krejtësisht të papërshtatshme për mbrojtje nga përmbytjet dhe nuk kanë asnjë veçori për të siguruar mbrojtje nga përmbytjet. Megjithatë, siç shpjegohet në kapitullin 2.6, ndërtimet e paligjshme nuk janë të mirë-dokumentuara dhe si rrjedhojë u nënshtrohen ndryshimeve.

Përfundimi më i rëndësishëm këtu është se personat që banojnë në këto vendbanime të paligjshme janë veçanërisht grupe vulnerabël (shpesh komunitetet rome në përgjithësi dhe të shpërngulurit nga zonat malore). Ato janë jashtëzakonisht të ekspozuar ndaj përmbytjeve për disa arsye:

- Vendndodhjet janë në zona të cilat përmbyten shpesh (qyteti i Shkodrës, lagjja nr. 1 dhe nr. 4 dhe njësi administrative Bërdicë)
- Banesat janë krejtësisht të paqëndrueshme gjatë përmbytjeve dhe nuk kanë mjete për t'u mbrojtur nga përmbytjet. Ato ndodhen nën nivelin e përmbytjeve dhe nuk kanë struktura të qëndrueshme.
- Situata sociale dhe ekonomike e familjeve të këtyre grupeve (komuniteteve) nuk lejon përshtatjen e aktiviteteve mbrojtëse, dhe ata as nuk kanë mjete financiare për t'u rimëkëmbur pasi janë prekur nga përmbytjet.

Këto grupe janë të vendosura përreth zonës urbane, liqenit të Shkodrës dhe bregut të lumit të Bunës (shih Figura 32). Sipas njohurive të ekspertëve vendorë, ka rreth 173 familje të cilat janë më të ekspozuara ndaj përmbytjeve (në bregun e liqenit dhe përgjatë lumit të Bunës).




Figura 32: Vendndodhja e ndërtimeve informale dhe e grupeve të marginalizuara brenda zonës së projektit, e ilustruar për skenarin e përmbytjes HQ500

Rreth 130 fëmijë nga këto familje frekuentojnë shkollën. Ka një mungesë të shërbimeve publike në këto zona të vendbanimeve informale. Nuk mund të pritët një nivel i lartë ndërgjegjësimi mbi rreziqet dhe masat mbrojtëse kundër përmbytjeve.

Asetet e rrezikuara në kategorinë e receptorit të riskut "shëndeti i njeriut"

Aspekte të tjera të rëndësishme në kategorinë e receptorit të riskut "shëndeti i njeriut" janë pjesët e infrastrukturës sociale dhe furnizimet bazë si më poshtë

- Furnizimet bazë: furnizimi me ujë
- Objekte arsimore: shkolla
- Objekte të mirëqenies sociale: kopshte fëmijësh, azile për të moshuarit
- Objekte të kujdesit shëndetësor: spitale, kujdesi shëndetësor si doktorët, qendrat e kujdesit shëndetësor, farmacitë
- Zona rekreative: Parqe dhe zona sportive.




Figura 33: Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "shëndeti i njeriut" për qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytjeje

Nga konsultimet me palët e interesit, uji i pijshëm i kontaminuar¹⁶ është një pasojë kritike gjatë dhe pas përmbytjeve. Kjo bazohet në dy arsye: Ujërat e ndotura në të gjithë rajonin e projektit nuk trajtohen siç duhet. Ujërat e e qytetit të Shkodrës derdhen drejtpërdrejt në liqenin e Shkodrës dhe në lumin e Bunës. Në Dajç, ujërat e ndotura drenazhohen në një sistem kanalizimesh me rrjedhje të lirë, ku uji bllokohet për një kohë të gjatë (shih nënkapitullin vijues që përshkruan trajtimin e ujërave të ndotura). Në rast përmbytjesh,

¹⁶ Uji i pijshëm në Shqipëri rrjedh kryesisht nga ujërat nëntokësore.

ujërat e ndotura të patrajtuara përzihen me ujin e pijshëm, si për shembull me pusët në Pentar, Mushan dhe Shirq në Dajç të cilat preken ndjeshëm. Ndaj, ndotja e ujit të pijshëm ka nivele të larta mikrobesh dhe nitratësh.

Në raste të tjera, në të gjithë zonën e Dajçit dhe të Gurit të Zi, furnizimi me ujë bazohet kryesisht në zgjidhje individuale pasi instalohen puse familjare. Furnizimi me ujë për qytetin e Shkodrës mbështetet kryesisht në stacionet e pompimit të ujit në Rrethinë dhe Bërdicë. Këto stacione preken ndjeshëm në rast përmbytjesh ekstreme si ajo e dhjetorit të vitit 2010. Situata e rrezikut mbetet e pandryshuar pavarësisht investimit në mure mbajtëse. Rreziku i dëmtimit të këtyre puseve nga përmbytjet është identifikuar si shumë i lartë duke shkaktuar mungesë të ujit të pijshëm (të sigurt).

Nga ana tjetër, ndërtimi i argjinaturës Shirq Belaj në Dajç ka ndihmuar në reduktimin e ekspozimit të tre shkollave ndaj përmbytjeve të shpeshta dhe mesatare. Për shkak të emigracionit dhe arsyeve të tjera, shkollat në fshatin Obot (Ana e Malit), Bërdicë dhe Dajç, si dhe kopshtet në fshatin Obot (Ana e Malit) dhe Dajç kanë ndaluar aktivitetin e tyre duke zvogëluar kështu rrezikun e ekspozimit ndaj përmbytjeve.

Vetëm 2,5 ha e zonës së parkut është e rrezikuar nga përmbytjet në hyrje të qytetit të Shkodrës dhe dy fusha futbolli në Velipojë. Ndërkohë, azilet nuk janë të ekspozuara ndaj përmbytjeve.

4.4.3. Mjedisi

Në kategorinë e receptorit të riskut “mjedisi”, vëmendje e veçantë i kushtohet impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe landfilleve. Numri total i objekteve në zonat e rrezikuara nga përmbytjet mund të shihet te Figura 34 duke iu referuar vlerësimit GIS për objektet e trajtimit të ujërave të ndotura (impiante dhe basene apo pellgje më të vogla të decentralizuara). Megjithatë, nga vlerësimi në terren, mund të thuhet se impiantet e mëposhtme të mëdha duhet të konsiderohen në vlerësimin e rrezikut nga përmbytjet:

- Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Velipojë (në punë); pjesërisht në zonën e rrezikuar nga përmbytjet.
- Landfilli i Bushatit (në punë); jo në zonën e rrezikuar nga përmbytjet.
- Impianti i ujërave të zeza në Shkodër (ndërtimi do të fillojë së shpejti); në zonën e rrezikuar nga përmbytjet.




Figura 34: Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "mjedisi" për qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytjeje

Siç është përmendur edhe më lart, instalimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura nuk është në nivelin më të mirë në qarkun e Shkodrës. Në rajon është i përhapur shkarkimi direkt në trupat ujorë nëpërmjet sistemit të kanaleve të kullimit. Në shumicën e rasteve këto kanale nuk janë plotësisht funksionale pasi kanë nevojë për pastrim në rast përmbytjesh.

Alternativa tjetër e trajtimit apo e shkarkimit të ujërave të ndotura është përmes gropave septike individuale dhe private ose e ndarjes së tyre sipas zonave. Numri i saktë i gropave të tilla në zonat me risk nuk është dokumentuar ende. Gjatë përmbytjeve, këto gropa janë të prirura të derdhen, duke ndikuar në kontaminimin e ujërave nëntokësore.

Krahas ujërave nëntokësore që ia vlejné të mbrohen, ka trupa ujorë të përcaktuar si ujëra rekreative dhe për plazh, si dhe zona të përcaktuara për mbrojtjen e habitateve apo specieve në rrezik ekspozimi ndaj përmbytjeve. Ujërat për banja plazhi të rrezikuara nga ekspozimi ndaj përmbytjeve në Dajç i referohen Bregicës në lumin e Bunës afër Belajt, Zallit të Dajçit në lumin e Bunës, Pentarit dhe Shirqit, ndërsa rreziku i përmbytjeve në Shkodër i referohet zonës së plazhit në fshatrat e Shirokës dhe Zogaj.

Ligji nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura" përcakton gjashtë zona të mbrojtura në kategoritë e menaxhimit në përputhje me Bashkimin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës. Në qarkun e Shkodrës, kategoria III, IV dhe V (shih kapitullin 2.10) janë të rrezikuara nga përmbytjet. Kjo i referohet të gjithë peizazhit të mbrojtur Lumi i Bunës – Velipojë i cili përfshin të gjithë lumin e Bunës duke filluar nga kryqëzimi Drin-Bunë në Bahçallëk në njësinë administrative Bërdicë deri te zona e deltës në njësinë administrative Velipojë dhe liqenin e Shkodrës.

Aktiviteti i erozionit lumor përmes prurjeve të mëdha është një stres shtesë mjedisor në shtratin e lumit jo vetëm të lumit të Bunës por edhe në lumin Kir në njësinë administrative Rrethinat.

4.4.4. Trashëgimia kulturore

Si pjesë e receptorit të riskut “trashëgimia kulturore”, objektet e rrezikuara të identifikuar janë:

- Vendet fetare, konkretisht xhamitë dhe kishat,
- Varrezat dhe
- Monumentet e kulturës

Në total rrezikohen 13 objekte nga HQ010, 36 nga HQ100 dhe 37 objekte nga përmbytjet ekstreme (HQ500). Niveli i riskut për këto objekte në këtë kategori nuk ka ndryshuar, duke qëndruar i njëjtë me nivelin e riskut në studimin MRP të vitit 2014.

Tabela 15: Objektet e rrezikuara që preken potencialisht të receptorit të riskut “trashëgimia kulturore” të diferencuara sipas skenarëve të përmbytjeve HQ010, HQ100, HQ500

Objektet e rrezikuara/ Skenari i përmbytjes	HQ010	HQ100	HQ500
703-kishë	6	12	13
704-qendër kulturore	2	5	5
705-varreza	3	8	8
709-xhami	2	11	11
Shuma	13	36	37

Në Gur të Zi është ndërtuar një xhami e re e përshtatur ndaj përmbytjeve. Niveli i riskut llogaritet të jetë i ulët.




Figura 35: Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "trashëgimia kulturore" për qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytjeje

4.4.5. Aktiviteti ekonomik

Vlerësimi i riskut për receptorin e riskut "aktiviteti ekonomik" merr në konsideratë

- Infrastrukturën teknike: gjenerimin/shpërndarjen e energjisë elektrike, asgjësimin/trajtimin e mbetjeve, infrastrukturën e komunikacionit, transportit e cila përfshin rrugët ajrore, rrugët dhe hekurudhat
- Shërbimet publike dhe sigurinë: godinat e administratës, zjarrfikësen, policinë, urgjencën
- Aktivitetet/objektet bujqësore
- Industrinë dhe tregtinë, shitjen me shumicë, me pakicë dhe shërbimet
- Objektet turistike

Numrat e vlerësimit statistikor në figurën e mëposhtme nuk pasqyrojnë të gjithë situatën në krahasim me rezultatet e konsultimit të grupet e interesit. Për shembull, ahuhret e vogla familjare nuk janë të listuara. Në njësinë administrative Bërdicë janë ende 650 ahure të vogla në fshatrat Trush, Bërdicë e Sipërme, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Madhe dhe Beltojë

të ekspozuara ndaj përmbytjeve (duke iu referuar përmbytjeve ekstreme). Megjithatë këto shifra kanë një trend rënës për shkak të emigrimit, duke lënë ahuret jashtë përdorimi. Për të njëjtën arsye, ka një rënie të numrit të bizneseve të tjera familjare. Kuptueshëm, familjet largohen nga zona e biznesit pasi humbjet financiare të shkaktuara nga përmbytjet nuk janë të kompensueshme.

Referojuni kapitullit 4.4.1 për më shumë informacion rreth tokës bujqësore që preket potencialisht nga përmbytjet.

Ka disa mospërputhje të tjera të statistikave rreth industrisë dhe vendeve të fabrikave. Për zonën e projektit ndodhen objektet e mëposhtme që preken nga përmbytjet:

- Një impiant i përpunimit të gurit në Oblikë (Njësia administrative Ana e Malit)
- Një depo kimike bujqësore në Harkun e Bërdicës në hyrje të fshatit, një në fshatin Konaj në njësinë administrative Bushat dhe një në njësinë administrative Dajç.
- Një magazinë industriale për prodhimin e materialeve të aluminit në bllokun Kasape në njësinë administrative Guri i Zi.

Nuk janë identifikuar aktivitete të tjera industriale dhe tregtare, të tilla si kompani të dëmshme për mjedisin.




Figura 36: Objektet që preken potencialisht nga përmbytjet në kategorinë "aktiviteti ekonomik" qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytjeje

Duke pasur parasysh infrastrukturën teknike, vendndodhjet informale të asgjësimit të mbetjeve për mbetjet e ngurta komunale në Gur të Zi dhe në njësinë administrative të Rrethinës, për fat të keq preken nga përmbytjet.

Figura e mëposhtme shfaq infrastrukturën rrugore që preket. Rrugët kombëtare SH-41 dhe SH-27, si dhe rrugët dytësore të tilla si Rruga Oblikë Obot në njësinë administrative Ana e Malit preken nga përmbytjet. Janë bërë disa ngritje, por pa e zbutur ekspozimin ndaj rrezikut

nga përmbytjet. Vetëm në Velipojë Selmanaj dhe Pentar-Luarz, argjinaura redukton dukshëm ekspozimin ndaj përmbytjeve të rrugës midis Baks-Rrjoll, Luarz-Cas dhe rrugës nacionale Shkodër-Velipojë.

Ka një numër të madh hekurudhash që preken nga përmbytjet në Gur të Zi dhe Shkodër (më pak se 1 km).




Figura 37: Rrugët dhe hekurudhat që preken potencialisht nga përmbytjet në qarkun e Shkodrës të ilustruara për çdo njësi administrative dhe skenar përmbytjeje

Për sa i përket objekteve të sigurisë publike, nuk ka objekte të ekspozuara ndaj përmbytjeve.

4.5 Rreziku nga përmbytjet nga hidrocentralet në zonën e projektit

Siç është përmendur edhe më lart, ashpërsia e përmbytjeve në qarkun e Shkodrës vjen si pasojë e një kombinimi të faktorëve natyrorë dhe njerëzorë. Të gjitha shkarkimet nga kaskadat rregullohen sipas “Rregullores së Shkarkimit të Plotave të kaskadës”. Shkarkimet nisin me hapje të vogla të portave dhe në raste të veçanta me hapje të mëdha të tyre. Duke iu referuar kushteve dhe parashikimeve hidrometeorologjike, është zbatuar vendimi i Komisionit të Posaçëm për Trajtimin e Plotë të kaskadës së lumit Drin. Kur shkarkimi i plotë është i nevojshëm për shkak të sigurisë së digës, shkarkimi i sasive të mëdha të ujit nga rezervuarët e hidrocentraleve llogaritet si faktor menaxhimi i cili mund të shkaktojë përmbytje në rrjedhën e poshtme të rajonit.

Tabela 16: Njerëzit e rrezikuar në rrjedhën e poshtme të digave të Vaut të Dejës në skenarin më të keq (KESH, 2015)

Njësia Administrative	Zona e përmbytur [ha]	Njerëzit e rrezikuar [shifra]	Njësia Administrative	Zona e përmbytur [ha]	Njerëzit e rrezikuar [shifra]
Ana e Malit	-	-	Rrethinat	-	-
Muriqan	682.8	1078	Bardhaj	366.4	384
Oblikë e Sipërme	213.3	46	Bleran	11.9	108
Oblikë e Madhe	599.5	2327	Shkodër	1330.1	110202
Obot	284	439	Golem	184.2	1084
Shtuf	194.6	89	Dobrac	424.7	1608
Velinaj	134	297	Shtoj i ri	121.1	273
Bërdicë	-	-	Velipojë	622.4	1288
Bërdicë e Sipërme	225.6	1230	Boks i Ri	299.4	301
Bërdicë e Mesme	228.8	922	Cas	1071.5	363
Beltoje	283	708	Gomsiqe e Re	562.3	984
Bërdicë e Madhe	483.4	1306	Luarz	958.5	328
Mali Hebej	4013.6	545	Mali Kolaj	187.1	126
Plepan	177	494	Rec	478.2	177
Trush	1440.4	2657	Rec i Ri	795.2	556
Zus	810.8	685	Pulaj	1199.8	501
Dajç.	238.3	1191	Bushat	590.7	1738
Belaj	304.9	268	Ashtë	445.4	903
Darragjate	321	294	Barbullush	1153.2	2626
Gramsh	372	656	Fshat i Ri	360.3	433
Mali i Gjymtit	459.5	62	Kosmac	442.4	1931
Mushan	211.8	959	Kukel	38.5	52
Pentar	152.2	269	Melgushe	188.4	797
Rrushkull	257.7	247	Pistull	395.6	498
Samrisht i Ri	161.8	441	Plezhë	305.9	689
Shirq	151.6	746	Rranxe	1732.6	3338
Suka-Dajç	332	347	Shelqet	419.9	1226
Guri i Zi	133.5	524	Shkjezë	429.6	1057
Ganjollë	509.4	364	Stajkë	561.6	2178
Juban	409.3	1120			
Kuc	761	996			
Renc	377	431			

Njësia Administrative	Zona e përmbytur [ha]	Njerëzit e rrezikuar [shifra]
Sheldija	30.2	28
Spathar	167.4	339
Vukatanë	381.2	1002

Njësia Administrative	Zona e përmbytur [ha]	Njerëzit e rrezikuar [shifra]
-----------------------	-----------------------	-------------------------------

Rezultatet e modeleve hidraulike tregojnë se çarja e digës së Fierzës do të çonte në një çarje të digës së Komanit dhe të një apo të të gjitha digave të Vaut të Dejës, duke përmbytur zona të mëdha e si rrjedhje duke prekur shumë njerëz si dhe infrastrukturën.

Tre rajone të ndryshme përmbyten potencialisht në rast të prishjes së digës

- Rajoni Fierzë-Koman
- Rajoni Koman-Vau i Dejës
- Fusha aluvionale në rrjedhën e poshtme të digës së Vaut të Dejës

Në skenarin më të keq, ku të tre digat çahen për shkak të rritjes së nivelit të ujit, numri i personave të rrezikuar në rrjedhën e poshtme të digave të Vaut të Dejës dhe të digës së Gojcit në zonën e projektit është si më poshtë Tabela 16. Për detaje rreth personave të rrezikuar në rajonin Fierzë-Koman dhe Koman-Vau i Dejës, referojuni KESH-it (2015).

5 Objektivat e duhura për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në qark

5.1 Objektivat e përgjithshme për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në zonë

Objektivi kryesor i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet sipas direktivës së BE-së për përmbytjet është: “Të krijohet një kornizë për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, duke synuar reduktimin e pasojave negative për

- Shëndetin e njeriut,
- Mjedisin,
- Trashëgiminë kulturore dhe
- Aktivitetin ekonomik.

Ky objektivi kryesor nënvizohet nga katër objektivat e lidhura me rrezikun e MRP të cilat trajtojnë fazat e përmbytjeve (para, gjatë dhe pas përmbytjeve), si dhe përmirësimin e situatave ekzistuese dhe parandalimin e ndikimeve të reja negative (shih Figura 8).

Një objektivi shtesë i referohet përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstytucional, shkëmbimit të informacionit dhe ndarjes së të dhënave për të reduktuar rreziqet me anë të masave organizative sipas Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027 (SKMIBU) si dhe Planit të Menaxhimit të Basenit Drin-Bunë 2020-2026 (PMBL).

5.2 Objektivat specifike

Nga objektivat kryesore për MRP, të zhvilluara nga direktiva e BE-së për përmbytjet dhe politikat shqiptare për ujin, u hartuan objektiva specifike, më të detajuara për të mbuluar fushat e veprimit. Propozimet u prezantuan dhe u diskutuan me grupin ndërinstytucional të punës në periudhën nëntor-dhjetor. 2021. Kështu që "objektivat e përshtatshme të mëposhtme për MRP në qarkun e Shkodrës" u dakordësuan për të krijuar një pranim të përbashkët të qëllimeve të të gjitha aktiviteteve në Planin e MRP. Objektivat janë pikënisja për zhvillimin e masave për zvogëlimin e riskut. Secila masë duhet të kontribuojë në arritjen e një objektivi të përshtatshëm të specifik.




Figura 38: Objektivat e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet (sipas direktivës së BE-së nga përmbytjet)

Tabela e mëposhtme (Tabela 17) tregon të gjithë objektivat specifike:

Tabela 17: Lista e objektivave të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në qarkun e Shkodrës

Objektivi specifik	Receptorët referencë				
	njerëzit	mjedisi	trashëgimi	ekonomia	
0. Objektivat e përgjithshme: organizimi dhe kapacitetet për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet (sipas Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027 - SKMIBU)					
0.1	Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimit të informacionit dhe ndarjes së të dhënave në fushën e zvogëlimit të riskut në lidhje me ujërat.	x	x	x	x
0.2	Rritja e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe e aftësive për tu përgatitur dhe për të reaguar ndaj përmbytjeve.	x	x	x	x
1. Parandalimi i rrezeqeve të reja në zonat e rrezikuara nga përmbytjet					
1.1	Nuk ka rritje të shkarkimeve ekzistuese. Mbrojtja funksionive ujëmbajtëse (fushave aluvionale lumore) në dhe pranë lumenej/përrenjeve.	x	x	x	x
1.2	Parandalimi i aktiviteteve të reja në vendbanimet e zonave të rrezikuara nga përmbytjet nëse nuk mund të sigurohen masa paraprake dhe mbrojtje nga përmbytjet (HQ ₁₀₀ /HQ _{extreme}).	x	x	x	x
1.3	Parandalimi i rrezeqeve shtesë në të gjitha zonat e rrezikuara nga përmbytjet (HQ _{ekstreme}); në lidhje me ndërtesat e reja dhe objektet e reja të infrastrukturës (ujësjellësi, ujërat e ndotura, energjia, telekomunikacioni etj.).	x	x	x	x
1.4	Parandalimi i praktikave industriale në zonat e rrezikuara nga përmbytjet të cilat mund të shkaktojnë rrjedhje të kimikateve të rrezikshme në rrugët ujore gjatë përmbytjeve (parandalimi i trajtimit të papërshtatshëm të substancave ndotëse për ujin)	x	x	x	x
1.5	Parandalimi i rrezeqeve të reja të erozionit dhe rrëshqitjeve të dheut në zonat e rrezikuara nga përmbytjet me prioritet për qasjet jostrukturore, duke marrë parasysh funksionin e rëndësishëm të pemëve/pyllit		x		
1.6	Inspektimi, mirëmbajtja dhe, sipas rastit, përmirësimi i punëve teknike për mbrojtjen nga përmbytjet.	x		x	x
2. Parandalimi i rrezeqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmbytjet					
2.1	Vlerësimi dhe reduktimi i potencialit të dëmit në zonat e rrezikuara nga përmbytjet (përshtatja dhe rritja e rezistencës së përdorimit ekzistues të tokës dhe ndërtesave, sistemeve të transportit, infrastrukturës, përdorimit të tokës, punëve mbrojtëse etj.).	x	x	x	x
2.2	Forcimi i ndërgjegjësisimit në lidhje me rreziqet nga përmbytjet në procesin e planifikimit dhe në projektet e ndërtimit.	x	x	x	x
2.3	Përmirësimi i ruajtjes natyrore të ujit me efekte pozitive në situatën e përmbytjeve (zvogëlimi i pikut të prurjeve, rritja e kapacitetit mbajtës të përmbytjeve).	x	x	x	x
2.4	Vlerësimi dhe mbrojtja e rezervuarëve të ujit nga substancat e rrezikshme për mjedisin në zonat e rrezikuara nga përmbytjet dhe të ujërave/ujërave nëntokësore nga trajtimi i ujërave të ndotura dhe nga aktivitetet bujqësore.		x		
2.5	Përmirësimi dhe identifikimi i masave teknike për mbrojtjen nga përmbytjet të cilat nuk kanë ndikim negativ tek të tjerët, duke marrë parasysh parimet e solidaritetit.	x		x	x
3. Reduktimi i pasojave negative gjatë përmbytjeve					
3.1	Përmirësimi i aftësisë së popullsisë së prekur dhe të menaxherëve të objekteve për të reaguar.	x	x	x	x
3.2	Përmirësimi i aftësisë së administratës dhe organizatave të sigurisë në nivel vendor dhe rajonal për të reaguar.	x	x	x	x
3.3	Përmirësimi i parimeve dhe burimeve organizative për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e fatkeqësive.	x	x	x	x
4. Reduktimi i pasojave negative pas përmbytjeve					

Objektivi specifik	Receptorët referencë			
	njerëzit	mjedisi	trashëgjimi	ekonomia
4.1 Përmirësimi i dëmit nga administratat dhe organizatat e sigurisë në nivel vendor dhe rajonal; gjithashtu për popullsinë potencialisht të prekur dhe menaxherët e objekteve.	x	x	x	x
4.2 Mbrojtja ndaj dëmeve financiare ekzistenciale nga sigurimet dhe fondet.	x		x	x
4.3 Përgatitja e restaurimit/rindërtimit të përshtatur me përmbytjet pas dëmtimeve; përgatitja e menaxhimit të mbetjeve lidhur me përmbytjet.	x	x	x	x

SHENIM: Objektivat janë zhvilluar nga objektivat e MRP sipas direktivës së BE-së për përmbytjet. Objektivat janë lidhur me katalogët e llojeve të masave (shih Shtojcën A); të gjitha masat e përzgjedhura duhet të kontribuojnë në të paktën një objektivi. Në shumicën e rasteve, një masë kontribuon në më shumë se një objektivi gjë që tregon efikasitetin e saj.

5.2.1. Objektivat e përgjithshme për organizimin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet

Objektivat e përgjithshme synojnë përmirësimin e strukturave të punës në sektorin e ujërave duke përfshirë menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, në veçanti bashkëpunimin, informimin dhe menaxhimin e të dhënave. Objektivat janë në përputhje me kërkesat e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027 (SKMIBU) si dhe të Planit të Menaxhimit të Basenit Drin-Bunë 2020-2026 (PMBL). Konkretisht, objektivat e SKMIBU-së në lidhje me përmbytjet janë:

- Rreziqet nga ujërat: reduktimi i rreziqeve nga ujërat (përmbytjet dhe thatësitrat) nëpërmjet menaxhimit dhe investimit, i cili u shërben të gjitha interesave, nëpërmjet zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore kombëtare, të cilat transpozojnë direktivat përkatëse të BE-së;
- Informacion rreth ujërave: ofrimi i modeleve dhe i të dhënave për ujërat dhe klimën për të gjithë grupet e interesit dhe këshillimi i qeverisë për politikëbërjen në lidhje me ujërat bazuar në institucionet përkatëse që zotërojnë këto të dhëna.

Objektivat e përgjithshme përfshijnë gjithashtu rritjen e kapaciteteve dhe të aftësive të të gjitha institucioneve përkatëse për t'u përgatitur dhe për të reaguar në rastet e përmbytjeve, si dhe për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në lidhje me kapacitetet teknike dhe profesionale. Kjo përfshin konkretisht objektivin për të rritur nivelin e ekspertizës së administratës dhe të organizatave në nivel qendror dhe vendor për të përmirësuar përlllogaritjen e kostos së dëmit nga përmbytjet, duke përfshirë popullsinë dhe administratorët e objekteve.

5.2.2. Objektivat për parandalimin e rreziqeve të reja në zonat e rrezikuara nga përmblytjet

Objektivat e përcaktuara për objektivin e përgjithshëm, parandalimi apo shmangia e rreziqeve të reja, synojnë fillimisht ruajtjen e rrjedhjes dhe funksionin mbajtës përgjatë trupave ujorë, si dhe në zonën e ujëmbledhësit, në mënyrë që të parandalohet një rritje e shkarkimeve dhe rreziqeve (nuk ka ndikime negative në krahasim me status quo-në).

Rritja e rrezikut nga përmblytjet duhet të shmanget më tej, veçanërisht duke parandaluar rritjen e potencialit të dëmit. Kështu, zonat e reja të vendbanimeve, shtëpitë e reja dhe infrastruktura e re duhet të rregullohen për aq kohë sa nuk është e mundur dhe e parashikuar në mënyrë eksplicite adaptimi i rrezikut nga përmblytjet dhe mbrojtja nga përmblytjet. Gjithashtu, të gjitha llojet e tjera të përmirësimeve në mbrojtjen nga përmblytjet për objektet e reja të rrezikuara mbulohen nga ky objektivi.

Shmangia e aktiviteteve të ngritjes së vendbanimeve apo përshtatja e përdorimit të tokës në zonat e prirura për përmblytje parandalon në veçanti rritjen e potencialeve të dëmeve dhe personave që preken dhe rrjedhimisht të risqeve. Objektivi përfshin gjithashtu parandalimin e zbatimit shtesë të praktikave industriale të cilat sjellin kimikate të rrezikshme në zonat e rrezikuara nga përmblytjet (për ngjarjet ekstreme).

Për të arritur objektivin e shmangies së rrezikut nga erozioni do të merret parasysh kontributi i pyllëzimit dhe pylltarisë lidhur me funksionin e tyre mbrojtës të shpateve, rrëshqitjeve të dheut, erozionit dhe stabilizimit të shpateve.

Objektivi përfshin gjithashtu synimin e mbrojtjes së mjedisit dhe aftësisë për tu përshtatur, mbrojtur dhe rikuperuar nga rreziqet natyrore. Me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5, datë 16.10.2017, është miratuar "Strategjia e Zhvillimit të Territorit". Një nga Objektivat Strategjike të kësaj strategjie (nr. 5) është: Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rikuperuar nga rreziqet natyrore. Duke pasur parasysh se ky është një dokument strategjik shumë i rëndësishëm (i cili ka kaluar të gjitha fazat ligjore të miratimit), ky objektivi është gjithashtu i integruar në planin e menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet. Në këtë aspekt, strategjitë dhe planet vendore të NjQV janë të ndërlidhura me strategjitë dhe planet e qeverisë qendrore.

5.2.3. Objektivat për reduktimin e rreziqeve ekzistuese në zonat e rrezikuara nga përmblytjet

Objektivat të cilat rezultojnë nga objektivi i përgjithshëm "Reduktimi i rreziqeve ekzistuese" fokusohen në përmirësimin e mbajtjes natyrore të ujërave për të ulur rrezikun nga përmblytjet si dhe për të ulur ndjeshmërinë ndaj dëmeve (përshtatja ndaj rreziqeve) dhe për të ulur potencialet ekzistuese të dëmeve.

Objektivi përfshin synimet e përshtatjes së përdorimit aktual të tokës për të ulur rrezikun për përdorimin e tokës urbane si edhe për tokën bujqësore në zonat e rrezikuara nga përmblytjet. Kjo politikë është miratuar nga Bashkia e Shkodrës me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.19, datë 24.03.2017, dhe është gjithashtu në përputhje me direktivën kuadër të BE-së për ujin nr. 12 2000/60 KE.

Për të ulur rrezikun ekzistues, hartat e rrezikut dhe riskut nga përmblytjet (shih kapitullin 4.2/4.3) janë me rëndësi tepër të lartë. Nëse është e nevojshme, hartat dhe vlerësimet specifike në lidhje me infrastrukturën kritike si magazinat, pikat e karburantit apo deponitë, si dhe vendndodhjet në të cilat ruhen fertilizuesit kimik apo kimikate të tjera në zonat e rrezikuara nga përmblytjet, duhet ta bëjnë këtë objektiv funksional.

5.2.4. Objektivat për reduktimin e pasojave negative gjatë përmblytjeve

Objektivi kryesor “Reduktimi i pasojave negative gjatë përmblytjeve” rezulton në objektiva të cilat fokusohen në përgatitjen e popullsisë dhe të njësive për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, menaxhimin e informacionit si dhe në aspektet organizative dhe operacionale. Në thelb, kjo ka të bëjë me përgatitjen për një ngjarje përmblytjeje në mënyrë që aktivitetet e duhura të mund të ndërmerren shpejt dhe saktë për të shmangur pasojat negative.

Komunikimi afatgjatë i rrezikut dhe ngritja e skemave të alarmit dhe shpëtimit është një nga fushat e veprimit më e rëndësishme që duhet të zhvillohet me masa të detajuara nën këtë grup objektivash.

5.2.5. Objektivat për reduktimin e pasojave negative pas përmblytjeve

Objektivat që rrjedhin nga objektivi i përgjithshëm “Reduktimi i pasojave negative pas përmblytjeve” fokusohen në përmirësimin e mundësive për të tejkaluar shpejt pasojat nga përmblytjet. Kjo përfshin aspektet organizative, operacionale, financiare dhe të rindërtimit, si dhe monitorimin dhe dokumentimin e ngjarjeve.

5.3 Ndërlidhjet e objektivave specifike dhe receptorët e riskut

Sipas nenit 7(2) të direktivës së BE-së për përmblytjet (Shtojca A.3 e direktivës së BE-së për përmblytjet) plani i MRP dokumenton objektivat e caktuara të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet për zonën e planit të MRP. Këto do të fokusohen në reduktimin e pasojave negative të përmblytjeve për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, dhe, nëse mendohet e përshtatshme, në nismat jostrukturore dhe/ose në reduktimin e probabilitetit të përmblytjeve. Këtu lidhja e objektivave të vendosura me receptorët e riskut verifikohet si më poshtë në Tabelën 17.

5.3.1. Shëndeti i njeriut

Në thelb, të gjitha objektivat specifike të vendosura për menaxhimin e rrezikut nga përmbajtjet në tabelën 17 i referohen zvogëlimit të riskut për “shëndetin e njeriut” si një aset i cili është veçanërisht i çmueshëm për mbrojtje:

- Mbrojtja e individit nga ekspozimi i dëmshëm që nënkupton mbrojtjen nga rreziku, dëmtimet e rënda apo shqetësimet për publikun ose afërsinë në mënyrën, madhësinë ose qëndrueshmërinë e tij.
- Nga ana tjetër, mbrojtja e shëndetit të njeriut objektivizohet nga një mbrojtje e përhershme e cilësisë së jetesës për sa i përket strehimit, mjedisit rezidencial të menjëhershëm dhe i ndërmjetëm dhe funksionit rekreativ .

5.3.2. Mjedisi

Receptori i riskut “mjedisi” ndahet në disa të mira të cilat ia vlejné të mbrohen gjatë menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet, konkretisht

- Flora dhe fauna: mbrojtja e diversitetit biologjik të florës dhe faunës dhe e habitatit të tyre, veçanërisht e pyjeve dhe rezervateve natyrore duke siguruar funksionalitet.
- Toka & dheu: ruajtja e strukturës së tokës nga erozioni dhe kompaktësimi për të mbrojtur funksionet natyrore të dheut (d.m.th. zhvillimi, filtrimi dhe zbutja e biotopit)
- Ujërat: Ruajtja e një gjendjeje të mirë ekologjike, kimike të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe ruajtja e sasive të tyre brenda kufijve të kapacitetit të tyre rigjenerues.

Këtu, objektivat specifike të menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet ndryshojné nga receptorët e tjerë të riskut duke lënë jashtë mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e veprave teknike për mbrojtjen nga përmbajtjet dhe objektivat specifike të çështjeve financiare (shih Tabelën 17).

5.3.3. Trashëgimia kulturore

Ruajtja e trashëgimisë kulturore llogaritet si një fushë tjetër e rëndësishme. Kjo ka të bëjë me ruajtjen e peizazhit kulturor të evoluar historikisht që përfshin ndërtesat historike, monumentet kulturore dhe arkeologjike nga deformimi, fragmentimi dhe dëmtime të tjera pasi monumentet dhe memorialet duhet të përdoren në mënyrë të arsyeshme dhe të eksploroehen shkencërisht.

Objektivat specifike të menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet të receptorit të riskut “shëndeti i njeriut” zbatohen në mënyrë analoge për këtë receptor, duke lënë jashtë parandalimin e

erozionit dhe mbrojtjen e ujit nga substancat e rrezikshme, pasi ato objektivizohen nga kategoria “mjedisi”.

5.3.4. Aktiviteti ekonomik

Aktiviteti ekonomik, si një e mirë e cila është e denjë për mbrojtje, përfshin të mirat materiale në industri dhe në tregti, bizneset bujqësore dhe pyjore dhe infrastrukturën teknike të cilat janë të rëndësishme për t'i shërbyer publikut për të përmirësuar cilësinë e jetesës.

Si të tilla, objektivat specifike të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet nuk ndryshojnë nga ato të kategorisë “shëndeti i njeriut” duke pasur parasysh për shembull mbrojtjen e funksioneve mbajtëse/ fushave aluvionale, reduktimin e potencialit të dëmit në zonat e rrezikuara nga përmbytjet dhe mbrojtjen nga katastrofat financiare.

6 Masat për menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet

Vlerësimi i rrezikut nga përmblytjet (Kapitulli 4) dhe objektivat e nxjerra nga menaxhimi i rrezikut nga përmblytjet (Kapitulli 5) janë baza për një plan veprimi të strukturuar. Një plan masash i përpunuar shërben si një kuadër i vlefshëm veprimi në zonën ujëmbledhëse të basenit lumor Drin-Bunë për të arritur objektivat e vendosura individualisht për rajonin e projektit. Si i tillë, plani i masave përfshin statusin e zbatimit, institucionet/subjektet përgjegjëse dhe mbështetëse për të vepruar, si dhe vendndodhjet sipas VPRRP (2018) dhe ndikimet e mundshme ndërkufitare.

Për mbledhjen dhe dokumentimin e masave për reduktimin e rrezikut nga përmblytjet bazuar në analizat e rrezikut dhe në identifikimin e aktiviteteve të nevojshme për të reduktuar rreziqet e identifikuar, u përdor një katalog i llojeve të masave, i cili u bazua në llojet e masave të nomenklaturës së BE-së (procesi CIS, skemat raportuese, skemat e vlerësimit). Katalogu u përshtat sipas kushteve dhe nevojave rajonale. Katalogu korrespondon me objektivat e përshtatshme pasi për të gjitha objektivat specifike ka lloje masash të cilat mund të kontribuojnë për të arritur objektivin specifik (shih Tabela 18 dhe Shtojcën A).

Ky katalog masash u zhvillua dhe u dakordësua fillimisht në një projekt rajonal të zhvilluar më herët për menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet në qarkun e Shkodrës me autoritetet dhe grupet e interesit përgjegjëse në 2013-2015 (Studimi i MRP 2014). Katalogu u përshtat për këtë plan MRP për shkak të ndryshimit të kushteve dhe kërkesave në nivel individual.

Të gjitha fushat e veprimit u zhvilluan në bazë të katalogut të llojeve të masave nga të gjitha organizatat e përfshira dhe në disa seminare të grupit ndërinstytucional të punës (2021-2022). Masat specifike të përshtatshme dhe të nevojshme vendore dhe rajonale u përzgjedhën bashkë me palët përgjegjëse rajonale dhe vendore. Plani përfundimtar i veprimit (Shtojca B) përmban masa nga pjesa më e madhe e fushave të veprimit të cilat janë diskutuar me të gjitha grupet e interesit përkatëse në nivel vendor dhe rajonal.

6.1 Katalogu i llojeve të masave

Katalogu i llojeve standarde të masave (sipas llojit të masave të BE dhe sipas aspektit të menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet të BE), është përdorur për të përcaktuar masat specifike për të reduktuar rrezikut nga përmblytjet në zonën e projektit. Masat e përzgjedhura u specifikuan dhe lokalizuan si vendore, rajonale dhe kombëtare. Cdo lloj i masës kontribuon në arritjen e një apo më shumë objektivave specifike (shiko tabelën 17 dhe 18).

Kjo strukturë dhe katalogu i masave ishin pikënisja e identifikimit të masave për të reduktuar rrezikun nga përmblytjet në të gjitha fushat e veprimit.

Tabela 18: Fushat e veprimit: Katalogu i llojeve të masave për MRP në qarkun e Shkodrës

Nr.	Struktura e katalogut të masave: fushat e veprimit	Lidhje për objektivat MRP (kapitulli 5.2)
1.	Aspekti: Parandalimi i rreziqeve	
1.1.	Instrumentet administrative (për shmangien e rrezikut)	
1.1.1.	Hartëzimi i zonave të rrezikuara nga përmbytjet	0.1., 0.2., 1.2., 2.2.
1.1.2.	Kufizime për ndërtime në zonat me rrezik (në planifikimin hapësinor / planifikimin urban)	0.1., 0.2., 1.2., 1.3., 2.1., 2.2.
1.1.3.	Mbrojtja e fushave aluvionale dhe zonave ujëmbajtëse	1.1., 1.3., 1.5., 2.1., 2.3.
1.2.	Përshtatja e përdorimit të tokës (për shmangien, zhdukjen apo zhvendosjen dhe reduktimin e rrezikut)	
1.2.1.	Përshtatja e përdorimit ekzistues të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet (duke përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë)	1.3., 2.1.
1.2.2.	Përshtatja e ndërtimeve dhe e infrastrukturës në zonat me rrezik (planifikimi dhe ndërtimi i përshtatur me përmbytjet)	1.3., 2.1.
1.2.3.	Konsultimi me ekspertët e bujqësisë dhe pylltarisë për ritjen e ndërgjegjesimit	1.5., 2.2.
1.3.	Parandalimi i rrezikut nga ndërtesat e përshtatura me përmbytjet	
1.3.1.	Menaxhimi i përshtatur me përmbytjet për substancat e rrezikshme për ujin	1.4., 2.1., 2.4.
2.	Aspekti: Mbrojtja natyrore nga përmbytjet	
2.1.	Menaxhimi natyror i përmbytjeve, rregullimi i rrjedhës së ujit	
2.1.1.	Rivitalizimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të lumenjve / ish fushat aluvionale	1.3., 2.1.
2.1.2.	Ndryshimi i rrjedhave të lumenjve dhe kushteve të pjerrësisë	1.1., 1.3., 1.5., 2.1.
2.1.3.	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumenjve	1.1., 1.3., 1.5., 2.1.
2.1.4.	Mbështetja e zhvillimit të fushave aluvionale natyrore	1.1., 1.3., 2.1.
2.1.5.	Mirëmbajtja e modifikuar e lumit	1.1., 1.3., 1.5., 2.1.
2.1.6.	Prishja/ Heqja e trotuareve në zonat urbane / Menaxhimi i ujërave të shiut	1.3., 2.1.
2.2.	Riaktivizimi i zonave ujëmbajtëse (rregullimi i rrjedhës/ rrjedhës së ujit)	
2.2.1.	Dekonstruksioni i një prite apo dige	1.3., 2.1., 2.3.
2.2.2.	Rivendosja e pritave	1.3., 2.1., 2.3.
2.2.3.	Heqja e një bregu artificial	1.3., 2.1., 2.3.
2.2.4.	Lidhja e një terreni ujëmbajtës (p.sh. kënetat, degë të vjetra të lumit)	1.3., 2.1., 2.3.
3.	Aspekti: Mbrojtja teknike nga përmbytjet	
3.1.	Rregullimi i rrjedhës së ujit/ Punime në fushat aluvionale (Masa për mbledhjen e ujërave)	
3.1.1.	Ndërtimi i një pellgu mbajtës	1.3., 2.1., 2.3.
3.1.2.	Krijimi i një toke të bonifikuar për mbajtjen e ujit	1.3., 2.1., 2.3.
3.1.3.	Restaurimi, zgjerimi apo përmirësimi i sistemeve ekzistuese ujëmbajtëse (digat / pellgjet / tokat e bonifikuara)	1.1., 1.3., 1.6., 2.1., 2.3.
3.2.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / kanalet (prita, diga, mure mbrojtëse dhe mjete të lëvizshme për tu mbrojtur nga përmbytjet)	
3.2.1.	Punime për mbrojtjen nga përmbytjet (prita, diga apo mure mbrojtëse nga përmbytjet)	1.3., 2.1.
3.2.2.	Forcimi i punëve ekzistuese për mbrojtjen nga përmbytjet	1.3., 1.6., 2.1.
3.2.3.	Përshtatja e një sistemi të lëvizshëm (stacionar) të mbrojtjes nga përmbytjet	1.3., 2.1.
3.2.4.	Kullimi në zona të mbrojtura dhe mbrojtja nga kthimi i rrjedhës	1.3., 1.6., 2.1.
3.3.	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanale (Masa / ndërhyrje në lumenj)	
3.3.1.	Mbajtja pastër e prerjeve tërthore në zonat e vendbanimeve	1.3., 1.6., 2.1.
3.3.2.	Heqja e ngushticave / kalimeve të ngushta në lumenj	1.3., 1.6., 2.1.
3.3.3.	Ndërtimi dhe forcimi i një bypass-i	1.3., 1.6., 2.1.
3.4.	Menaxhimi i ujërave sipërfaqësorë (Masa për menaxhimin e ujërave urbane)	
3.4.1.	Menaxhimi i ujërave të shiut	1.1., 1.3., 2.1., 2.3.
3.4.2.	Zhvillimi i një sistemi ujëmbajtës bashkiak (p.sh. kanal i depozitimit të ujit të shiut)	1.3., 2.1., 2.3.
3.4.3.	Përmirësimi i një sistemi kullues të përshtatur me përmbytjet (p.sh. një sistem filtrimi, valvola për moskthimin e ujit)	1.3., 1.6., 2.1., 2.3.
3.5.	Mbrojtja e objekteve	
3.5.1.	Mbrojtja e ndërtesave individuale	1.3., 2.1.
3.5.2.	Mbrojtja e objekteve të infrastrukturës (p.sh. sistemet e transportit, energjisë, ujit)	1.3., 2.1.
3.6.	Masa të tjera mbrojtëse	
3.6.1.	Përmirësimi i menaxhimit të sistemeve lumore me diga/rezervuarëve	1.3., 1.6., 2.1., 2.3.
3.6.2.	Mbrojtja ndaj depërtimit dhe ujërave nëntokësorë	1.4., 2.1., 2.4.
4.	Aspekti: Përgatitja dhe informimi	
4.1.	Përgatitja ekonomike / financiare	
4.1.1.	Masat paraprake financiare nga rezervat dhe sigurimet (sigurimi nga rreziqet natyrore)	4.2.
4.2.	Përgatitja informative	
4.2.1.	Përmirësimi i parashikimit të përmbytjeve dhe paralajmërimit / mesazheve për përmbytje	0.2., 3.2., 3.3.

4.3. Përgatitje në lidhje me reagimin ndaj përmbytjeve	
4.3.1. Publikimi i hartave të rrezikut dhe hartave të riskut nga përmbytjet afër vendit	3.1.
4.3.2. Avancimi i vazhdueshëm i rritjes së ndërgjegjësimit dhe publicitetit	3.1.
4.4. Kompensimi, përgatitja dhe përpunimi i kontrollit të rrezikut.	
4.4.1. Përafrimi ose optimizimi i skemave të njoftimit dhe funksionimit (skemat e menaxhimit të fatkeqësive)	0.2., 3.2., 3.3.
4.4.2. Mbrojtja civile	0.2., 3.2., 3.3.
4.4.3. Mbledhja dhe analizimi i përvojave në lidhje me përmbytjet	0.1., 0.2., 2.2., 3.2., 3.3., 4.1.

6.2 Statusi i zbatimit të masave

Të gjitha masat janë vlerësuar në lidhje me statusin e tyre të zbatimit. Janë përdorur statuset në vijim (sipas kategorive të skemave të raportimit të BE-së / procesit CIS):

Tabela 19: Përshkrimi i statusit të zbatimit të masave në planin e veprimit

Statusi / emri	Shpjegimi
Të gjitha statuset:	Masa është identifikuar si e nevojshme ose potencialisht e dobishme për të reduktuar rrezikun e përmbytjeve sipas objektivave të përshtatshme, është e shënuar në planin e veprimit, dhe ...
(NS) - I pafilluar	... nuk ka filluar ende (i paplanifikuar në detaj, nuk ekziston asnjë studim mbi efikasitetin apo fizibilitetin e kësaj mase specifike).
(P) - I planifikuar	... është planifikuar në mënyrë më të detajuar duke përfshirë konceptim e zbatimit, por zbatimi nuk ka nisur ende (p.sh. nuk ka fonde në dispozicion apo lejet janë në pritje).
(OGM) - Mirëmbajtje e vazhdueshme	... është në fazën e zbatimit të rregullt ose përsëritëse (lloji i masës nuk ka një datë të caktuar përfundimi ose nuk përfundon kurrë, por duhet të zbatohet periodikisht ose në vazhdimësi, si për shembull aktivitetet e pastrimit, ose fushatat informuese, publikimet periodike të informacionit, takimet e rregullta etj.).
(OGC) - Ndërtim në vazhdim	... një masë ndërtimi e cila është në fazën e realizimit para përfundimit (për llojet e masave të cilat janë ndërtime ose aktivitete të tjera me një datë përfundimi të qartë, jo të përsëritura).

Statusi “I përfunduar” nuk është përdorur pasi në këtë plan të parë të MRP do të dokumentohen vetëm ato masa të cilat janë planifikuar të merren aktualisht apo në të ardhmen për të zvogëluar riskun. Masat e përfunduara janë përshkruar në dokumentimin e situatës hidrologjike të rrjetit lumor dhe të përdorimit të tokës në kapitullin 2.4. Statusi “I përfunduar” do të përdoret në ciklin e dytë të planit MRP për të lejuar vlerësimin e ecurisë së të gjitha masave (duke përfshirë ato të cilat do të kenë përfunduar deri atëherë).

Të 128 masat janë specifikuar në mënyrën më të mirë të mundshme me informacion mbi vendndodhjet, statusin e zbatimit dhe detaje të tjera (shih listën e masave në Shtojcën B).

6.3 Masat e përzgjedhura në zonë

Masat, të shpërndara sipas njësive të qeverisjes vendore, në total janë 144. Në këtë numër, numërohen të gjitha masat për NJQV që do të thotë se një masë që do të zbatohet në më shumë se një NJQV llogaritet për të gjitha NJQV-të e emërtuara (vetëm një masë që zbatohet një herë për të gjithë qarkun (“të gjitha NJQV”) llogaritet si një masë e vetme.

Plani i veprimit (Shtojca B) përbëhet nga 128 masa të ndryshme, nga të cilat 10 janë emërtuar për 2 ose më shumë vendndodhje në NJQV të ndryshme. Shpërndarja e masave në të katër aspektet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet pasqyrohet në Tabela 20.

Tabela 20: Shpërndarja e të gjitha masave për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në trajtimin e MRP në nivel BE-je

Trajtimi i MRP në nivel BE-je	Numri i masave në trajtimin e MRP në nivel BE-je [numri]	Numri i masave në trajtimin e MRP në nivel BE-je [%]
1. Aspekti: Parandalimi i rrezikut	41	32 %
2. Aspekti: Mbrojtja natyrore nga përmbytjet	24	19 %
3. Aspekti: Mbrojtja teknike nga përmbytjet	45	35 %
4. Aspekti: Përgatitja dhe informimi	18	14 %

Pasqyra në Figurën 39 tregon masat që korrespondojnë me katër aspektet e BE-së të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe gjithashtu statusin e zbatimit të tyre.




Figura 39: Masat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe statusi i tyre i zbatimit

Tabela tregon një numër të lartë të masave në vazhdimësi (rreth 58%) dhe të masave të cilat nuk kanë filluar ende (rreth 38%). Kjo pasqyron përpjekjet dhe angazhimin e autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.

Ndër këto aktivitete, numri relativisht i lartë i masave me status “mirëmbajtje e vazhdueshme”, veçanërisht në kategoritë “parandalimi i rreziqeve” dhe “përgatitja/informacioni” por gjithashtu “mbrojtja teknike nga përmbytjet” rezulton nga aktivitetet e vazhdueshme apo aktivitetet e mirëmbajtjes të cilat nuk kanë datë të caktuar përfundimi por të cilat duhet të përsëriten rregullisht. Numri i lartë i masave me këtë status është në përputhje me strategjinë e direktivës së BE-së për përmbytjet për t’i dhënë prioritet masave jostrukturore pasi ato janë me kosto efektive. Ka disa masa strukturore të cilat llogariten si një aktivitet me “mirëmbajtje të vazhdueshme”, të cilat i referohen punimeve të rregullta të pastrimit dhe të mirëmbajtjes.

Masat strukturore në përgjithësi, kryesisht të zakonshme në kategoritë e mbrojtjes natyrore dhe teknike nga përmbytjet (aspekti 2. dhe 3.), janë kryesisht me kosto intensive, kanë nevojë për planifikim të detajuar dhe miratim formal dhe si rrjedhojë varen nga fondet, si dhe nga planifikimi dhe procedurat e lejes. Më pak progres në zbatim është mjaft i zakonshëm për këto fusha veprimi. Në shikim të parë, Figura 39 nuk pasqyron këtë standard për rastin e qarkut të Shkodrës.

Megjithatë, në një vështrim më nga afër (referojuni nën-kapitullit përkatës për detaje të mëtejshme), zbatimi i ulët në këto aspekte është i dukshëm. Rekomandohet për masat që ende nuk kanë filluar të merren parasysh për ciklin MRP 2023-2028; në rastin më të mirë me prioritet për planifikimin, financimin dhe zbatimin e masave më efektive për sa i përket zvogëlimit të riskut.

Krahas këtij fokusi, masat të cilat nuk kanë nisur ende në fushën e veprimit “Parandalimi i rrezikut” (aspekti 1) dhe “Përgatitja dhe informimi” (aspekti 4) duhet të adresohen në mënyrë imperative për ciklin MRP 2023-2028 pasi me shumë gjasa janë me kosto efektive.

Figura 40 jep një pasqyrë më të detajuar duke marrë parasysh shpërndarjen e masave në fushat specifike të veprimit dhe statusin e tyre të zbatimit për çdo aspekt.

Dokumentimi i detajuar i të gjitha masave mund të gjendet në Shtojcë. Nënkapitujt e mëposhtëm japin një analizë më të detajuar të masave për të katër aspektet e BE-së për MRP.




Figura 40: Masat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në fushat specifike të veprimit dhe statusi i tyre i zbatimit

Tabelat e mëposhtme 21 dhe 22 listojnë numrin e masave të përzgjedhura në nivel NJQV dhe në nivel APSFR si dhe numrin total të masave të përzgjedhura për zonën e projektit në lloje të ndryshme masash dhe aspekte të menaxhimit të rrezikut.

Shënim:

Numri i përgjithshëm i masave të përzgjedhura ndryshon ndërmjet tabelave 21 dhe 22. Kjo rezulton nga ndarje të ndryshme të numërimit: p.sh. një masë për APSFR përfshin disa masa nëse llogaritet në nivel NJQV. Dhe 1 masë në kolonën “të gjitha NJQV-të” përfshin 8 masa nëse numërohen për secilën NJQV. Nëse llogaritet rrjedhimisht në nivel NJQV, numri total i masave do të ishte 522 (90 masa specifike që mund të ndahen në një NJQV të vetme plus 54 masa që ndahen në 8 NJQV; $90+(8 \times 54)=522$).

Ky vëzhgim tregon gjithashtu se numërimi i masave mund të jetë mbështetës për qëllime statistikore ose për të dhënë një pasqyrë të përmbajtjes dhe fokusit të planit, por nuk ka asnjë tregues të mëtejshëm në lidhje me p.sh. cilësinë e planit etj.

Tabela 21: Numri i masave të përzgjedhura në nivel vendor dhe rajonal (Alokimi për NjQV)

Nr.	Lloji i masës (Qarku i Shkodrës)	Numri total i masave								Të gjitha NjQV	Totali
		Ana e Malet	Bërdicë	Bushat	Dajç	Gur I Zi	Rrethina	Shkodër	Velipojë		
1.	Aspekti: Parandalimi i rreziqeve	4	1	4	2	1	1	3	30	46	
1.1	Instrumentet administrative			2	1			1	15	19	
1.1.1.	Hartëzimi i zonave të rrezikuara nga përmbytjet								6	6	
1.1.2.	Kufizime për ndërtime në zonat me risk								6	6	
1.1.3.	Mbrojtja e fushave aluvionale dhe zonave ujëmbajtëse			2	1			1	3	7	
1.2	Përshtatja e përdorimit të tokës	4	1	2	1	1	1	2	12	24	
1.2.1.	Përshtatja e përdorimit ekzistues të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet		1	1	1	1	1	2	3	10	
1.2.2.	Përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës në zonat me risk	3		1					7	11	
1.2.3.	Konsultimi me ekspertët e bujqësisë dhe pylltarisë për rritjen e ndërgjegjësimit	1							2	3	
1.3	Parandalimi i rrezikut nga ndërtesat e përshtatura me përmbytjet								3	3	
1.3.1.	Menaxhimi i përshtatur me përmbytjet për substancat e rrezikshme për ujë								3	3	
2.	Aspekti: Mbrojtja natyrore nga përmbytjet	6	3	1	5	5	1	3	2	3	
2.1	Menaxhimi natyror i përmbytjeve	6	3	1	5	5	1	3	2	3	
2.1.1.	Rivitalizimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të lumenjve / ish fushat aluvionale	1			2	2				5	
2.1.2.	Ndryshimi i rrjedhave të lumenjve dhe kushteve të pjerrësisë	2	1				1		1	5	
2.1.3.	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumenjve		1		1	3			1	6	
2.1.4.	Mbështetja e zhvillimit të fushave aluvionale natyrore	1		1	1			1	1	5	
2.1.5.	Mirëmbajtja e modifikuar e lumit	1	1		1			1	1	5	
2.1.6.	Prishja/ Heqja e trotuareve në zonat urbane / Menaxhimi i ujërave të shiut	1						2		3	
2.2	Riaktivizimi i zonave ujëmbajtëse										
2.2.1.	Dekonstruksioni i një prite apo dige										
2.2.2.	Rivendosja e pritave										
2.2.3.	Heqja e një bregu artificial										
2.2.4.	Lidhja e një terreni ujëmbajtës										
3.	Aspekti: Mbrojtja teknike nga përmbytjet	5	8	1	10	5	3	3	11	6	
3.1	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Punime në fushat aluvionale	1	2	1	3	1	2	2	3	15	
3.1.1.	Ndërtimi i një pellgu mbajtës										
3.1.2.	Krijimi i një toke të bonifikuar për mbajtjen e ujit										
3.1.3.	Restaurimi, zgjerimi apo përmirësimi i sistemeve ekzistuese ujëmbajtëse	1	2	1	3	1	2	2	3	15	
3.2	Rregullimi i rrjedhës së ujit (p.sh. prit)	1	2	5	3	1	1	5	2	20	
3.2.1.	Punë për mbrojtjen nga përmbytjet	1								1	
3.2.2.	Forcimi i punëve ekzistuese për mbrojtjen nga përmbytjet					1			2	3	
3.2.3.	Përshtatja e një sistemi të lëvizshëm (stacionar) të mbrojtjes nga përmbytjet										
3.2.4.	Kullimi në zona të mbrojtura dhe mbrojtja nga kthimi i rrjedhës		2		5	2	1	1	5	16	
3.3	Rregullimi i rrjedhës së ujit (p.sh. Trajtimi i lumit)	1	4	2	2	1	1	2	2	12	
3.3.1.	Mbajtja pastër e prerjeve tërthore në zonat e vendbanimeve	1	1			1				5	
3.3.2.	Heqja e ngushticave / kalimeve të ngushta në lumenj		1							1	
3.3.3.	Ndërtimi dhe forcimi i një bypass-i		2		2			2		6	
3.4	Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore									1	
3.4.1.	Menaxhimi i ujërave të shiut								1	1	
3.4.2.	Zhvillimi i një sistemi ujëmbajtës bashkiak										
3.4.3.	Përmirësimi i një sistemi kullimi i përshtatur me përmbytjet										
3.5	Mbrojtja e objekteve	1								1	
3.5.1.	Mbrojtja e ndërtesave individuale										
3.5.2.	Mbrojtja e objekteve të infrastrukturës	1								1	
3.6	Masa të tjera mbrojtëse	1						1	1	3	
3.6.1.	Përmirësimi i menaxhimit të digave/rezervuarëve										
3.6.2.	Mbrojtja ndaj depërtimit dhe ujërave nëntokësore	1						1	1	3	
4.	Aspekti: Përgatitja dhe informimi	2							15	17	
4.1	Përgatitja ekonomike / financiare								3	3	
4.1.1.	Masat paraprake financiare nga rezervat dhe sigurimet								3	3	
4.2	Përgatitja informuese								2	2	
4.2.1.	Përmirësimi i parashikimit të përmbytjeve dhe paralajmërimit / mesazheve për përmbytje								2	2	
4.3	Përgatitje në lidhje me reagimin ndaj përmbytjeve								3	3	

4.3.1.	Publikimi i hartave të rrezikut dhe hartave të riskut nga përmbytjet afër vendit								2	2
4.3.2.	Avancimi i vazhdueshëm i rritjes së ndërgjegjësimit dhe publicitetit								1	1
4.4	Kompensimi, përgatitja, pas përpunimit	2							8	10
4.4.1.	Përafrimi ose optimizimi i skemave të njoftimit dhe funksionimit								2	2
4.4.2.	Mbrojtja civile	2							5	7
4.4.3.	Mbledhja dhe analizimi i përvojave në lidhje me përmbytjet								1	1
	Total: masa për NjQV	17	12	6	17	11	5	6	16	144

Tabela 22: Numri i masave të përzgjedhura në nivel vendor dhe rajonal (alokim për ZRRPKP)

Nr.	Lloji i masës	numri i masave në ZRRPKP			
		AL-4	AL-5	AL-6	Totali
1	Aspekti: Parandalimi i rreziqeve	29	29	41	99
1.1	Instrumentet administrative	14	14	18	46
1.1.1.	Hartëzimi i zonave të rrezikuara nga përmbytjet	6	6	6	18
1.1.2.	Kufizime për ndërtime në zonat me risk	6	6	6	18
1.1.3.	Mbrojtja e fushave aluvionale dhe zonave ujëmbajtëse	2	2	6	10
1.2	Përshtatja e përdorimit të tokës	12	12	20	44
1.2.1.	Përshtatja e përdorimit ekzistues të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet	3	3	6	12
1.2.2.	Përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës në zonat me risk	7	7	11	25
1.2.3.	Konsultimi me ekspertët e bujqësisë dhe pylltarisë për rritjen e ndërgjegjësimit	2	2	3	7
1.3	Parandalimi i rrezikut nga ndërtesat e përshtatura me përmbytjet	3	3	3	9
1.3.1.	Menaxhimi i përshtatur me përmbytjet për substancat e rrezikshme për ujin	3	3	3	9
2	Aspekti: Mbrojtja natyrore nga përmbytjet	5	6	21	32
2.1	Menaxhimi natyror i përmbytjeve	5	6	21	32
2.1.1.	Rivitalizimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të lumenjve / ish fushat aluvionale			5	5
2.1.2.	Ndryshimi i rrjedhave të lumenjve dhe kushteve të pjerrësisë	1	2	4	7
2.1.3.	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumenjve	1	1	6	8
2.1.4.	Mbështetja e zhvillimit të fushave aluvionale natyrore	1	1	4	6
2.1.5.	Mirëmbajtja e modifikuar e lumit			1	1
2.1.6.	Prishja/ Heqja e trotuareve në zonat urbane / Menaxhimi i ujërave të shiut	2	2	1	5
2.2	Riaktivizimi i zonave ujëmbajtëse				
2.2.1.	Dekonstruksioni i një prite apo dige				
2.2.2.	Rivendosja e pritave				
2.2.3.	Heqja e një bregu artificial				
2.2.4.	Lidhja e një terreni ujëmbajtës				
3	Aspekti: Mbrojtja teknike nga përmbytjet	4	8	41	53
3.1	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Punime në fushat aluvionale	1	2	10	13
3.1.1.	Ndërtimi i një pellgu mbajtës				
3.1.2.	Krijimi i një toke të bonifikuar për mbajtjen e ujit				
3.1.3.	Restaurimi, zgjerimi apo përmirësimi i sistemeve ekzistuese ujëmbajtëse	1	2	10	13
3.2	Rregullimi i rrjedhës së ujit (p.sh. pritë)	2	4	16	22
3.2.1.	Punë për mbrojtjen nga përmbytjet			1	1

3.2.2.	Forcimi i punëve ekzistuese për mbrojtjen nga përmbytjet	2	2	3	7
3.2.3.	Përshtatja e një sistemi të lëvizshëm (stacionar) të mbrojtjes nga përmbytjet				
3.2.4.	Kullimi në zona të mbrojtura dhe mbrojtja nga kthimi i rrjedhës		2	12	14
3.3	Rregullimi i rrjedhës së ujit (p.sh. Trajtimi i lumit)			11	11
3.3.1.	Mbajtja pastër e prerjeve tërthore në zonat e vendbanimeve			5	5
3.3.2.	Heqja e ngushticave / kalimeve të ngushta në lumenj			1	1
3.3.3.	Ndërtimi dhe forcimi i një bypass-i			5	5
3.4	Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore		1		1
3.4.1.	Menaxhimi i ujërave të shiut		1		1
3.4.2.	Zhvillimi i një sistemi ujëmbajtës bashkiak				
3.4.3.	Përmirësimi i një sistemi kullimi i përshtatur me përmbytjet				
3.5	Mbrojtja e objekteve			1	1
3.5.1.	Mbrojtja e ndërtesave individuale				
3.5.2.	Mbrojtja e objekteve të infrastrukturës			1	1
3.6	Masa të tjera mbrojtëse	1	1	3	5
3.6.1.	Përmirësimi i menaxhimit të digave/rezervuarëve				
3.6.2.	Mbrojtja ndaj depërimit dhe ujërave nëntokësorë	1	1	3	5
4	Aspekti: Përgatitja dhe informimi	15	15	18	48
4.1	Përgatitja ekonomike / financiare	3	3	3	9
4.1.1.	Masat paraprake financiare nga rezervat dhe sigurimet	3	3	3	9
4.2	Përgatitja informuese	2	2	2	6
4.2.1.	Përmirësimi i parashikimit të përmbytjeve dhe paralajmërimit / mesazheve për përmbytje	2	2	2	6
4.3	Përgatitje në lidhje me reagimin ndaj përmbytjeve	3	3	3	9
4.3.1.	Publikimi i hartave të rrezikut dhe hartave të riskut nga përmbytjet afër vendit	2	2	2	6
4.3.2.	Avancimi i vazhdueshëm i rritjes së ndërgjegjësimit dhe publicitetit	1	1	1	3
4.4	Kompensimi, përgatitja, pas përpunimit	7	7	10	24
4.4.1.	Përafrimi ose optimizimi i skemave të njoftimit dhe funksionimit	2	2	2	6
4.4.2.	Mbrojtja civile	4	4	7	15
4.4.3.	Mbledhja dhe analizimi i përvojave në lidhje me përmbytjet	1	1	1	3
Total: masa për ZONAT ME RREZIKSHMERI		53	58	121	232

Shënim: Llojet e masave me “ngjyrë gri” nuk janë parashikuar për zbatim në Shtojcën B të masave të PMRP.

Në lidhje me përcaktimin e masave në ZRRPKP për çdo aspekt të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

Tabela 23 jep një pasqyrë (numri total i masave është më i lartë për shkak të masave të cilat janë caktuar në më shumë se një masë; e përmbledhur në planin e veprimtari si një masë për “të gjitha NJQV-të”):

Tabela 23: Numri i masave të përzgjedhura sipas aspekteve kryesore dhe përcaktimit të tyre në ZRRPKP

Nr. I masave në ZRRPKP	DRIN-BUNA 4	DRIN-BUNA 5	DRIN-BUNA 6
1: Aspekti: Parandalimi i rreziqeve	29	29	41
2: Aspekti: Mbrojtja natyrore nga përmbytjet	5	6	21
3: Aspekti: Mbrojtja teknike nga përmbytjet	4	8	41
4: Aspekti: Përgatitja dhe informimi	15	15	18
Totali	53	58	121

Nga tabelat e mësipërme bëhet e qartë se jo për të gjitha llojet e masave të katalogut janë përzgjedhur masa specifike për zonën e projektit. Kjo është e arsyeshme pasi situata dhe nevoja për zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet nuk është e njëjtë në të gjitha zonat e rrezikuara nga përmbytjet. P.sh. lloji 2.2 (riaktivizimi i zonave ujëmbajtëse) nuk u identifikua si një masë e përshtatshme për momentin për këtë plan MRP, pasi ajo është një masë për zonën e rrjedhës së sipërme, por jo për ultësirën dhe në zonën e deltës. Pjesa më e madhe e llojeve të masave janë përzgjedhur për masat për qarkun e Shkodrës.

6.3.1. Aspekti 1: Parandalimi i rrezikut

Masat për parandalimin e rrezikut ndahen në tre kategori (1.1.-1.3.):

- Instrumente administrative për të krijuar/ përmirësuar bazën e politikës për shmangien e rrezikut,
- Masa për përshtatjen e përdorimit të tokës dhe
- Parandalimi i rrezikut nga ndërtesat e përshtatura me përmbytjet

Figura jep një pasqyrë të masave të cilat janë menduar si të nevojshme në nivel komunal, rajonal dhe kombëtar për MRP në qarkun e Shkodrës (në të gjitha NjQV).

Plani MRP përfshin 41 masa të cilat fokusohen në parandalimin e rrezikut nga përmbytjet dhe në shmangien e rreziqeve të reja. Pjesa më e madhe e masave në këtë fushë veprimi kanë një karakter të “mirëmbajtjes së vazhdueshme”. Figura 41 tregon se 17 masa janë identifikuar si masa mbështetëse për të reduktuar rrezikun dhe duhet të nisen dhe të zbatohen gjatë ciklit të ardhshëm 6-vjeçar.

Duke krahasuar tre kategoritë në trajtimin e MRP në nivel BE-je, mbrojtja e mjedisit nga substancat potencialisht ndotëse për ujin në rast përmbytjesh (1.3.) luan një rol të vogël. Si rrjedhojë, rekomandohen studime të mëtejshme për të mos neglizhuar këtë kategori.




Figura 41: Masa për parandalimin e rrezikut dhe statusi i tyre i zbatimit

6.3.2. Aspekti 2: Mbrojtja natyrore nga përmbytjet

Masat natyrore për mbrojtjen nga përmbytjet ndahen në dy kategori (2.1. Dhe 2.2.).

- Menaxhimi natyror nga përmbytjet dhe
- Riaktivizimi i zonave ujëmbajtëse

Çdo kategori e masave natyrore të mbrojtjes nga përmblytjet përmban disa masa specifike, të cilat janë paraqitur në Figura . Gjithashtu, figura tregon statusin e zbatimit të masave në çdo fushë veprimi për qarkun e Shkodrës.

Për këtë fushë veprimi (masat natyrore të mbrojtjes nga përmblytjet) figura ilustron fokusin në mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mbajtjen pastër të trupave ujorë dhe të kanaleve dhe rivitalizimin e brigjeve të lumenjve, si dhe zgjidhje të bazuara në natyrë për përmirësimin e argjinaturave dhe mbrojtjen e brigjeve të lumenjve dhe të zonave përgjatë vijave ujore. Rizhvillimi i fushave aluvionale natyrore për të mbrojtur brigjet e lumenjve dhe gjithashtu për të rritur kapacitetet ujëmbajtëse ka një rëndësi të madhe në këtë fushë veprimi.

Mbajtja e ujit në ujëmbledhës, zgjidhjet e bazuara në natyrë për ruajtjen e ujit në zonat ujëmbajtëse, depozitimi dhe infiltrimi i ujërave të shiut nuk janë ende pjesë e axhendës së MRP. Këtu, studime të mëtejshme mund të ndihmojnë për të iniciuar zgjidhje dhe masa.

Krahasuar me të gjitha aspektet e tjera të BE-së të MRP, masat e kësaj fushe nuk janë zbatuar në nivel të lartë. Realizimi i masave në këtë fushë veprimi shpesh kërkon fonde për planifikim të detajuar, studime fizibiliteti dhe ndikimi dhe ndërtime. Për të avancuar më tej në këtë fushë veprimi, duhet të caktohen kapacitete shtesë për sa i përket stafit dhe buxheteve.

Planifikimi dhe procedurat e lejes ngadalësojnë progresin në këtë fushë veprimi në krahasim me masat më pak strukturore. Kjo është tipike në krahasim me studime dhe plane MRP të ngjashme nga basene lumore dhe rajone të tjera në Evropë. Për të avancuar në këtë fushë, rekomandohet fokusimi në masat më efektive të cilat ende nuk kanë filluar në lidhje me zvogëlimin e rrezikut nga përmblytjet për periudhën e ardhshme të MRP.




Figura 42: Masat natyrore për mbrojtjen nga përmbytjet dhe statusi i tyre i zbatimit

6.3.3. Aspekti 3: Mbrojtja teknike nga përmbytjet

Masat teknike për mbrojtjen nga përmbytjet ndahen në gjashtë kategori (3.1.-3.6.):

- Rregullimi i rrjedhës së ujit në lidhje me mbajtjen e shtuar (në fusha aluvionale)
- Rregullimi i rrjedhës së ujit në lidhje me mbrojtjen (prita, diga, mure mbrojtëse)
- Rregullimi i rrjedhës së ujit në lidhje me shkarkimin e siguar/ të shtuar të lumit/kanalit
- Menaxhimi i ujërave sipërfaqësore në lidhje me ujërat e shiut në ujëmbledhës (urbane, rurale)
- Mbrojtja teknike e objekteve dhe infrastrukturës dhe

- Masa të tjera mbrojtëse

Çdo kategori e masave teknike të mbrojtjes përmban disa fusha veprimi specifike dhe masa specifike, të cilat janë ilustruar në Figura 43 duke përfshirë statusin e tyre të zbatimit.

Për këtë fushë veprimi (masat teknike për mbrojtjen nga përmbytjet) numri total i masave (45) dhe statusi i zbatimit është i ulët ose më i ulët në krahasim me fushat e tjera të veprimit, duke përfshirë masat në kategorinë 3.1.3. pasi ato i referohen punëve të rregullta për mirëmbajtjen e kanaleve të kullimit në zona të ndryshme të përmbytura dhe masat në kategorinë 3.2.4. pasi ato i referohen rindërtimit të argjinaturave ekzistuese në zonat e ndryshme përkatëse.

Lënia e masave në vazhdimësi në 3.1.3. dhe 3.2.4. lejon një analizë të thellë si më poshtë.

Nuk është surprizuese që një numër i madh i masave të pafilluara dominojnë këtë kategori pasi masat teknike për mbrojtjen nga përmbytjet, të ngjashme me masat natyrore për mbrojtjen nga përmbytjet, shpesh kërkojnë fonde për planifikim të detajuar, studime fizibiliteti dhe ndikimi dhe ndërtime. Gjithashtu, planifikimi dhe procedurat e lejes ngadalësojnë progresin në këtë fushë veprimi në krahasim me masat më pak strukturore. Kjo është tipike në krahasim me studime dhe plane MRP të ngjashme nga basene lumore dhe rajone të tjera në Evropë.

Për më tepër, hartat e rrezikut dhe hartat e riskut për rajonin e Shkodrës tregojnë qartë zonën e madhe të rrezikut e cila përfshin disa fshatra, shtëpi dhe infrastrukturën. Si rajon në zonën e rrjedhës së poshtme të basenit lumor Drin-Bunë, rreziku nga përmbytjet është kryesisht rezultat i aktiviteteve dhe ndikimit në rrjedhën e sipërme. Si rrjedhojë, mbrojtja teknike në këtë rajon ka

- efekt të kufizuar për sa i përket zvogëlimin të rrezikut nga përmbytjet, pasi masat vendore të mbrojtjes që janë të realizueshme kanë potencial të kufizuar lokal për zvogëlimin e rrezikut ose
- masat teknike për një zonë rreziku kaq të gjerë dhe të sheshtë janë me kosto intensive (si p.sh. diga të larta, ndryshim gjithëpërfshirës i rrjedhave ujore, pellgje të mëdha ujëmbajtëse, punë mbrojtëse teknike në objekte etj.), me ndikim të kufizuar.

Sfidë shtesë është krijimi i një mase mbrojtëse teknike për mbrojtjen nga përmbytjet në një vend pa ndikuar negativisht një vend tjetër (në rrjedhën e poshtme, përtej kufirit).

Ndaj, numri i vogël i masave teknike për mbrojtjen nga përmbytjet në planin MRP deri më sot pasqyron specialitetet e rajonit, si p.sh. karakteristikat e një zone në rrjedhën e poshtme/ rajonit të deltës dhe origjinën specifike të rrezikut nga përmbytjet në rrjedhën e sipërme, kështu që masat teknike me kosto efektive janë të vështira për tu identifikuar. Direktiva e BE-së për përmbytjet kërkon një prioritet për masat jostrukturore me kosto efektive, e cila reflektohet në këtë plan MRP.




Figura 43: Masat teknike për mbrojtjen nga përmbytjet dhe statusi i tyre i zbatimit

Masat teknike të cilat tashmë kanë filluar dhe janë me “karakter të vazhdueshëm” (shih Figura 43) fokusohen në mirëmbajtjen dhe përmirësimin/ forcimin e punëve ekzistuese për mbrojtjen nga përmbytjet dhe mirëmbajtjen e brigjeve të lumenjve dhe të kanaleve.

Në tërësi, për të avancuar në këtë fushë veprimi duke trajtuar masat e pafilluara, duhet të caktohen kapacitete shtesë për sa i përket stafit dhe buxheteve. Studime të mëtejshme duhet të rishikojnë fizibilitetin dhe financimin e zbatimit të masave mbrojtëse të listuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për mbrojtjen e infrastrukturave specifike, si p.sh. mbrojtjen e objekteve specifike, si infrastruktura e ujësjellësit, energjisë apo infrastruktura e komunikimit etj.) si dhe të rrisin dhe menaxhojnë kapacitetet ujëmbajtëse për të reduktuar rrezikun nga përmbytjet në zonë si për shembull menaxhimi i përmbytjeve në vende të caktuara për të mbrojtur vende e tjera më të rëndësishme.

6.3.4. Aspekti 4: Përgatitja dhe informimi

Masat e përgatitjes dhe të informimit ndahen në katër kategori (4.1.-4.4.):

- Përgatitje ekonomike,
- Përgatitja informuese (parashikimi dhe paralajmërimi),
- Përgatitja në lidhje me sjelljen dhe
- Përgatitja dhe përpunimi i kontrollit të rrezikut.

Secila nga këto fusha veprimi përmban disa masa specifike, të cilat shfaqen në 44 duke përfshirë statusin respektiv të zbatimit të masave.

Në këtë fushë veprimi 18 masa janë të rëndësishme për të gjithë zonën e projektit. Pjesa më e madhe e masave të cilat janë nisur lidhen me parashikimin e përmblytjeve, skemat/sistemet e lajmërimit dhe të alarmit si dhe me detyra të ndryshme për përmirësimin e përgatitjes së mbrojtjes civile dhe menaxhimit të emergjencave/fatkeqësive. Një parakusht themelor për të gjitha aktivitetet në këtë fushë veprimi është përditësimi i rregullt dhe sigurimi i hartave të rrezikut dhe të riskut nga përmblytjet.

Midis tre aspekteve të tjera të BE-së të MRP, kjo fushë veprimi ka përqindjen relativisht më të lartë të masave në vazhdimësi në krahasim me masat e pafilluara. Statusi i zbatimit të masave në këtë fushë veprimi tregon një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Rrjedhimisht, për këtë kategori, pjesa më e madhe e masave respektive janë me karakter “mirëmbajtjeje të vazhdueshme” të cilat nënkuptojnë se masat kanë filluar, përsëriten periodikisht, përmirësohen dhe rishikohen rregullisht. Megjithatë, cilësia e zbatimit mund të variojë nga njëra masë në tjetrën.

Në tërësi, numri i lartë i masave në vazhdimësi në këtë fushë veprimi pasqyron rëndësinë e madhe të përgatitjes dhe të informimit për uljen e dëmeve dhe numrit të viktimave në situata ekstreme përmblytjesh. Vetëm me informimin dhe ndërgjegjësimin e duhur në njërin anë, dhe përgatitjen e publikut dhe emergjencave civile si dhe të organizatave të tjera përgjegjëse në anën tjetër, mund të kryhen si duhet dhe me efektivitet aktivitetet për reduktimin e dëmeve.




Figura 44: Masat e përgatitjes dhe të informimit dhe statusi i tyre i zbatimit

Krahas masave që kanë të bëjnë me përgatitjen financiare, si skemat e sigurimit, veçanërisht monitorimi i rregullt i ecurisë së të gjitha instrumenteve, fushatat, trajnimet dhe përmirësimi i skemave dhe i strukturave mbeten të rëndësishme edhe për periudhën 2023-2028 në këtë fushë veprimi.

6.4 Masat sipas Zonave me Rrezikshmëri dhe masat e përzgjedhura dhe statusi i zbatimit për territoret e NjQV

Figura 45 jep një pasqyrë të numrit të masave sipas 4 aspekteve kryesore dhe territorit të zonave të identifikuara me rrezik nga përmbytjet Drin-Buna 4, 5 dhe 6 dhe Figura 46 jep një pasqyrë të shpërndarjes së masave në katër fushat kryesore të veprimit të caktuara për NjQV-të e ndryshme në zonën e projektit dhe të masave të cilat mbulojnë të gjitha NjQV.

Të gjitha detajet e masave të përzgjedhura për çdo NjQV, për çdo fushë specifike veprimi, statusi i zbatimit dhe përgjegjësia për zbatimin e tyre janë të listuara në Shtojcën B.




Figura 45: Masat sipas Zonave me rrezikshmëri nga përmbytjet







Figura 46: Masat dhe statusi i zbatimit në fushat e veprimit në NjQV të ndryshme

6.5 Prioritetet për zbatimin e masave

Masat e përzgjedhura janë vlerësuar sipas kriterëve të mëposhtme:

- Ndikimet pozitive (në lidhje me objektet e MRP);
- Ndikimet (e tërthorta) negative (efektet e mundshme ekologjike apo efektet negative të tjerët);
- Kompleksiteti / kostoja (të lehta për t'u realizuar ose të vështira / me kosto të larta).

Skema e mëposhtme e vlerësimit përfshin kriteret:

Kriteret	 pozitive	 neutrale / mesatare	 negative
Efektet në zvogëlimin e riskut	<ul style="list-style-type: none"> • Mund të pritet kontribut në një apo më shumë objektiva brenda 12 muajve. • Mund të pritet zvogëlim i riskut / e dëmeve në përmbytjen e radhës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pasojat nuk janë të qarta. • Mund të priten kontribute në një apo më shumë objektiva në periudhën afatmesme apo afatgjatë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk priten efekte pozitive në zonën në fjalë.
Efekte (ekologjike) negative	<ul style="list-style-type: none"> • Asnjë ndikim negativ nuk mund të shihet bazuar në njohuritë aktuale. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pasojat nuk mund të vlerësohen bazuar në gjendjen aktuale të planifikimit / njohurive. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikime potencialisht negative në ekologji apo në zona / rajone të tjera.
Vështirësi realizimi / mundësie për tu realizuar	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimi nuk është kompleks. • Mund të realizohet brenda 12 muajve kryesisht me burimet vetjake. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mund të realizohet brenda 12- 24 muajve. • Realizim kryesisht me burime vetjake; nevojiten burime shtesë por mund të aktivizohen. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shumë komplekse. • Nevojiten studime / planifikime shtesë. • Nuk mund të kryhet me burime vetjake. • Duhet të përfshihen aktorë shtesë / të jashtëm.
Kostot	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk nevojiten kosto të larta (< 1,000 €). • Mund të paguhen me buxhetin ekzistues. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kosto prej 1,000 – 10,000 € • Duhet të financohet nga buxhete të jashtme. • Mendohet se mund të gjenden buxhete (ekziston ideja). 	<ul style="list-style-type: none"> • Kosto të larta (> 10,000 €) • Nevojiten buxhete të jashtme. • Nuk është e qartë nëse mund të gjenden buxhete (nuk ekziston asnjë ide).
Rezultati: Prioriteti	Prioriteti 1	Prioriteti 2	Prioriteti 3
Rezultati: Prioriteti	<ul style="list-style-type: none"> • Realizim afatshkurtër (1-2 vjet); brenda ciklit të ardhshëm të MRP • Kryesisht me burime vetjake 	<ul style="list-style-type: none"> • Realizim afatmesëm (3-6 vjet); brenda ciklit të ardhshëm të MRP • Duhet të gjenden burime shtesë 	<ul style="list-style-type: none"> • Realizim në periudhë afatgjatë (>6 vjet); pas ciklit të ardhshëm të MRP • Buxhetet e nevojshme, fondet/donatorët duhet të gjenden

Prioriteti është kombinim i kriterëve të lartpërmendura. Bazuar në vlerësimin e të gjitha masave, prioritetet u diskutuan dhe u dakordësuan së bashku me partnerët vendorë dhe rajonalë të projektit në një proces konsensual.

Prioritizimi i masave të përzgjedhura (prioritetet 1-3) është ilustruar në figurën e mëposhtme (për detaje referojuni listës së masave në Shtojcën B).




Figura 47: Numri i masave të përzgjedhura sipas aspekteve kryesore për çdo prioritet

6.6. Përgjegjësia e zbatimit

Për realizimin e masave të caktuara janë caktuar institucione të ndryshme, sipas mandateve dhe përgjegjësive të tyre, në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar (shih listën e masave në Shtojcën B).




Figura 48: Përgjegjësitë në nivel kombëtar, rajonal apo vendor

Përgjegjësitë e dakordësuara për realizimin e masave specifike të identifikuar janë radhitur në listën e masave në shtojcën B.

6.7 Zbatimi dhe monitorimi

6.7.1. Kalendar i zbatimit

Sipas direktivës së BE-së për përmblytjet, planet e MRP duhet të përditësohet në një cikël gjashtë vjeçar. Megjithatë, ky është vetëm kalendar për monitorimin dhe rishikimin e planeve. Realizimi i masave duhet të fillojë dhe të përfundojë në varësi të prioritetit të vendosur. Siç është listuar në kriteret e prioritizimit, periudhat e mëposhtme të realizimit duhet të jenë qëllimi:

- Prioriteti 1: Duhet të realizohet brenda 12 muajve; kryesisht me burimet vetjake.
- Prioriteti 2: Duhet të realizohet brenda 12 - 24 muajve; deri sa të jetë e nevojshme për planifikim të mëtejshëm, përgatitje dhe mbledhje fondesh.
- Prioriteti 3: Koha e realizimit nuk mund të përcaktohet; nevojiten studime apo planifikime të mëtejshme. Pjesa më e madhe e këtyre masave nuk mund

të kryhet me burime vetjake dhe nevojitet përfshirja e aktorëve shtesë apo të jashtëm.

Këto masa duhet të ndiqen, monitorohen dhe të përditësohen të rastin më të mirë çdo 12 muaj, dhe të paktën çdo 2-3 vjet.

6.7.2. Mundësi financimi për zbatim

Duke qenë se shumë masa të identifikuar nuk kanë nevojë për financim të madh, financimi i zbatimit të masave të tilla duhet të ofrohet nga buxheti i qeverive vendore, prefekturës, qarkut, etj. dhe duhet të konsiderohet në planifikimin vjetor të buxhetit. Krahas kësaj, ka disa mundësi financimi në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar të cilat mund të përdoren nga qarku dhe njësitë e qeverisjes vendore për të zbatuar masat.

Në nivel rajonal, qarku i Shkodrës përfiton nga:

- Portofoli i financimit të Programit për Zhvillimin Rajonal - Shqipëria Veriore (projekte të vogla e të mesme) (<http://www.rdpnorthernalbania.org/>);
- Programi i Decentralizimit dhe Zhvillimit Lokal (mbështetje për menaxhimin e mbetjeve dhe hartimin e projekt propozimeve) (<http://www.dldp.al/dldp/>);
- Agjencia për Zhvillimin e Zonës Malore (ofron mbështetje për fermerët) (<http://en.redeval.org/>).

Ndërsa në nivel kombëtar, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve¹⁷ dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (<http://www.albaniandf.org>). Por këtë fonde si dhe fondet të cilat vijnë nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural mund të përdoren për ndërhyrje infrastrukturore.

Në nivel ndërkombëtar, NjQV dhe Qarku mund të përfitojnë nga mundësitë e mëposhtme të financimit:

- Programi IPA për bashkëpunimin ndërkufitar Shqipëri - Mal i Zi (<http://www.albania-montenegro.org/index.html>) dhe
- IPA Adriatic (<http://www.adriaticpacbc.org/>) të dyja me fokus në ndihmë teknike;
- Fondi i Partneritetit i Ekosistemit Kritik (për masa të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mbrojtjen natyrore nga përmbytjet) (<http://www.cepf.net/Pages/default.aspx>).

Gjithashtu, mund të ketë mundësi të tjera financimi të cilat duhet të vlerësohen në mënyrë proaktive.

¹⁷ <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/nje-fond-i-qeverise-per-rilindjen-urbane-si-asnjehere-me-pare>

6.8 Monitorimi

Kuadri i monitorimit përcakton masat që mund të përdoren nga organizatat përgjegjëse (AMBU dhe ZABU; pjesërisht bashkia për masat nën përgjegjësinë e tyre) për të monitoruar zbatimin e planit dhe masat e tij së bashku me njësitë e qeverisjes vendore.

Pasiguritë e lidhura me karakterin strategjik të masave e bëjnë monitorimin edhe më të rëndësishëm, pasi në një proces periodik rishikimi, mund të shtohen rregullisht detaje për zbatimin e tyre. Monitorimi lejon kontrolle periodike

- të progresit të zbatimit
- për të konfirmuar saktësinë e supozimeve ku është bazuar plani origjinal
- për të siguruar se masat e propozuara të reduktimit të rrezikut janë ende të përshtatshme dhe po zbatohen në mënyrë efektive dhe
- për të riparë planin e veprimit periodikisht.

Monitorimi duhet të përfshijë:

Kriteret e monitorimit	Pyetje për t'u përgjigjur
Statusin e realizimit të masave të planifikuara	<ul style="list-style-type: none"> • A kanë filluar apo përfunduar masat e planifikuara? (shih kategoritë e statusit në listën e masave) • Cilat ishin pengesat në rast se masat nuk kishin filluar?
Efikasiteti i masave të realizuara	<ul style="list-style-type: none"> • A e ndryshuan situatën e rrezikut masat e marra? • Si mund të përshkruhen ose llogariten efektet zbutëse? • Nëse nuk ka efekte të dukshme: pse? Çfarë mund të përmirësohet për të rritur efektet e zvogëlimit të rrezikut? • A pati pasoja negative (të paparashikuara)?
Ndryshimi i kuadrit apo i supozimeve	<ul style="list-style-type: none"> • A u prek plani i veprimit nga ndryshime të rëndësishme? (Administrative? Fizike? Të popullsisë? etj.) • A kanë filluar projekte të tjera të cilat ndryshojnë kuadrin e planit të veprimit? • A po afrojnë projekte të tjera të cilat duhet të marrin parasysh veprimet e MRP (nevojë për komunikim)?
Përditësimi i planit të veprimit	<ul style="list-style-type: none"> • Cilat masa duhet të ndryshohen / përshtaten / hiqen nga plani i veprimit? • A janë përshtatjet e nevojshme?
Efektet mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> • A janë të dukshme efektet ekologjike të cilat ndryshojnë rezultatet e vlerësimit mjedisor?
Komunikimi; ndryshime administrative / personale	<ul style="list-style-type: none"> • A është procesi i komunikimit dhe i koordinimit në rregull? Apo është përshtatur apo përmirësuar? • A kanë ndodhur ndryshime administrative apo personale të cilat kërkojnë përshtatje në planin e veprimit (apo në komunikim)?

Mjetet e monitorimit

Veprimet e mëposhtme janë sugjeruar si mjete monitorimi për llojet e masave të planit.

Tabela 24: Mjetet e monitorimit të sugjeruara

Veprimi	Produkte për tu monitoruar / mjete	Afatet kohore
Kontrolle dhe mbledhje informacioni sipas kritereve të monitorimit	Raporte mbi statusin e zonave të rrezikut, masave, komunikimit etj. (shih kriteret). → tabela / formati për tu përditësuar rregullisht; komente	Çdo 24 muaj (nga marrëveshja për planin MRP në grupin e punës)
Koordinimi midis aktorëve dhe organeve të tjera të lidhura me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.	<ul style="list-style-type: none"> • 6 takime mujore të grupit rajonal të punës së MRP • 12 takime mujore për planifikimin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet (takime të zgjatura të grupit të punës) 	Çdo 6 deri në 12 muaj nga miratimi i planit dhe zbatimi i planit.
Përditësimi i planit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet çdo gjashtë vjet	<ul style="list-style-type: none"> • Përditësimi i vlerësimit të rrezikut • Përditësimi i listës së masave (masave të reja, statusit të masave, përshtatja e përshkrimeve/komenteve) 	Çdo 6 vjet sipas direktivës së BE-së për përmbytjet

Periudha e rishikimit

Për të siguruar së zvogëlimi i rrezikut nga përmbytjet do të realizohet në mënyrë aktive dhe me sukses dhe se do të caktohen masat përkatëse, plani i veprimet duhet të rishikohet në lidhje me realizimin e masave dhe të përditësohet në një periudhë të përcaktuar rishikimi. Një periudhë e përshtatshme rishikimi është në 24 muaj apo edhe më shpesh nëse ka kapacitete në dispozicion. Megjithatë, disa masa kanë nevojë për rishikime të vazhdueshme.

Grupi i punës duhet të takohet çdo 6 muaj për të diskutuar periodikisht projektet e ardhshme dhe për të koordinuar veprimet e zbatimit. Grupi i gjerë i interesit (ose: grupi i gjerë i punës) duhet të takohet jo më pak se një herë në vit (çdo 12 muaj).

Plani MRP duhet të rishikohet dhe të përditësohet çdo 6 vjet, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e situatës së rrezikut, statusin e zbatimit të masave dhe për sa i përket progresit të MRP në lidhje me objektivat e përshtatshme (shih Shtojcën B të direktivës së BE-së për përmbytjet).

Aspektet ndërkufitare

Koordinimi i procesit të monitorimit dhe përditësimit duhet të sigurohet për shembull me përfaqësuesit e proceseve të MRP malazeze dhe autoritetet vendore fqinje. Kjo mund të bëhet qoftë në grupin e punës vendor/rajonale apo në një grup pune të veçantë ndërkufitar.

Përgjegjësitë e rishikimit dhe të monitorimit

Përgjegjësia për proceset e MRP duke përfshirë monitorimin dhe përditësimin e aktiviteteve të saj është e AMBU-së. Aktorët dytësorë kryesorë dhe koordinatorët rajonal/ vendor për zbatimin e masave të planit MRP duhet të jenë (1) Prefektura dhe (2) Bashkia e Shkodrës dhe Bashkia e Vaut të Dejës. Ato janë gjithashtu aktorët kryesorë për rishikimin, monitorimin dhe përditësimin e rregullt të planit rajonal MRP në bashkëpunim të ngushtë me institucionin përgjegjës kombëtar AMBU. Grupi i punës ndërinstytucional (kombëtar-rajonale-vendor) duhet të funksionojë si një “grup rishikimi dhe monitorimi”, i koordinuar nga AMBU. Prefektura mund të koordinojë mjetet vendore të monitorimit.

Monitorimi i ndikimeve mjedisore sipas VSM

Monitorimi i ndikimeve të mundshme mjedisore të masave të menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet bazuar në planin e MRP ndjek udhëzimet sipas dokumentit të VSM. Kriteret e monitorimit mjedisor janë vendosur për tu përdorur për monitorimin (shih Shtojcën D dhe E).

7 Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedis (VSM)

Ky kapitull jep një përmbledhje të procesit dhe dokumentit të VSM. Gjetjet dhe rekomandimet e VSM mund të gjenden në Shtojcën D dhe E. Detaje të vlerësimeve dhe të rezultateve të VSM mund të gjenden në dokumentin SEA (raport më vete).

Për planin MRP, do të kryhet një vlerësim i ndikimit në mjedis dhe koncepti përkatës i reduktimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe rregulloreve shqiptare, si p.sh. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM). Standardi ndërkombëtar i cili do të aplikohet është “direktiva e BE-së për përmblytjet 2001/42/KE për vlerësimin e ndikimeve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis” (Direktiva VSM).

Legjislacioni kombëtar mjedisor që lidhet me procedurën VSM është si më poshtë:

- Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” ka ratifikuar direktivën e BE-së për VSM 2001/42/KE, e cila kërkon që të ndërmerren një sërë planesh dhe programesh për një progres të Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Qëllimi i përgjithshëm i këtij procesi është të harmonizojë kërkesat mjedisore në përgatitjet e planifikimit dhe në procesin e vendimmarrjes, por edhe të rrisë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes

- Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një nga kërkesat për miratimin e çdo plani hapësinor (apo planeve me ndikim në territor) në Shqipëri i bazuar në ligjin nr/ 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial” dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe ligjin nr. 10440/2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- VKM nr. 219, datë 11.03.2015, “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9 të nenit 10 të ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013, “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
- VKM nr. 507, datë 10.06.2015, “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.”

Objektivat e SEA janë të identifikojë, përshkruajë dhe të vlerësojë:

- Efektet e mundshme të rëndësishme në mjedis të zbatimit të Planit MRP
- Kufizimet më të rëndësishme mjedisore, të lidhura me burimet natyrore dhe ndryshimet klimatike që ndikojnë në performancën e sektorit
- Mundësitë për Planin MRP për të kontribuar në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, ndërtimin e rezistencës ndaj klimës të sektorit dhe popullsisë, dhe promovimin e zhvillimit të ulët të karbonit dhe kalimit në ekonominë e gjelbër.

Ky informacion ndihmon për të siguruar që shqetësimet mjedisore janë integruar siç duhet në proceset e vendimmarrjes dhe zbatimit. Hapat e përgjithshëm për VSM janë të listuara në Figura 49.

Nëpërmjet një procedure vlerësimi, kriteret e caktuara dhe dokumentet përcaktuan domosdoshmërinë e kryerjes së një VSM për Planin MRP pasi ai mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në mjedis dhe një jetën e njeriut. VSM është i përbërë nga dy pjesë kryesore - një studim i fushëveprimit dhe një studim VSM.

Një studim paraprak VSM jep:

- Një përshkrim të sektorit
- Një përshkrim të politikës së sektorit, kuadrin institucional dhe ligjor
- Një identifikim të grupeve kryesore të interesit dhe një pasqyrë të interesave dhe të shqetësimeve të tyre në lidhje me planin MRP
- Një identifikim të ndërveprimeve kryesore midis dokumentit strategjik dhe mjedisit.
- Një tregues të qëllimit të vlerësimit paraprak mjedisor që do të përgatitet

- Një tregues i metodologjive kryesore të identifikimit dhe vlerësimit të ndikimit që do të përdoren në studimin e VSM




Figura 49 Hapat e përgjithshëm të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)

Rezultatet e studimit paraprak do të përmbliidhen në një raport paraprak.

Studimi i vlerësimit strategjik i ndikimit në mjedis bazohet në rezultatet e fazës paraprake (pas miratimit të raportit të studimit paraprak) dhe përfshin një studim bazë mjedisor, identifikimin e kufizimeve dhe mundësive mjedisore, identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore, një analizë të treguesve të performancës, një vlerësim të kapaciteteve institucionale për të adresuar mjedisin e identifikuar, dhe përfundime e rekomandime. Studimi i VSM-së jep rezultatet e mëposhtme:

- Një vlerësim mjedisor të Planit MRP, duke marrë parasysh rreziqet, kufizimet dhe mundësitë e lidhura me mjedisin

- Rekomandime për formulimin e Planit MRP dhe për përmirësimin e performancës mjedisore të Planit MRP.

Rezultatet e studimit VSM janë përpiluar në një raport VSM.

Shtojca D jep një pasqyrë të objektivave mjedisore dhe treguesve të tyre për qëllime monitorimi ndërsa Shtojca E përmbledh rekomandimet për fushat përkatëse të mëposhtme

- Popullsia dhe shëndeti i njeriut
- Biodiversiteti
- Dheu
- Uji
- Faktorët klimatik
- Asetet materiale
- Trashëgimia kulturore
- Peizazhe.

8 Aspektet e menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet

8.1 Ndikimet e mundshme ndërkufitare të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet

Zona e projektit dhe zona përkatëse e rrezikuar nga përmbytjet kanë dimensione të ndryshme ndërkufitare:

- Baseni Lumor i Drinit është një basen lumor ndërkufitar siç përshkruhet në kapitullin 2.
- Lumi i Drinit është kufiri midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në rreth 20 km e fundit para se të bashkohet me detin Adriatik.
- Zona e rrezikuar nga përmbytjet e Drinit dhe Bunës mbulon krahas territorit shqiptar edhe territorin malazez.
- Liqeni i Shkodrës dhe shkarkimi në lumenjtë e Drinit dhe të Bunës ndikohen nga degët shqiptare dhe malazeze.

Jo vetëm në kuadër të direktivës së BE-së për përmbytjet, aspektet ndërkufitare të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të integrohen në procesin e planifikimit të MRP në basene lumore ndërkombëtare. Direktiva e BE-së për përmbytjet kërkon konkretisht informacionin e përbashkët rreth qasjeve të MRP dhe të koordinimit të masave të MRP për të parandaluar pasojat negative të masave të MRP në vendet fqinje. Zyrtarisht, kjo kërkesë

është e vlefshme vetëm për shtetet anëtare të BE-së; megjithatë, duke qenë se ky plan MRP është në përputhje me direktivën e BE-së për përmblytjet, aspektet e ndërlidhura ndërkufitare janë të arsyeshme. Në detaj, ndikimet ndërkufitare të përmblytjeve (krahas ndikimeve të ndryshme ndërkufitare në zonat e rrjedhës së sipërme) janë:

- Ndikimi i Liqenit (ndërkombëtar) të Shkodrës në situatën e përmblytjeve në rajon;
- Situata në rrjedhën e poshtme të lumit, që do të thotë se të gjitha masat për mirëmbajtjen dhe rindërtimin e lumit, të pritave apo punëve të tjera mbrojtëse mund të kenë një ndikim në territorin fqinj (në të dyja anët: nga Shqipëria në Mal të Zi dhe anasjelltas);
- Parashikimi dhe masat parandaluese janë të lidhura ngushtë ndërmjet zonës shqiptare dhe malazeze të rrezikuar nga përmblytjet në deltë; Mali i Zi varet nga parashikimet e përmblytjeve dhe masat përgatitore të grupeve shqiptare të interesit.

Menaxhimi ndërkufitar i rrezikut nga përmblytjet kërkon hapa të ndryshëm bashkëpunimi:

- Informacion të përbashkët mbi rreziqet dhe veprimet;
- Sistem të përbashkët për vlerësimin, modelimin dhe paralajmërimin e rrezikut;
- Planifikim i përbashkët apo i rregulluar reciprokisht i menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet;
- Planifikimi i përbashkët i reagimit emergjent;
- Komunikimi dhe bashkëpunimi gjatë përmblytjeve / veprimet e përbashkëta të reagimit emergjent.

8.2 Masa specifike me ndikim të mundshëm ndërkufitar

Plani i veprimit / plani i masave (shih kapitullin 0) përfshin një përcaktim të ndikimeve të mundshme ndërkufitare të masave: gjithsej u identifikuan 30 nga 128 masa të cilat mund të kenë ndikim ndërkufitar. Këto janë përgjithësisht masa me ndikim ndërkufitar nga ndryshimet strukturore, mirëmbajtja dhe rindërtimi i lumenjve. Të gjitha pritave apo punët e tjera mbrojtëse mund të kenë ndikim ndërkufitar. Si rrjedhojë, masat me ndikim të mundshëm ndërkufitar mund të gjenden në fushat e veprimit “mbrojtja natyrore nga përmblytjet” dhe “mbrojtja teknike nga përmblytjet” (shih Tabela 25).

Tabela 25: Shpërndarja e masave me ndikim të mundshëm ndërkufitar në aspektet e BE-së të MRP

Trajtimi i MRP në nivel BE-je	Nr. i masave me ndikim të mundshëm ndërkufitar [numri]	Masa me ndikim të mundshëm ndërkufitar [përqindja]
1. Aspekti: Parandalimi i rrezikut	1	2 %
2. Aspekti: Mbrojtja natyrore nga përmblytjet	14	58 %

3. Aspekti: Mbrojtja teknike nga përmbytjet	15	33 %
4. Aspekti: Përgatitja dhe informimi	0	0 %

Ndikimet ndërkufitare mund të jenë pozitive (p.sh. nëse objektet ujëmbajtëse reduktojnë valën e përmbytjes në të dyja anët e lumit në dy shtete) ose negative (nëse përmirësimi i punëve për mbrojtjen nga përmbytjet apo pritad/digat në një anë të lumit në një shtet rrisin rrezikun e përmbytjeve në anën tjetër të lumit në një shtet tjetër).

Tabela 235 specifikon masat e përzgjedhura të këtij plani MRP të cilat mund të kenë ndikime ndërkufitare dhe të cilat duhet të koordinohen apo të planifikohen së bashku dhe të zbatohen në bashkëpunim me shtetin fqinj.

Tabela 26: Karakteristikat e ndikimeve të mundshme ndërkufitare të masave në këtë plan MRP

Lloji i masës me ndikim të mundshëm ndërkufitar (për detaje shih Shtojcën B)		Shpjegimi: Karakteristikat e ndikimit të mundshëm ndërkufitar	Nr. i masave (shtojca)
1.2	Përshtatja e përdorimit ekzistues të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytja (përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë) Masa specifike si p.sh.: mbjellja e bimësisë hidrofille në brigjet e lumenjve / fushat lymore, pyllëzimi i brigjeve të lumenjve.	Duke ndryshuar përdorimin e tokës në zonën ujëmbajtëse dhe përgjatë lumenjve dhe përrenjve, mbledhja e ujit mund të rritet ose zvogëlohet. Ndryshimi në kapacitetin mbajtës mund të ketë ndikim në valët e përmbytjeve në rrjedhën e poshtme. Nëse zonat e rrjedhës së poshtme në basenin lumor janë territori i shteteve fqinje (këtu: Mali i Zi në zonën e Shkodrës përgjatë lumit të Bunës) ndikimet ndërkufitare janë të mundura. Ndryshimet e mëdha në kapacitetin mbajtës në ujëmbledhësit e baseneve lumore ndërkombëtare duhet të jenë subjekt i bashkëpunimit ndërkufitar.	1
2.1	Menaxhimi natyror i përmbytjeve, rregullimi i rrjedhës së ujit	Rregullimi i rrjedhave të ujit ka ndikime potenciale në rrezikun e përmbytjeve (duke ulur ose rritur valët e përmbytjeve). Masat natyrore ose strukturore (teknike) të cilat ndikojnë në derdhjen dhe vërshimin e ujit në lumenj apo përgjatë tyre në rajonet kufitare, kanë rregullisht ndikime (pozitive apo negative) ndërkufitare.	14
3.2	Rregullimi i rrjedhës së ujit / kanalet (prita, diga, mure mbrojtëse dhe mjete të lëvizshme për tu mbrojtur nga përmbytjet)	Ngritja e argjinaturave dhe/ose e pritave/digave ka gjithmonë ndikim negativ në rrezikun e përmbytjeve në bregun e kundërt të lumit. Nëse ky është territori i një shteti fqinj atëherë duhet të merren parasysh ndikimet e mundshme ndërkufitare.	8
3.3	Rregullimi i rrjedhës së ujit / Kanale (Masa / ndërhyrje në lumenj)	Masat specifike të këtij plani MRP janë si p.sh.: rehabilitimi i argjinaturave ekzistuese përgjatë lumit të Bunës dhe mirëmbajtja e shtratit të lumit Drin në Berdicë. Masat respektive duhet të jenë subjekt i bashkëpunimit ndërkufitar dhe planifikimit të përbashkët të masave përgjatë këtyre lumenjve dhe brigjeve.	7
Totali			30

Referojuni Shtojcës B me planin e masave për detaje të mëtejshme të masave me ndikim të mundshëm ndërkufitar.

8.3 Statusi dhe perspektiva e menaxhimit ndërkufitar të rrezikut

Korniza e mëposhtme e bashkëpunimit është caktuar në bashkëpunimin ndërkufitar me institucionet fqinje përgjegjëse të Malit të Zi dhe mund të zhvillohet më tej në të ardhmen për sa i përket përmirësimit të bashkëpunimit ndërkufitar:

Tabela 27: Statusi dhe perspektiva e bashkëpunimit ndërkufitar në qark

Bashkëpunimi, informacioni	Ekziston në nivel kombëtar	Bashkëpunim vendor në nivel të Planit MRP ndërmjet bashkive dhe NjQV-ve.
Grup i zakonshëm pune	Ekziston në nivel kombëtar	Grupet lokale të punës midis bashkive dhe NJQV-ve për MRP dhe reagimin ndaj emergjencave
Vlerësimi / Hartëzimi i rrezikut	Ekziston në nivel kombëtar	Rishikim i përbashkët i rregullt dhe përditësimi i hartave të riskut; vlerësimi i përbashkët i rrezikut
Modelim i përbashkët / parashikim i përbashkët	Pjesërisht duke u zhvilluar; sistemi i parashikimit në projektin e GIZ	Zhvillim i mëtejshëm; trajnim
Reagimi emergjent	Në shkallë të ulët sipas rastit	Plan i përbashkët i reagimit emergjent; trajnime të rregullta

9 Koordinimi me direktivën kuadër të ujit 2000/60/KE

Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmblytjet duhet të marrin parasysh objektivat mjedisore të nenit 4 të direktivës kuadër të ujit (2000/60/KE). Sipas nenit 9 të direktivës së BE-së për përmblytjet, zhvillimi i planeve MRP kryhet në bashkëpunim me, dhe mund të integrohet në, rishikimet e planeve të menaxhimit të basenit lumor të shprehura në nenin 13(7) e direktivës 2000/60/KE.

“Plani i Menaxhimit të Basenit Lumor Drin-Bunë” i qershorit të vitit 2019 u përgatit nën përgjegjësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky plan u vlerësua në procesin e hartimit të MRP për të identifikuar lidhjet dhe sinergjitë apo konfliktet që mund të ndodhin nga krijimi i planit MRP. Synimi afatgjatë i integritetit të dy planeve nuk preket në këtë rishikim.

Rishikimet dhe vlerësimi u fokusuan veçanërisht në kapitujt e mëposhtëm, të cilët janë analizuar dhe integruar në pjesët specifike të Planit MRP.

2 Kuadri ligjor dhe institucional për menaxhimin e ujërave

3 Karakteristikat e përgjithshme të basenit lumor Drin-Bunë

- 4 Presionet dhe ndikimet
- 5 Zonat e mbrojtura
- 9 Menaxhimi i përmbytjeve
- 10 Objektivat mjedisore
- 12 Programi i masave

Për sa i përket menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, PMBL përfshin masat për menaxhimit e basenit lumor bazuar në vlerësimet paraprake të rrezikut nga përmbytjet duke përfshirë rekomandime nga projekte të tjera. Ai nuk i referohet shprehimisht hartave të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet, pasi ato nuk ishin përfunduar deri në vitin 2019, kur u publikua PMBL.

Për të siguruar koordinimin e nevojshëm me planin e fundit të menaxhimit të vitit 2019 sipas direktivës kuadër të BE-së për ujin, gjatë zhvillimit të planit MRP për qarkun e Shkodrës, u vlerësuan ndikimi reciprok, sinergjitë ose konfliktet e mundshme të masave MBL dhe MRP. Metoda e përdorur ndjek një qasje të grupit të punës të BE-së, e cila zbatohet gjithashtu për të gjitha planet MRP në Gjermani: Në varësi të ndikimit të tyre, masat janë identifikuar si të rëndësishme për koordinimin e direktivave dhe u janë caktuar grupeve M1, M2, dhe M3:

M1: Masa të cilat mbështesin objektivat e direktivës tjetër.

Në rastin e planifikimit të MRP, këto masa janë përgjithësisht të përshtatshme për të arritur objektivat e direktivës kuadër të BE-së për ujin. Shtrirja e sinergjisë ndërmjet dy direktivave varet nga hartimi i mëtijshëm i masave në planifikimin e detajuar. Prandaj, në përgjithësi mund të anashkalohet një ekzaminim i mëtijshëm i sinergjive të këtyre masave. Shembujt përfshijnë ndalimin e ndërtimeve në fushat aluvionale nëpërmjet përcaktimit të tyre me ligj apo masat për të rritur mbajtjen natyrore të ujit në zonë, p.sh. duke zhvendosur pritat.

M2: Masa të cilat mund të çojnë në konflikte të objektivave dhe të cilat duhet të ekzaminohen sipas rastit.

Kjo kategori përfshin, nga njëra anë, masat të cilat nuk mund t'u caktohen qartë kategorive M1 dhe M3 dhe, nga ana tjetër, masat të cilat, në rrethana të caktuara, mund të kundërshtojnë objektivat e direktivës tjetër. Këto përfshijnë, për shembull, masat e direktivës kuadër të BE-së për ujin për zhvillimin natyror të vijës ujore në zonat vendore të cilat mund të çojnë në një rrezik të shtuar nga përmbytjet apo masa për bonifikimin e tokës të cilat kontribuojnë në uljen e ndotjes dhe më pas i bashkohen masave të mbrojtjes së bregdetit. Sa i përket masave MRP, më të rëndësishmet janë masat tekniko-infrastrukturore për mbrojtjen nga përmbytjet ose masat inxhinierike lumore.

M3: Masa të cilat nuk janë të rëndësishme për objektivat e direktivës tjetër

Si rregull, këto masa nuk kanë asnjë efekt pozitiv apo negativ në objektivat e direktivës tjetër. Si rrjedhojë, ekzaminimi i mëtejshëm i sinergjive dhe konflikteve të këtyre masave në kuadrin e planifikimit të MRP mund të anashkalohet. Në lidhje me direktivën kuadër të BE-së për ujin, masat jostrukturore të tilla si studimet konceptuale, programet e monitorimit dhe masat administrative, si dhe masat për të reduktuar substancat e shpërndara, duhet të përmenden në veçanti. Në rastin e MRP, në këtë kategori futet pjesa më e madhe e masave jostrukturore, si shërbimet e paralajmërimit dhe të raportimit, planifikimi dhe përgatitjet për parandalimin e rreziqeve dhe kontrollin e fatkeqësive, apo konceptet për kujdesin e mëvonshëm dhe rigjenerimin.

Në Shtojcën C ka një pasqyrë tabelore të sinergjive dhe konflikteve të identifikuara të objektivave të MBL dhe të planit të masave të MRP. Për këtë qëllim, të dy planet kryesisht ndjekin rrugë të qëndrueshme. Nga pikëpamja sasiore, ka më shumë gjasa të ketë një koherencë sinergjike të objektivave të MBL dhe planit të masave të MRP sesa ato konfliktuale. Më poshtë përmbledhet analiza e ndërveprimit të tyre reciprok. Për çdo lloj mase, kategoria e sinergjive potenciale është paraqitur në katalogun e masave në Shtojcën A; për secilën masë të përzgjedhur kategoria emërtohet në listën e masave në Shtojcën B.

Konsistenca midis MBL dhe MRP

Masat e propozuara në PMBL karakterizohen kryesisht nga masa parandaluese të cilat lehtësojnë përkeqësimin e statusit të të gjithë trupave ujorë sipërfaqësorë pasi ndjek paradigmen e direktivës kuadër të BE-së për përmblytjet. Si të tilla, (16 nga 21) objektivat mjedisore të propozuara në PMBL janë disi të lidhura me masat e MRP.

Megjithatë, janë të pranishme të gjitha ndërveprimet që kanë të bëjnë me promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, si p.sh. masat në lidhje me sistemin e furnizimit me ujë, zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës në zona të caktuara të basenit lumor Drin-Bunë si dhe në lidhje me rritjen e kërkesave për menaxhimin e ujit.

Ka dy objektiva të tjera mjedisore të cilat i kushtohen ruajtjes dhe arritjes së një statusi të mirë ekologjik dhe kimik nga njëra anë të trupave ujorë sipërfaqësore dhe nga ana tjetër të ujërave të larjes me fokus në zonat bregdetare: Masat e propozuara mund të vlerësohen si një objektiv përgjithësisht konsistent bashkë me masat MRP.

Për të vlerësuar konsistencën nga perspektiva e MRP, ekzistojnë gjithsej pesë kategori masash MRP të cilat janë plotësisht në përputhje me të gjitha objektivat e MBL pa karakter sinergjik ose konfliktual. Këto janë masa në lidhje me:

- 2.2. Riaktivizimin e zonave ujëmbajtëse
- 3.4. Menaxhimin e ujërave sipërfaqësore
- 3.5. Mbrojtjen e objekteve
- 4.1. Përgatitjen ekonomike/ financiare

- 4.3. Përgatitjen në lidhje me reagimin ndaj përmbytjeve

Sinergjitë ndërmjet MBL dhe MRP

Kategoria më sinergjike e masave MRP me masat MBL është vlerësuar për parandalimin e rrezikut nga përmbytjet. Kjo përfshin masat e propozuara në PMBL, të tilla si:

- Përmirësimi i monitorimit për të gjitha trupat ujorë përmes regjistrave dhe regjistrimit të parametrave të monitorimit të ujit që mund të mundësojnë përpunimin e HRrRP-ve në të ardhmen.
- Në të njëjtën mënyrë, regjistrimi i propozuar i të gjitha fermave industriale dhe sipërfaqes së tyre të tokës bujqësore është i dobishëm për përditësimin e zonave dhe objekteve të rrezikuara.
- Kontaminimi nga përdorimi i pesticideve në bujqësi është një shqetësim specifik në PMBL, ndërsa për basenin lumor Drin-Bunë, Shkodra ka sektorin më të zhvilluar të bujqësisë, duke u larguar nga sistemet e bazuara në familje, në bujqësi intensive, e cila përdor më shumë pesticide, herbicide dhe lëndë ushqyese (PMBL, 2019). Reduktimi i përdorimit të pesticideve nëpërmjet fuqizimit të autoriteteve vendore mbi kontrollin dhe monitorimin e bujqësisë apo programet për rritjen e ndërgjegjësimit të fermerëve, mund të jenë të dobishme për arritjen e cilësisë së mirë të tokës, duke mundësuar mundësisht kultivimin alternativ të tokës bujqësore të përshtatur me përmbytjet.

Një kategori tjetër e MRP, e cila vlen tu përmendur, ka të bëjë me menaxhimin e përmbytjeve natyrore i cila përforcohet nga masat e PMBL nëse ndiqet. PMBL propozon, konkretisht, reduktimin e përdorimit të paligjshëm të inerteve dhe të zhavorreve të lumenjve dhe thekson rëndësinë e reduktimit të erozionit në lumenj.

E fundit, por jo nga rëndësia, rëndësia e rrjedhës së ujit në kanale si një masë teknike e mbrojtjes nga përmbytjet nënkupton nevojën për prerje të qarta tërthore. Ka disa masa të propozuara në PMBL të cilat synojnë përmirësimin e rrjetit të kullimit. Kjo përfshin përmirësimin e drejtpërdrejtë të sistemit të kullimit dhe në varësi të projektimit teknik, përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve në zonat urbane dhe rurale.

Konflikte ndërmjet MBL dhe MRP

Edhe nëse ka vetëm dy objektiva që mund të kenë një ndërveprim konfliktual midis masave MRP dhe MBL, implikimet e tyre janë të mëdha pasi kanë të bëjnë me sistemin teknik të mbrojtjes nga përmbytjet. Ka një nevojë të madhe për rehabilitimin dhe zhvillimin e rrjetit të ujit për tokën bujqësore e cila përfshin edhe digat sipas PMBL. Një ndërhyrje e tillë mund të kundërveprojë me sistemin e instaluar dhe të ndjekur të rregullimit të rrjedhës së ujit që synon të ulë rrezikun nga përmbytjet. Në mënyrë të pashmangshme, kjo kërkon një ekzaminim të veçantë për secilin rast.

Nga ana tjetër, PMBL propozon maksimizimin e përdorimit të potencialit të energjisë hidrike duke promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Kjo përfshin hetime mbi optimizimin e skemave ekzistuese të prodhimit të energjisë hidrike dhe potencialin e HEC-eve (hidrocentraleve të vegjël) për degët e lumenjve. Në varësi të rezultateve të këtyre studimeve, këto mund të kundërveprojnë me çdo masë natyrore për mbrojtjen nga përmbytjet.

10 Informimi i publikut dhe masat e publicitetit

10.1 Përmbledhje e procesit të konsultimit

Përfshirja e grupeve të interesit në të gjitha nivelet dhe e publikut në procesin e MRP është themelore për suksesin e qasjes së MRP. Plani MRP bazohet në strategjinë për të ndarë detyrat me të gjitha organizatat dhe personat përkatës në përgjegjësinë e tyre respektive. Kjo është gjithashtu qasja e direktivës dhe e strategjisë së BE-së për përmbytjet.

Në vijim të kësaj qasjeje, organizatat përkatëse komunale, rajonale dhe kombëtare u përfshinë në procesin e MRP-së në Qarkun e Shkodrës në 2021/2022. Procesi, deri në tani:

- Përgatitja e draftit të parë të planit MRP për rishikimin e anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës (tetor deri në dhjetor 2021)
- Rishikimi i parë i grupit ndërinstitucional të punës (janar 2022)
- Përgatitja e draftit të dytë të planit MRP për rishikimin e anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës (shkurt 2022)
- Rishikimi i dytë i grupit ndërinstitucional të punës (mars 2022)
- Përgatitja e draftit përfundimtar të planit MRP për rishikimin e anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës (prill 2022)
- Rishikimi përfundimtar i draftit të planit MRP të grupit ndërinstitucional të punës (maj 2022)

Nga kjo fazë e më tutje, procesi i konsultimit është i përcaktuar në nivel kombëtar në VKM nr. 1015, datë 16.12.2020, "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet".

Kërkohet miratimi i KKU-së para publikimit zyrtar të draftit të dytë të planit MRP. Më pas, bazuar në shtojcën III, kapitulli 4, numër 6 të VKM-së nr.1015/2020, caktohet një periudhë 6 mujore për rishikimin e autoriteteve përkatëse, publikut, komenteve nga shtetet fqinje të basenit ndërkufitar ujor. Gjatë kësaj periudhe, dëgjuesat publike mund të organizohen nga AMBU-ja.

Drafti i dytë i Planit MRP parashikohet të publikohet në qershor 2022.

10.2 Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe aktivitetet informuese

Aktivitetet në vijim janë propozuar për tu realizuar për të informuar publikun dhe për të rritur ndërgjegjësimin rreth çështjeve të MRP (shih gjithashtu listën e masave në shtojcë):

- Publikimi i hartave rajonale të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet në njësitë e qeverisjes vendore; si një nga masat bazë të rritjes së ndërgjegjësimit, u nda informacion rreth vendit dhe intensitetit të përmbytjeve potenciale (harta të mëdha në qendër të bashkisë; fletëpalosje për t'u shpërndarë në vendbanimet e rrezikuara, publikimi në internet etj.)
- Zhvillimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve të cilat përfshijnë informacion rreth masave për uljen e rrezikut nga përmbytjet, masave individuale paraprake, dhe përgatitjen për përmbytjet.
- Për të ardhmen këto aktivitete duhet të përditësohen, realizohen dhe përsëriten rregullisht në një proces të përhershëm. Lista e masave përmban disa masa prioritare mbi komunikimin dhe informimin të cilat janë të rëndësishme në lidhje me kontributet publike, vetëpërgatitjen, mbrojtjen e fushave aluvionale nga të gjithë, përgatitjen për përmbytjen e radhës. Masat nën "Përgatitja dhe informimi" (aspekti 4 / fusha e veprimit masave) të katalogut duhet të kenë një rëndësi të madhe në një strategji afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Aktorët janë kryesisht bashkitë, prefektura dhe qarku (shih përcaktimin specifik të aktorëve përgjegjës në tabelat e planit të veprimit, të cilat janë emërtuar prej tyre; ndaj, procesi ka arritur një nivel të lartë angazhimi me planin e veprimit).

11 Referencat

- Plani i Mbrojtjes së Biodiversitetit Bashkia Shkodër (2017). *Plani i Mbrojtjes së Biodiversitetit Bashkia Shkodër*,
http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plani_i_mbrojtes_se_biodiversitetit_bashkia_shkoder_2017_1_2418.pdf
- Bogdani, M. (2006). *Vlerësimi i rrezikut nga përmbytjet në lumenjtë e Shqipërisë*, Procedurat e Konferencës Balwois 2006.
- Bota Sot (2021). *Përmbytjet në Shkodër, nis ndarja e ndihmave për familjet e prekura*,
<https://www.botasot.info/shkodra-shqiperia/1481733/permbytjet-ne-shkoder-nis-ndarja-e-ndihmave-per-familjet-e-prekura/>
- Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 835, datë 03.12.2004, "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 682, datë 02.11.2005, "Për shpalljen e Lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij "Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 684, datë 02.11.2005, "Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 219, datë 11.03.2015, "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 507, datë 10.06.2015, "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 1015, datë 16.12.2020, "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet".
- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 19, datë 24.03.2017, "Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Territorit dhe Projektet Strategjike të Zhvillimit të Bashkisë së Shkodrës"
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 5, datë 16.10.2017, "Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Shkodrës"

Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 9, datë 28.12.2020, “Për Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Shkodrës”

Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 1, datë 15.06.2021, “Për miratimin e raporteve të vlerësimit paraprak të rreziqeve nga përmbytjet për basenet ujore Drin-Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin Seman, Vjosë dhe shpalljen e zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhë përmbytje”

Vendimi i Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 3, datë 15.06.2021, “Për Miratimin e Hartave të Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona në Basenin Ujor Drin-Bunë”

Energjia (2018). *Përmbytjet në Shkodër, krahasimi mes 2010 dhe 2018, ndryshimi në menaxhimin e digave*, <http://energjia.al/2018/03/30/permbytjet-ne-shkoder-krahasimi-mes-2010-dhe-2018-ndryshimi-ne-menaxhimin-e-digave>

Grupi i të dhënave evropiane Corine për mbulesën e tokës (CLC) (2012).

Direktiva Evropiane 2007/60/KE për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet (**Direktiva e BE-së për përmbytjet**).

Direktiva Evropiane 2000/60/KE për krijimin e një kuadri për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit (**Direktiva Kuadër e BE-së për Ujin**).

Direktiva Evropiane 91/676/KEE në lidhje me mbrojtjen e ujërave kundër ndotjeve të shkaktuara nga nitratet nga burimet bujqësore (**Direktiva e BE-së për nitratet**).

Direktiva Evropiane 2001/42/KE për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis (**Direktiva e BE-së VSM**).

Bashkimi Evropian (2013). Udhëzim për Raportimin sipas Direktivës për Përmbytjet (2007/60/KE) - Dokumenti Udhëzues nr. 29 A përmbledhje e fletëve të raportimit e miratuar nga Drejtoritë e Ujit, Strategjia e Përbashkët e Zbatimit për Direktivën Kuadër të Ujit (2000/60/EC).

Studimi MRP. (2014). *Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, Qarku Shkodër (Shqipëri)*. Darmstadt (Gjermani): INFRASTRUKTUR & UMWELT.

GNP. (2016). Plani i Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor - dokumenti i parë kombëtar mbi planifikimin hapësinor 2015-2030, i miratuar me VKM nr. 881, datë 14.12.2016, “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”

GLP Shkodër. (2017). Plani i zhvillimit të territorit – Plani i përgjithshëm vendor Bashkia Shkodër. Shkodër (Shqipëri): Bashkia e Shkodrës.

- INFRASTRUKTUR & UMWELT. (2013). *Raporti fillestar për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në Shqipëri*, Projekti rajonal CCAWB i GIZ “Përshtatja me ndryshimet klimatike në Ballkanin Perëndimor”.
- KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare). (2015). *Plani i përgatitjes emergjente Digat e Vaut të Dejës - Raporti Teknik*. Tiranë (Shqipëri): KESH.
- Ligji nr. 9244/2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”
- Ligji nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”
- Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”
- Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar me ligjet në vijim:
- Ligji nr. 73/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”
- Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”
- Ligji nr. 28/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”
- Ligji nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”
- Ligji nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”
- Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”
- Ligji nr. 119/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014”
- LWI. (2014) Instituti për Menaxhimin e Ujërave GmbH, Braunschweig, Gjermani, në bashkëpunim me Institutin Leichtweiss për Inxhinieri Hidraulike dhe Burimet Ujore, Universiteti i Braunschweig, Gjermani: *Zhvilimi dhe Aplikimi i një Modeli Hidrologjik për basenin Drin-Bunë, në kuadër të GIZ, draft shtator 2014*
- Miho, A. (2018). *Aktivitetet e ndërtimit në zonat e mbrojtura shpesh janë të papërshtatshme dhe të paqëndrueshme - rast shqiptar*, Thalassia Salentina, Vëllimi 40, suppl. 2 (2018), Alblakes3 2017, fq. 91-112.
- Miho A., Vasjari M., Vallja L., Duka S., Shehu A., Broli N., Kashta L., Qirjo M., Miri F., Bego F., & Aliko V. (2021). *Qasja ekologjike e kompleksit ligatinor Kune-Vaini (Lezhë): Rezultatet kryesore*, Revista e Shkencave Natyrore dhe Teknike 2021/2, Vëllimi XXVI/53, numri i veçantë i paraqitur në WEPSD-2021 (artikulli në shtyp).

- MM. (2005) Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, "Harta e 'peizazhit ujor/tokësor të mbrojtur' të lumit të Bunës dhe të territoreve ligatinore përreth tij", VKM nr. 682, datë 02.11.2005.
- Mott MacDonald. (2011) Raporti fillestar për vlerësimin dhe studimin e menaxhimit gjithëpërfshirës të rrezikut nga përmytjet pas fatkeqësisë.
- Mott MacDonald. (2012a) Raporti përfundimtar për vlerësimin dhe studimin e menaxhimit gjithëpërfshirës të rrezikut nga përmytjet pas fatkeqësisë.
- Mott MacDonald. (2012b) Faza e dytë / Raporti për vlerësimin dhe studimin e menaxhimit gjithëpërfshirës të rrezikut nga përmytjet pas fatkeqësisë.
- PMBL. (2019). *Plani Përfundimtar i Menaxhimit të Basenit Lumor Drin-Bunë*. Tiranë (Shqipëri): Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- VPRRP. (2018). *Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmytjet për basenin lumor Drin-Bunë – Raporti Përfundimtar*. Darmstadt (Gjermani): INFRASTRUKTUR & UMWELT.
- QRM (Qendra Rajonale e Mjedisit Shqipëri). (2006). *Plani i Veprimit Vendor Mjedisor i Velipojës*, http://archive.rec.org/albania/Projects/LEAPs/PLVM_Velipojë.html
- QRM (Qendra Rajonale e Mjedisit Shqipëri). (2010). Vlerësimi i situatës aktuale të liqenit të Shkodrës Zona RAMSAR, Raporti i Vlerësimit të Liqenit të Shkodrës, qershor 2010
- QRM (Qendra Rajonale e Mjedisit Shqipëri). (2013). Raport i shpejtë i vlerësimit "Identifikimi i bashkive / komunave të cilat kanë nevojë për mbështetje për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet dhe rrezikun nga thatësitat në Shqipëri dhe Kosovë"
- KTK (Komunikimi i Tretë Kombëtar). (2016). *Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike*. Tiranë (Shqipëri): Ministria e Mjedisit.
- Atlasi Urban. (2012). Të dhënat Copernicus të Atlasit Urban të vitit 2012
- Schwarz, U. (2009) Vlerësim i shpejtë i hidrocentralit të propozuar në lumin e Drinit aftër Ashtës (në jug të Shkodrës)

12 Fjalorth¹⁸

Basen (lumor) - Sipërfaqja e tokës prej ku, lumenjtë apo edhe liqenet dhe të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një lumë, i cili derdhet në det, në një grykëderdhje të gjerë të vetme, në një deltë apo në një lumë tjetër. Përkufizimi i referohet nenit 4 (7) të ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Karakterizimi - Procesi i shprehjes së sjelljes së vëzhguar/parashikuar të një sistemi dhe të përbërësve të tij për përdorim optimal në vendimmarrje.

Pasoja - Një ndikim si dëmi/përmirësimi ekonomik, social apo mjedisor i cili mund të rezultojë nga një përmbytje. Mund të shprehen në mënyrë sasiore (p.sh. vlera monetare), sipas kategorive (p.sh. e lartë, e mesme, e ulët) apo në mënyrë përshkruese.

Potenciali i dëmit - Një përshkrim i vlerës së ndikimeve (dëmeve) sociale, ekonomike dhe ekologjike që do të shkaktoheshin në rast përmbytjesh.

Varësia - Shkalla në të cilën një variabël varet nga një variabël tjetër. Varësia ndikon në gjasat e tejkalimit të dy ose më shumë pragjeve njëkohësisht. Kur nuk dihet nëse ekziston varësi midis dy variablave apo parametrave, mund të sigurohen udhëzime mbi rëndësinë e çdo supozimi duke vlerësuar rastet plotësisht të varura dhe të pavarura (shih gjithashtu korrelacionin)

Shkarkimi (përrua, lum) - E matur me vëllim për njësi kohe.

Efikasiteti - Në gjuhën e përditshme, raporti i prodhimeve ndaj hyrjeve; në ekonomi, optimaliteti.

Menaxhimi i emergjencave - Tërësia e aktiviteteve të cilat mbulojnë planifikimin, kontrollin e emergjencave dhe vlerësimin pas përmbytjeve.

Skema e evakuimit - Plani për kombinimin e veprimeve të nevojshme për evakuim (paralajmërimi, komunikimi, transporti etj.).

Ekspozimi- Kuantifikimi i receptorëve që mund të preken nga një rrezik (përmbytje), për shembull, numri i njerëzve dhe demografia e tyre, numri dhe lloji i pronave etj.

Pritshmëria - Apo vlera e pritur - e një variable, i referohet vlerës mesatare që merr variabla. Për shembull, në një periudhë 100 vjeçare, një ngjarje e cila ndodh 1 herë në 100 vjet pritët të barazohet apo të ndodhë vetëm një herë.

¹⁸ Shih www.floodsite.net

Frekuenca e pritshme vjetore - Numri i pritshëm i dukurive në vit (periudha e përsëritjes së një ngjarjeje të caktuar).

Përmbytje - Një mbulim i përkohshëm me ujë i tokës e cila nuk mbulohet zakonisht nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrrenjtë malorë, shkarkimet e digave, rrjedhjet e shpejta të ujit dhe përmbytjet e detit në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimeve të ujit ndotës. Përkufizimi i referohet nenit 4 (39) të ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

Kontrolli i përmbytjeve (masa) - Një ndërhyrje strukturore për të kufizuar përmbytjet dhe kështu një shembull i një mase të menaxhimit të rrezikut.

Dëmtime nga përmbytjet - Dëmtime të receptorëve (ndërtesave, infrastrukturës, mallrave), prodhimit dhe pasurive të paprekshme (jetës, aseteve kulturore dhe ekologjike) të shkaktuara nga një përmbytje.

Sistemi i parashikimit të përmbytjeve - Një sistem i projektuar për të parashikuar nivelin e përmbytjeve para se ato të ndodhin.

Harta e rrezikut nga përmbytjet - Hartë me shtrirjen e parashikuar apo të dokumentuar të përmbytjes, me apo pa tregues të probabilitetit të përmbytjes.

Niveli i përmbytjes - Niveli i ujit gjatë një përmbytjeje.

Masat për menaxhimin e përmbytjes - Veprime të cilat ndërmerren për të ulur probabilitetin e përmbytjes apo pasojat e përmbytjes apo një kombinim i të dyjave.

Piku i përmbytjes - Niveli më i lartë i ujit i regjistruar në lum gjatë një përmbytjeje.

Fushë aluvionale - Pjesë e një fushe aluvionale e cila do të përmbytej në mënyrë natyrore në mungesë të ndërhyrjeve inxhinierike.

Parandalimi i përmbytjes - veprime për të parandaluar shfaqjen e një piku ekstrem të shkarkimit.

Mbrojtja nga përmbytjet (masa) - Për të mbrojtur një zonë të caktuar nga përmbytja (duke përdorur prita etj.).

Menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet - Analiza shoqërore të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse, vlerësime dhe zbutje të rrezikut nga përmbytjet.

Sistemi i paralajmërimit të përmbytjeve - Një sistem i krijuar për të lajmëruar publikun rreth përmbytjeve të afërta të mundshme. Zakonisht i lidhur me një sistem parashikimi përmbytjesh.

Qeverisje - Procesi i vendimmarrjes dhe i zbatimit

Rrezik - Një ngjarje fizike, fenomen apo aktivitet njerëzor me *potencialin* për të shkaktuar dëme. Një rrezik nuk shkakton domosdoshmërisht dëme.

Hartëzimi i rrezikut - Procesi i përcaktimit të shtrirjeve hapësinore të dukurive të rrezikshme.

Menaxhimi i integruar i riskut - Një qasje e menaxhimit të riskut që përfshin të gjitha burimet, rrugët dhe receptorët e riskut dhe konsideron kombinimin e zgjidhjeve strukturore dhe jostrukturore.

Ndërhyrje - Një aktivitet i planifikuar, i projektuar për të sjellë një përmirësim në një sistem ekzistues natyror ose të projektuar (duke përfshirë sistemet sociale, organizative/mbrojtëse).

Përmbytje - Përmbytja e tokës me ujë. (NB: Në disa gjuhë evropiane kjo mund t'i referohet përmbytjeve të qëllimshme, për të ulur pasojat e përmbytjeve në zonat përreth, për shembull. Këtu preferohet përkufizimi i përgjithshëm.)

Zvogëlimi - shih *Masat e menaxhimit të përmbytjeve*

Rruga - Rruga që ndjekin rreziqet për të prekur Receptorët. Në mënyrë që një Rrezik të ndodhë, duhet të ekzistojë një rrugë.

Përgatitja - Aftësia për të siguruar përgjigje efektive ndaj ndikimit të rreziqeve, duke përfshirë sigurimin e paralajmërimeve në kohë dhe efektive dhe evakuimin e përkohshëm të njerëzve dhe pronës nga vendet e kërcënuara.

Rezistenca - Aftësia e një sistemi/komuniteti/shoqërie/mbrojtjeje për të reaguar dhe për tu rikuperuar nga pasojat negative të rreziqeve të shkaktuara.

Rezistencë - Aftësia e një sistemi për të qëndruar i pandryshuar nga ngjarjet e jashtme.

Reagimi (në kontekst) - Reagimi i një mbrojtjeje ose sistemi ndaj ngarkimit mjedisor ose politikës së ndryshuar.

Risk - Risku është një funksion i probabilitetit, ekspozimit dhe cenueshmërisë. Shpesh, në praktikë, ekspozimi inkorporohet në vlerësimin e pasojave, si rrjedhojë, risku mund të konsiderohet se ka dy komponentë. Probabiliteti se një ngjarje do të ndodhë dhe ndikimi (apo *pasoja*) i lidhur me atë ngjarje.

Vlerësimi i riskut - Përfshin kuptimin, vlerësimin dhe interpretimin e perceptimeve të riskut dhe tolerancave të shoqërisë ndaj riskut për të njoftuar vendimet dhe veprimet në procesin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

Menaxhimi i rrezikut - Procesi i plotë i analizës së rrezikut, vlerësimit të rrezikut, vlerësimit të alternativave dhe zbatimit të masave të menaxhimit të rrezikut.

Masë për menaxhimin e përmbytjes - Një veprim i cili ndërmerret për të ulur probabilitetin e përmbytjes apo pasojat e përmbytjes apo një kombinim i të dyjave

Hartëzimi i riskut - Procesi i përcaktimit të shtrirjes hapësinore të riskut (duke kombinuar informacionin mbi probabilitetin dhe pasojat). Hartëzimi i riskut kërkon kombinimin e hartave të rrezikut dhe dobësive. Rezultatet e këtyre analizave zakonisht paraqiten në formën e hartave të cilat tregojnë magnitudën dhe natyrën e rrezikut.

Zvogëlimi i riskut - Zvogëlimi i mundësisë së dëmtimit, me anë të zvogëlimit të probabilitetit të një përmbytjeje që ndodh apo me anë të zvogëlimit të ekspozimit ose cenueshmërisë së receptorëve.

Planifikimi hapësinor - Politika publike dhe veprime të cilat synojnë të ndikojnë në shpërndarjen e aktiviteteve në hapësirë dhe lidhja ndërmjet tyre. Ai operon në nivel evropian, kombëtar dhe vendor dhe përfshin planifikimin e përdorimit të tokës dhe politikën rajonale.

Grupet e interesit - Palët/personat të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në një çështje.

Strategji (menaxhimi i rrezikut nga përmbytjet) - Një strategji është një kombinim i objektivave afatgjata, synimeve specifike, masave teknike, instrumenteve të politikës, dhe i proceseve të cilat janë vazhdimisht në përputhje me kontekstin shoqëror.

Zhvillim i qëndrueshëm - Është një zhvillim i cili përmbush nevojat aktuale pa komprometuar aftësinë e gjeneratave të ardhshme për të përmbushur nevojat e tyre.

Sistem - Një bashkim elementesh dhe ndërlidhjet ndërmjet tyre, që përbëjnë një tërësi dhe përgjithësisht karakterizohen nga sjellja e tij. Gjithashtu vlen për sistemet shoqërore dhe njerëzore.

Pasiguri - Një koncept i përgjithshëm i cili pasqyron mungesën tonë të sigurisë për dikë ose diçka, duke filluar nga një siguri e ulët deri në një mungesë të plotë të bindjes për një rezultat.

Cenueshmëria - Karakteristika e një sistemi i cili përshkruan potencialin e tij për tu dëmtuar. Kjo mund të konsiderohet si një kombinim i ndjeshmërisë dhe vlerës.

Shtojca A

Katalogu i llojeve të masave për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet referuar BE-së

Për Planifikimin e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet (MRP) në ZONËN E SHKODRËS (në përputhje me llojet e masave; dokumenti udhëzues i BE-së nr. 29-2013, në kuadër të direktivës së BE-së për përmbytjet 2007/60/KE)

Llojet e masave me “ngjyrë gri” nuk janë parashikuar për zbatim në Shtojcën B të masave të PMRP.

Nr. (Lloji)	Lloji i masave	Përshkrimi	Zbatuar nga (përgjithësisht)*	Sinergjitë direktiva kuadër e ujit / PMBL**	Masat strukturor e	Ndikimi i mundshëm ndërkufitar	Kontributi në objektivin e MRP
1. Aspekti: Parandalimi i rreziqeve							
1.1. Instrumentet administrative (për shmangien e rrezikut)							
1.1.1.	Hartëzimi i zonave të rrezikuara nga përmbytjet	<ul style="list-style-type: none"> Hartëzimi i zonave me rrezik përmbytjeje (të ulët, mesatar, përmbytje të shpeshta) Njoftim publik rreth hartave dhe informacion aktiv nga bashkia përkatëse 	Menaxhimi i Ujërave, Mbrojtja Civile, Planifikimi Hapësinor, Bashkitë	M1/M3	Jostrukturor	jo	0.1., 0.2., 1.2., 2.2.
1.1.2.	Kufizime për ndërtime në zonat me risk (në planifikimin hapësinor / planifikimin urban)	<ul style="list-style-type: none"> Publikimi i zonave të rrezikut / hartat e rrezikut për planifikuesit urban dhe lejet e banimit Rregullimi i zonave të mbrojtura për të parandaluar ndërtime në zonat e rrezikut (p.sh. zonat prioritare dhe zonat rezervë) 	Bashkitë, Planifikimi Hapësinor	M1/M3	Jostrukturor	jo	0.1., 0.2., 1.2., 1.3., 2.1., 2.2.
1.1.3.	Mbrojtja e fushave aluvionale dhe zonave ujëmbajtëse	<ul style="list-style-type: none"> Kufizime dhe rregullore për përdorimin e tokës në fusha aluvionale të cilat mund të shkaktojnë rreziqe të reja apo të cilat sjellin efekte negative në lidhje me përmbytjet dhe rrjedhjet Përcaktimi dhe publikimi i zonave ujëmbajtëse. Mbrojtje me anë të kufizimeve për ndërtim 	Bashkitë, NjQV; Agjencitë e Menaxhimit të Ujërave dhe Planifikimit Hapësinor	M1/M3	Jostrukturor	jo	1.1., 1.3., 1.5., 2.1., 2.3.
1.2. Përshtatja e përdorimit të tokës (për shmangien, zhdukjen apo zhvendosjen dhe reduktimin e rrezikut)							
1.2.1.	Përshtatja e përdorimit ekzistues të tokës në zonat e rrezikuara nga përmbytjet (duke përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë)	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësim sistematik i aseteve të rrezikuara Zhvillimi i përdorimit të përshtatur të tokës në zonat e rrezikuara Promovimi i alternativave për zhvillimin urban në zonat e mbrojtura nga përmbytjet Përshtatja e përdorimit të tokës dhe e objekteve të rrezikuara me anë të masave paraprake, punëve mbrojtëse, ndryshimeve në përdorimin e tokës apo ndryshime në mirëmbajtje / operim P.sh. shndërrimi afatmesëm i tokës bujqësore në kullota të gjelbërta të përhershme, ndryshimi i metodave të prodhimit (p.sh. mbrojtja e tokës) dhe i 	Bashkitë, Bujqësia, Agjencitë e Pyjeve; NjQV;	M1/M3	Jostrukturor	jo	1.3., 2.1.

		përdorimit të makinerive					
1.2.2.	Përshtatja e ndërtimeve dhe e infrastrukturës në zonat me risk (planifikimi dhe ndërtimi i përshtatur me përmytjet)	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e masave të ndërtimit dhe mbrojtjes së objekteve të përshtatura me përmytjet • Mbledhja e ujit në zonat urbane dhe rurale. • Ndërtimi i infrastrukturës së transportit të sigurt nga përmytjet (p.sh. ngritja, muret mbrojtëse, stabilimentet) • P.sh. dritare rezistente ndaj ujit dhe presionit në standardin e përmytjeve, fasada rezistente ndaj përmytjeve, përdorimi i dhomave të përshtatura me përmytjet në ambientet e banimit (duke shmangur dëme të cilat shkaktojnë përdorimin e dhomave të bodrumit), pjesë mbështetëse të ndërtesave 	Bashkitë, Ujësjellësi, Autoritetet e Infrastrukturës Rrugore	M1/M3	kryesisht strukturore	jo	1.3., 2.1.
Nr. (Iloji)	Lloji i masave	Përshkrimi	Zbatuar nga (përgjithësisht)*	Sinergjitë direktiva kuadër e ujit / PMBL**	Masat strukturore	Ndikimi i mundshëm ndërkufitar	Kontributi në objektivin e MRP
1.2.3.	Konsultimi me ekspertët e bujqësisë dhe pylltarisë për rritjen e ndërgjegjësimit	<ul style="list-style-type: none"> • P.sh. analiza e statusit, këshilla të synuara për bujqësinë dhe pylltarinë për menaxhim të qëndrueshëm, evente për informimin e publikut 	Bashkitë, NjQV, Autoriteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	M1/M3	jostrukturore	jo	1.5., 2.2.
1.3.	Parandalimi i rrezikut nga ndërtesat e përshtatura me përmytjet						
1.3.1.	Menaxhimi i përshtatur me përmytjet për substancat e rrezikshme për ujin	<ul style="list-style-type: none"> • P.sh. mbajtja dhe menaxhimi sipas udhëzimeve teknike përkatëse 	Autoriteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Bashkitë, NjQV	M1/M2/M3	strukturore ose jostrukturore	jo	1.4., 2.1., 2.4.
2.	Aspekti: Mbrojtja natyrore nga përmytjet						
2.1.	Menaxhimi natyror i përmytjeve, rregullimi i rrjedhës së ujit (në koordinim me menaxhimin e basenit ujore/ Direktiva Kuadër e Ujit)						

2.1.1.	Rivitalizimi i shtretërve të lumenjve dhe brigjeve të lumenjve / ish fushat aluvionale	<ul style="list-style-type: none"> • P.sh. Rrafshim brigjesh, strukturim i brigjeve te lumit, heqje konstruksionesh mbrojtëse • Instalimi i shtretërve të lumenjve të orientuar drejt natyrës • Zhvillimi i bimësisë tipike të zonës në ujë 	Bashkitë	M1/M2/M3	strukurore	e mundur (+/-)	1.3., 2.1.
2.1.2.	Ndryshimi i rrjedhave të lumenjve dhe kushteve të pjerrësisë	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i rrjedhave të lumenjve që korrespondojnë me qasjen morfologjike (p.sh. degëzim, gjarpërim) • Kërkesë e thjeshtë për një kanal fillestar me një bllokim fillestar, masa gërmimi të përshtatshme për ngritjen e pjesës së shtratit 	Menaxhimi i Ujërave, Autoriteti i Bujqësisë, Bashkitë	M1/M2/M3	strukurore	e mundur (+/-)	1.1., 1.3., 1.5., 2.1.
2.1.3.	Mbrojtja e zonave përgjatë brigjeve të lumenjve	<ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi dhe caktimi lokal i kufirit të bregut • Sigurimi i përdorimit të përshtatshëm të ujit ose një braktisje e tërë • Mbështetje për zhvillimin e trupave ujorë të orientuar drejt natyrës 	Menaxhimi i Ujërave, Bashkitë	M1/M2/M3	jostrukurore	jo	1.1., 1.3., 1.5., 2.1.
2.1.4.	Mbështetja e zhvillimit të fushave aluvionale natyrore	<ul style="list-style-type: none"> • Bujqësi dhe pylltari e përshtatshme për zonën përgjatë lumenjve • Përdorimi i gjerë i fushave aluvionale, duke i lënë ato për një vazhdimësi natyrore 	Bashkia, Bujqësia, Pylltaria	M1/M2/M3	jostrukurore	e mundur (+/-)	1.1., 1.3., 2.1.
2.1.5.	Mirëmbajtja e modifikuar e lumit	<ul style="list-style-type: none"> • Mirëmbajtje e përshtatshme e lumenjve duke iu referuar aspekteve mjedisore (p.sh. zgjedhja e pajisjeve, marrja në konsideratë e aspekteve hapësinore dhe kohore) 	Bashkia, Menaxhimi i Ujërave	M1/M2/M3	strukurore	jo	1.1., 1.3., 1.5., 2.1.
OM5 Kontribut në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	<ul style="list-style-type: none"> Numri i strukturave/ndërtesave të përmirësuara në kuadër të përshtatshmerisë ndaj ndryshimeve klimatike. Adoptimi i teknologjive të rinovueshme 	Drejtoritë kompetente të bashkive MTM	Në vijim	<p>Rritja e numrit të strukturave / ndërtesave të përmirësuara në kuadër të përshtatshmerisë ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Shtimi dhe përmirësimi i mjeteve dhe mënyrave të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.</p>	<p>✓ Plotësimi me rigozitet i kërkesave specifike</p> <p>✓ Rishikimi i planit sipas nevojës</p>
Asetet Materiale					
OM6 Kontribut në mbrojtjen e pronës dhe infrastrukturës OM7	<ul style="list-style-type: none"> Numri i aseteve (publike, private, infrastrukturore) të mbrojtura nga rreziku i përmbytjeve. Vlerësimi i sasisë dhe cilësisë së burimeve të përdorura për zbatimin e masave të planit. 	Strukturat përkatëse të qarkut/bashkive	Në vijim	<p>Rritja e numrit të aseteve të mbrojtura nga rreziku i përmbytjeve.</p> <p>Aplikimi i praktikave inxhinierike / ndërtimore që kërkojnë shfrytëzim minimal të murimeve.</p>	<p>✓ Modifikimi/rishikimi i planit, sipas nevojës</p>

Reduktim i konsumit të burimeve					
Trashëgimia Kulturore					
OM8 Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit historik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i Monumenteve të listuara në PMRRP dhe zonat me potencial arkeologjik që janë regjistruar ose janë objekt eksplorimi si rezultat i zbatimit të planit. ▪ Numri i monumenteve dhe zonave arkeologjike të dëmtuara për shkak të zbatimit të planit. ▪ Numri dhe statusi i mbrojtjes së strukturave të përfshira në listën e monumenteve të kulturës. ▪ Numri i ndërtesave të konservuara dhe të ripërdorura. ▪ Numri i strukturave të mbrojtura të dëmtuara për shkak të zbatimit të planit. 	Drejtoritë përkatëse në qark/bashki Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore	Në vijim	<ul style="list-style-type: none"> – Ruajtja dhe rritja e numrit të veçorive arkeologjike të regjistruara dhe të mbrojtura. – Mosdëmtimi i strukturave apo monumenteve dhe zonave rreth tyre për shkak të zbatimit të planit. – Rritja e numrit dhe ruajtja e statusit të mbrojtjes për monumentet e kulturës në zonë. 	✓ Çdo dëmtim i monumenteve të kulturës të regjistruara, apo i çdo elementi tjetër të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike, si dhe i zonës rreth tyre, do të konsiderohet si shkelje dhe do të aplikohen sanksionet sipas legjislacionit në fuqi.
Peizazhi					

<p>OM9</p> <p>Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të veçanta të peizazheve</p>	<p>▪ Cilësia e mjedisit urban dhe rural</p>	<p>Drejtoritë kompetente të bashkive</p>	<p>Në vijim</p>	<p>Rritja e cilësisë së mjedisit urban dhe rural.</p>	<p>✓ Detyrimi për zbatim të parashikimeve në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe planet e tjera zhvillimore për çdo bashki.</p>
--	---	--	-----------------	---	--

Kërkesat për monitorimin mjedisor, raportimin periodik në ministri gjatë zbatimit të Planit:

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedor gjatë zbatimit të Planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky program të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedor të Planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedor të këtij Plani.
- Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëherë ministria i kërkon autoriteteve miratuese e zbatuese të planit të merren masat e duhura për shmangien/minimizimin e ndikimeve negative, ose të vlerësohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore;
- Autoriteti përgjegjës, që zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e PMRRP, duhet të hartojë periodikisht 1 herë në vit, një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta depozitojë pranë Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin, jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.

Monitorimi i ndikimeve në mjedis për çdo masë të parashikuara në PMRRP do të bëhet sipas programit të monitorimit dhe mund të përfshijë informacione të shprehura në formë tabelore, sipas modelit në tabelën e mëposhtme.

Masa e zbatuar sipas PMRRP-së	Treguesit mjedisorë	Parashikim i ndikimeve kumulative (sipas rastit)	Ndikimi total i planit
Masa 001			
Masa 002			
Masa 003			
Masa...			

Shtojca E

**Rekomandime dhe Instruksione për
implementimin e Masave të Planit të
Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet,
referuar në:**

- **rekomandimet e Vlerësimit Strategjik
Mjedisor**
- **rekomandimet e Deklaratës mjedisore të
Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit**

Shtojca E

REKONANDIME&UDHEZIME

TE CILAT DUHET TE MBAHEN NE KONSIDERATE PER ZBATIMIN E SECILES MASE TE PMRP me qëllim për të rritur efektet pozitive dhe për të zbutur çdo efekt negativ mjedisor.

(referuar rekomandimeve të Vlerësimit Strategjik Mjedisor)

Detajimi i tyre si dhe përcaktimi i masave më specifike dhe më të drejtpërdrejta do të bëhet gjatë hartimit të VNMS-ve përkatëse lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP (kur VNMS-ja është e nevojshme)

I. TË PËRGJITHSHME

1. Për masat më teknike dhe konstruktive, që shpesh kanë një efekt të qartë për reduktimin e rrezikut, të cilat krijojnë efekte negative për florën, faunën, biodiversitetin, token, trashëgiminë kulturore, peisazhin si dhe disa efekte të tjera të vogla, kërkohet një analizë dhe vlerësim mjedisor i mëtejshëm gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit si pjesë e procedurave të miratimit (VNMS-të përkatëse). Ky proces vlerësimi do të ndihmojë në identifikimin e mënyrave për të shmangur, reduktuar ose zbutur ose kompensuar çdo efekt negativ të identifikuar.
2. Meqë burimet financiare për mbrojtjen e integruar civile, siç kërkohet nga ligji përkatës, janë të kufizuara në të dy nivelet e qeverisjes, madje edhe më të pakta në nivel vendor të bëhet: (1) një analizë e plotë e veprimeve të elasticitetit të zbatuara gjatë ofrimit të shërbimeve vendore dhe do të gjurmoheshin shpenzimet përkatëse, me shumë mundësi shpenzimet e elasticitetit do të ishin më të larta se sa janë konceptuar aktualisht; (2) planifikimi ndërsektorial për qëndrueshmërinë lokale me qëllim që bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet sektorëve çojë në disa veprime të thjeshta që garantojnë qëndrueshmëri dhe efikasitet financiar brenda buxheteve aktuale.
3. Infrastruktura e re që parashikohet të instalohet duhet të marrë parasysh regjimet e ndryshuara klimatike të parashikuara. Masat e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të projektohen/detajohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh ndikimet afatgjata të ndryshimeve klimatike.
4. Këshillohet që alokimi i fondeve të reja dhe financimi për menaxhimin e rrezikut të ruajë një nivel prioritizimi lidhur me financimin për menaxhimin e rrezikut në zonat me rrezik të lartë. Kjo duhet të pasqyrohet në planifikimet përkatëse buxhetore në të gjitha nivelet.

5. Rinatyalizimi i lumenjve dhe rrjedhave ujore për t'i rikthyer në gjendjen e tyre natyrore, aty ku ndërhyrjet aktuale në lumenj dhe zona bregore janë të vjetra, të panevojshme ose që sjellin shkatërrim të mëtejshëm. Parashikimi i një mekanizmi për marrjen/blerjen e zonave bregore për të mundësuar zona natyrore të përmbytjeve dhe për të ndryshuar politikën lidhur me mbrojtjen e zonave bregore, duke bërë kështu të mundur që lumenjtë të transportojnë sedimentet në mënyrë natyrore.
6. Inkurajimi i zbatimit të PMRRP për të arritur qasje me karbon të ulët ose zero. Kjo do të shërbente për të zyrtarizuar dhe për t'i dhënë efekt njërit prej parimeve që përdoret në proceset zhvillimore në ditët e sotme, aspirimit për të qenë neutral ndaj karbonit.

II. REKOMANDIME ME FOCUS “POPULLSIA DHE SHENDETI PUBLIK”

1. Gjatë projektimit për zbatim të masave të propozuara, rekomandohet të merren parasysh të dhënat lokale për popullsinë dhe indekset e privimit. Kjo do të ndihmojë në harmonizimin e prioriteteve për zonat në rrezik më të lartë nga përmbytjet dhe komunitetet e grupet sociale më të cenueshme.
2. Në zhvillimin e studimeve për përmbytjet dhe projektimin e masave dhe punimeve përkatëse, duhet të merren parasysh mundësitë për përfitime rekreative dhe përmirësimin e aksesit në mjedisin natyror dhe hapësirën e gjelbër, kjo për të përmirësuar cilësinë e jetës. Masat duhet të synojnë të mbështesin propozimet lokale të rigjenerimit dhe të synojnë ofrimin e mundësive drejt komuniteteve më të pafavorizuara.
3. Rekomandohet që t'i kushtohet më shumë rëndësi rolit përfitues nga mjedisi natyror në zonat urbane. Kjo mund të përfshijë, për shembull, zgjerimin dhe përmirësimin e rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër dhe aplikimin e sistemeve të qëndrueshme të kullimit që përdorin hapësirën e gjelbër.
4. Për të siguruar që të gjithë grupet e komunitetit të angazhohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse, mund të nevojiten mbështetje dhe veprime shtesë në nivel lokal për ta lehtësuar këtë, ndërkohë që kjo mbështetje e këto veprime duhet të përshtaten sipas kontekstit specifik.
5. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus popullsinë dhe shëndetin publik:
 - a) Për aksesin në zonën e punimeve, duhet rënë dakort (kur është e nevojshme) me aktorët e interesit (pronarët, qiramarrësit, përdoruesit/pronarët e objekteve të biznesit/shtëpiake).
 - b) Aty ku aksesit ekzistues nuk mund të përdoret, kjo duhet marrë në konsideratë përpara fillimit të punimeve dhe duhen ngritur strukturat e nevojshme përpara se të ndërmerret ndonjë veprim që mund të shkaktojë ndërprerje të punës.
 - c) Të gjitha punimet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes do të kryhen në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare lidhur me kontrollin e zhurmës dhe dridhjeve në punimet e ndërtimit, dhe kontraktori duhet të marrë masat zbutëse përkatëse në këtë drejtim.

- d) Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmbajtjet me qëllim mbrojtjen e mjedisit natyror dhe përdorimin efikas të burimeve ekonomike.
- e) Përpara nisjes së punimeve duhet marrë në konsideratë aksesin e banorëve, psh. në tokat bujqësore apo në shërbime të tjera. Aty ku aksesin mund të ndërpritet përkohësisht, do të sigurohen pika aksesin të përkohshme, por të sigurta.
- f) Grumbullimi, depozitimi, trajtimi, transportimi i mbetjeve ndërtimore sipas dispozitave në fuqi dhe në bashkëpunim me autoritetet përkatëse.
- g) Duhet ngritur infrastruktura përkatëse në mënyrë që popullsia dhe bizneset të dinë se si dhe ku do të evakohen, si të sigurojnë objektet e tyre, dhe kur mund të rikthehen në to.
- h) Ruajtja e aksesit ekzistues në zonat bujqësore, pronat private si dhe lëvizja përgjatë akseve rrugore publike. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të sigurohen mënyra alternative aksesimi gjatë periudhës së ndërtimit.
- i) Minimizimi i marrjes së tokës (të përhershme dhe të përkohshme) aty ku është e mundur, veçanërisht brenda kufijve të pronave private rezidenciale dhe komerciale, si dhe brenda zonave rekreative publike.
- j) Aksesin dhe koha për mirëmbajtje duhet të minimizohen sa më shumë që të jetë e mundur.
- k) Duhet hartuar dhe shpërndarë udhëzime për të ndihmuar që bizneset e turizmit, banorët dhe ambientet tregtare të përgatiten për ngjarjet e përmbajtjeve.
- l) Do të shpërndahet informacion se si fermerët duhet të reagojnë në rast përmbajtjeje, duke përfshirë zonat e sigurta për të lëvizur bagëtinë dhe tokat që duhen lënë djerrë për shkak të përmbajtjeve.
- m) Restaurimi i të gjitha zonave të prekura, përfshirë edhe ato private, dhe krijimi i peizazhit, aty ku është e përshtatshme
- n) Toka e marrë përkohësisht gjatë periudhës së ndërtimit do të kthehet në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të punimeve.
- o) Grafiku i punimeve duhet t'i komunikohet pronarëve/përdoruesve të tokës, me qëllim minimizimin e efekteve tek punët në bujqësi.

III. REKOMANDIME ME FOCUS “BIODIVERSITETIN”

1. Efektet e mundshme negative mund të zbuten përmes identifikimit të ndikimit, projektimit të përshtatshëm grafikut të zbatimit të masave kundër përmbajtjeve, me qëllim për të shmangur ose minimizuar efektet në habitatet dhe kafshët e egra; shoqëruar këto edhe me konsultimin me organizatat përkatëse.
2. Detajimi dhe hartimi i projekteve të zbatimit për masat e propozuara duhet të përfshijë mjete që kanë potencialin për të sjellë përfitime për biodiversitetin. Kjo përfshin elementë të adoptimit/elasticitetit që lidhen me proceset natyrore, përdorin përafrimit e menaxhimit të përmbajtjeve natyrore dhe adoptojnë menaxhimin e qëndrueshëm të tokës. Në nivel rajonal/lokal zhvillimi i tyre i mëtejshëm duhet të përfshijë edhe autoritetet mjedisore rajonale/lokale.

3. Këshillat dhe mbështetja praktike për një përafrim adoptues në plan duhet të promovojnë mjetet që kanë potencialin për të sjellë përfitime për biodiversitetin. Gjithashtu, duhet që këshilla të ngjashme të përfshihen edhe në planet e sektorëve të tjerë (bujqësi, pylltari, etj.) që lidhen me menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, në mënyrë sigurohet vlerësimi i financimit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi.
4. Në trajtimin e mënyrave të reja të financimit të aktiviteteve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, rekomandohet që kërkesa për të demonstruar një fitim neto për biodiversitetin të përfshihet si pjesë e procedurave të aplikimit për fonde, dhe të sigurohet.
5. Për të ndihmuar në arritjen e një përfitimi neto në biodiversitet, rekomandohet që elementët e biodiversitetit të përfshihen në trajnime në të ardhmen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe në bashkëveprimin me komunitetet. Gjithashtu duhet të merren parasysh në zhvillimin e aftësive praktike dhe burimeve në të gjithë sektorin. Kjo përfshin edhe këshillimin me ekspertë të fushës, si biologë të specializuar në ekologjinë e ujërave të ëmbla dhe detare dhe ekspertë të peshkimit.
6. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus biodiversitetin:
 - a) Respektimi i udhëzimeve për parandalimin e ndotjes dhe praktikave më të mira lidhur me materialet e ndërtimit dhe praktikave të punës pranë rrjedhave ujore.
 - b) AKM/ARM dhe bashkitë përkatëse duhet të ndihmohen në detajimin e masave të propozuara në PMRRP për të adresuar se si do të përmbushen objektivat e zonës së mbrojtur pas ngjarjes së përmbytjes.
 - c) Heqja e bimësisë/pemëve do të ndërmerret jashtë sezonit të shumimit të shpendëve, aty ku është e mundur, për të siguruar që foletë e shpendëve me të vegjël ose vezë të mos shkatërrohen. Në çdo rast, nëse kërkohet heqja e bimësisë, pemët dhe shkurret duhet të kontrollohen nga një biolog i kualifikuar, për praninë e zogjve riprodhues/fole aktive.
 - d) Heqja e bimësisë/pemëve duhet të shmanget sa me shumë që të jetë e mundur.
 - e) Para fillimit të punimeve duhet të kryhet një vlerësim i habitateve në zone, nga një ekspert i kualifikuar dhe me përvojë.
 - f) Duhet të merren parasysh masat për përmirësimin e habitatit, që në fazën e projektimit për zbatim të masave të propozuara.
 - g) Ndërtimi duhet të ndjekë të gjitha udhëzimet për parandalimin e ndotjes dhe deklaratat e metodës së punimeve duhet të dakortësohen me AdZM në zonat ku mund të hasen lloje të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
 - h) Duhet të kryhet kontrolli i rrjedhjeve nga zonat e punimeve.
 - i) Parashikimi i masave për kontrollin e sedimenteve gjatë punimeve, në mënyrë që të mos dalin sedimente, të cilat mund të ndikojnë në habitatet dhe llojet përgjatë rrjedhave ujore.
 - j) Çdo ndërhyrje duhet kryer në konsultim dhe me angazhimin e AKM/ARM/Bashki (drejtoria e mjedisit) dhe AdZM, si dhe aktorët e tjerë të interesit.
 - k) Zhvilluesi duhet të sigurojë:
 - Mbrojtjen e duhur për habitatet ekzistuese ujore nga ngjarjet e përmbytjeve.
 - Parashikimin në projekt të kalimeve të nevojshme për llojet e faunës, duke përdorur praktikave më të mira të projektimit dhe metodave të ndërtimit.
 - Ruajtjen e regjimeve natyrore të rrjedhës ujore dhe transportit të sedimentit,

duke e përfshirë këtë në parametrat e projektimit dhe minimizuar rreziqet që në këtë fazë.

- l) Identifikimi, zbatimi dhe menaxhimi i punimeve për përmirësimin e habitatit aty ku është e mundur.
- m) Punimet që do të kryhen në rrjedhën ujore duhet të planifikohen për të minimizuar ndikimet tek të gjitha llojet ujore.
- n) Monitorimi për të garantuar se të gjitha masat zbutëse po funksionojnë ashtu siç duhet.
- o) Monitorimi për të garantuar se punimet nuk shkaktojnë efekte të dëmshme mbi habitatet dhe llojet e florës dhe faunës.
- p) Mbjelljet e pemëve ndihmojnë, aq sa është e mundur, në rivendosjen e mbulesës bimore të tokës dhe shtimin e zonave pyjore.
- q) Programimi i punimeve në mënyrë që të mos përkojë me kohën e rrjedhës së lartë ose të ulët, apo në periudhat kur zona përdoret nga llojet e mbrojtura.
- r) Projekti i zbatimit hartohet në mënyrë të tillë që të sigurojë përmirësim të regjimit të rrjedhës ujore, të mos ndryshojë regjimin ekzistues normal.
- s) Aktivitetet e mirëmbajtjes duhen planifikuar të realizohen në periudhën kur ndikimet në bimësi janë minimale.
- t) Programimi i punimeve në mënyrë të tillë që të shmangen/minimizohen konfliktet me llojet e mbrojtura dhe/ose ato ujore që mund të gjenden në zonën e punimeve.

IV. REKOMANDIME ME FOCUS – TOKËN

1. Gjatë studimeve të përmbytjeve dhe në projektimin e zbatimit e masave të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet të merret parasysh modelimi i proceseve natyrore i cili mund të ndihmojë në parashikimin dhe zbutjen më të mirë të efekteve të mundshme negative në tokë.
2. Projektimi dhe detajimi i mëtejshëm i masave të propozuara duhet të përfshijë marrjen në konsideratë të ndërveprimeve të mundshme që lidhen me mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës. Rekomandohet gjithashtu përfshirja e organizatave kombëtare dhe rajonale/lokale të fermerëve.
3. Këshillat dhe mbështetja praktike për një përafrim adoptues në Plan duhet të promovojnë mjetet që kanë potencialin për të sjellë përfitime për tokën. Gjithashtu, duhet që këshilla të ngjashme të përfshihen edhe në planet e sektorëve të tjerë (bujqësi, pylltari, etj.) që lidhen me menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, në mënyrë sigurohet vlerësimi i financimit, zhvillimi i qëndrueshëm dhe planifikimi
4. Rekomandohet gjithashtu angazhimi i hershëm me komunitetin bujqësor. Kjo do të ndihmojë për të përshtatur mbështetjen dhe për të maksimizuar mundësitë e ofruara duke forcuar lidhjen midis praktikave të menaxhimit të tokës dhe atyre të menaxhimit të rrezikut.
5. Në nivel lokal, forcimi bashkëpunimit brenda një pellgu ujëmbledhës do të lehtësojë identifikimin e prioritetëve për ruajtjen e tokës dhe mënyrën se si mjetet e ndryshme

të menaxhimit të rrezikut mund t'i mbështesin më së miri këto prioritete. Gjithashtu rekomandohet angazhimi që në fazat e para i aktorëve kryesorë të interesit, me qëllim informimin dhe ndihmën në procesin e vendimmarrjes.

6. Investimi në aftësimin, trajnimet dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional duhet të përfshijë njohuri se si mjetet e ndryshme të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet mund të sjellin përfitime për një menaxhim të qëndrueshëm të tokës. Autoritetet mjedisore në të gjitha nivelet, përmes rolit të tyre të strategjik duhet të demonstrojnë gjithashtu se si mund të projektohet dhe zbatohet infrastruktura për të reduktuar mbetjet dhe për të maksimizuar efikasitetin e burimeve.
7. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus tokën:
 - a) Aplikimi i procedurave të praktikave të mira në lidhje me gërmimin, trajtimin dhe depozitim të kujdesshëm të dheut gjatë proceseve të skarifikimit, ndërtimit dhe restaurimit.
 - b) Hartimi dhe zbatimi i deklaratës së metodave të punës duke përfshirë masat e kontrollit të sedimentit.
 - c) Sigurimi që asnjë lloj invaziv të mos hyjë ose dalë jashtë zonës gjatë lëvizjeve të dheut.
 - d) Zbatimi i masave të kontrollit të erozionit dhe sedimentit.
 - e) Kufizoni i periudhës së punimeve gjatë kohës kur moti është i përshtatshëm.
 - f) Kufizimi, sa të jetë e mundur, i shtrirjes dhe vendndodhjes së kantievere të punës dhe hapësirave të magazinimit.
 - g) Rekuperimi i zonave të prekura/dëmtuara.
 - h) Ruajtja e vegjetacionit në kanale për të maksimizuar mbrojtjen nga erozioni
 - i) Ripërdorimi i materialeve të gërmuara, aty ku është e mundur, në argjinatura dhe peizazh.
 - j) Përdorimi i udhëzimeve dhe praktikave më të mira për të minimizuar rrjedhjen e sedimenteve gjatë punimeve.

V. REKOMANDIME ME FOCUS - UJIN

1. Efektet e mundshme negative në mjedisin ujor mund të zbuten duke kuptuar efektet në proceset fizike, duke përfshirë rrjedhat ujore dhe erozionin në zonat bregore lumore dhe bregdetare; minimizuar humbjen e habitatit; dhe krijuar habitate përmes zbatimit të masave të propozuara. Efektet negative duhet të adresohen gjatë studimeve të përmbytjeve dhe projektimit të masave përkatëse.
2. Dispozitat rregullatore ekzistuese kërkojnë kryerjen e vlerësimit të burimeve ujore për të siguruar përputhshmërinë me objektivat përkatës kur kjo është e mundur. Rekomandohet që shembujt e praktikave të mira në vlerësimet e DKU-së të shpërndahen gjerësisht tek të gjithë aktorët e përfshirë në aktivitetet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

3. Rekomandohet që t'i kushtohet më shumë rëndësi rolit përfitues nga mjedisi natyror në zonat urbane. Kjo mund të përfshijë, për shembull, zgjerimin dhe përmirësimin e rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër dhe aplikimin e sistemeve të qëndrueshme të kullimit që përdorin hapësirën e gjelbër.
4. Investimi në aftësimin, trajnimet dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional duhet të përfshijë njohuri se si mjetet e ndryshme të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet mund të sjellin përfitime për cilësinë e ujit dhe burimet ujore. Gjithashtu, këshillohet që aktivitetet e angazhimit në nivel lokal të marrin në konsideratë edhe menaxhimin e burimeve ujore.
5. Masat që mund të ndikojnë në mjedisin e ujërave të ëmbla (siç janë masat për mbledhjen e ujërave të përmbytjeve), të cilat synojnë mbrojtjen e mjedisit ujor, rregullohen sipas kuadrit ligjor përkatës dhe zbutja konsiderohet si pjesë e procesit të vlerësimit. Disa masa, veçanërisht ato që konsiderohen si zhvillim, rregullohen sipas sistemit të planifikimit të përdorimit të tokës; dhe efektet mjedisore do të adresohen përmes VNMS-ve në nivel projekti specifik.
6. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus Ujin:
 - a) Respektimi i udhëzimeve që lidhen me zbutjen e efekteve gjatë ndërtimit, për shembull garantimi që papërshkueshmëria e zonës të mos rritet përkohësisht gjatë ndërtimit.
 - b) Duhet të kryhet një studim mbi kompanitë e shërbimeve publike për të përcaktuar vendndodhjen e shërbimeve ekzistuese në të gjithë zonën e zhvillimit. Respektimi i mëposhëm i praktikave më të mira të ndërtimit duhet të sigurojë që proceset ndërtimore të marrin parasysh vendndodhjen e shërbimeve, në mënyrë që këto të mos dëmtohen si pasojë e mosnjohjes së vendndodhjes dhe të mos shkaktohen përmbytje të lokalizuara.
 - c) Duhet të studiohen dhe përdoren sisteme të përkohshme të kullimit duke aplikuar praktika ndërtimore, aty ku është e mundur, ose metoda të tjera për të kontrolluar dhe trajtuar rrjedhjet e ngarkuara me llum.
 - d) Ndërtimi duhet të kryhet në përputhje me praktikën më të mira. Kjo do të përfshijë zonat e magazinimit të karburantit dhe zonat e përcaktuara për furnizim me karburant.
 - e) Muret mbrojtës dhe argjinaturat e reja duhet të orientohen në drejtimin e rrjedhës për t'u mbrojtur nga gërryerja.
 - f) Hartimi dhe zbatimi i deklaratës së metodave të punës duke përfshirë masat e kontrollit të sedimenteve dhe të ndotjes.
 - g) Përpara pozicionimit të mureve mbrojtës, argjinaturave dhe kanaleve, duhet realizuar një studim për të minimizuar rrezikun e ndotësve dhe sedimenteve të tjera që ndikojnë në rrjedhën e ujit pranë këtyre strukturave.
 - h) Aktivitetet e ndërtimit duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që sipërfaqja dhe kohëzgjatja e ekspozimit të tokës të minimizohen aty ku është e mundur, duke e ndarë në faza kohën e ndërtimit, në mënyrë që seksionet të restaurohen përpara se të kalohet në seksionin/fazën tjetër;
 - i) Lëvizja në kantier e makinerive, impianteve dhe pajisjeve të tjera të ndërtimit duhet të reduktohet sa më shumë që të jetë e mundur.
 - j) Materialet e ndryshme të grumbulluara duhet të depozitohen larg rrjedhave ujore ekzistuese.

- k) Proceset ndërtimore (psh. depozitimi i materialeve) do të marrin në konsideratë ndikimin tek ujërat nëntokësore.
- l) Rrjedhjet duhet të bllokohen përpara trajtimit dhe shkarkimit/depozitimit të tyre.
- m) Përdorimi i udhëzimeve dhe praktikave më të mira për të minimizuar rrjedhjen e sedimenteve gjatë punimeve.
- n) Adoptimi i procedurave të duhura për kontrollin e ndotjes, në përputhje me udhëzimet përkatëse, për të reduktuar rrezikun e rrjedhjeve të ujërave sipërfaqësore të ngarkuara me sedimente që hyjnë në rrjedhat ujore dhe në ujërat nëntokësore.
- o) Zbatimi i udhëzimeve teknike për ruajtjen dhe restaurimin e fushave lymore dhe rrjedhave ujore natyrore si një formë e zbutjes nga përmbytjet dhe një burim i rëndësishëm mjedisor dhe social. Garantimi që kjo aplikohet edhe në procesin e vendimmarrjes.

VI. REKOMANDIME ME FOCUS - FAKTORET KLIMATIK

1. Këshillohet që burimet e reja të financimit për menaxhimin e rrezikut të jenë plotësisht të informuara dhe të bazuara në standarde të qëndrueshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
2. Gjatë projektimit/detajimit të masave të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duhet të shmangen ato zgjidhje inxhinierike të cilat mund të ndikojnë negativisht në emetimet e gazeve serrë dhe të minimizohet përdorimi i burimeve të energjisë jo të rinovueshme në proceset e ndërtimit dhe mirëmbajtjes.
3. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus Faktorët Klimatik:
 - a) Qasjet e mëposhtme mund të përdoren për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë edhe kombinimin e tyre, kur është e nevojshme dhe/ose e mundshme:
 - koncepte të infrastrukturës “*gr*”, d.m.th. ndërhyrje fizike ose masa ndërtimore kundrejt ngjarjeve të jashtëzakonshme, përmes përdorimit të shërbimeve inxhinierike, për të rritur fleksibilitetin e ndërtesave dhe të infrastrukturës,
 - qasjet strukturore “*të gjelbra*” dhe “*blu*”, që kontribuojnë në fleksibilitet më të madh të ekosistemeve, në mënyrë që të parandalohet humbja e biodiversitetit dhe degradimi i ekosistemit dhe që të rikthehen ciklet e ujit, ndërkohë që shfrytëzohen funksionet dhe shërbimet e ofruara nga ekosistemet;
 - konceptet jostrukturore “*të moderuara*”, sipas të cilave, strategjitë për përdorimin e tokës, shpërndarjen e informacionit dhe incentivat ekonomike për reduktimin ose parandalimin e riskut të fatkeqësive janë projektuar dhe zbatuar.
 - b) Preferohen qasjet e “*gjelbra*” dhe “*të moderuara*”, dhe është i volitshëm një kombinim i tyre në cilësinë e masave zbutëse.
 - Aktualisht, një sërë propozimesh për masat e përshtatjes disponohen në disa dokumente, por duke marrë parasysh dyshimet e shumta lidhur me parashikimet e zhvillimit të ndryshimeve klimatike dhe informacionet e

kufizuara aktuale për këtë dukuri, monitorimi i zhvillimeve dhe reagimi në mënyrë fleksibël ndaj informacioneve të reja do të jetë i nevojshëm. Në bazë të informacioneve dhe njohurive të reja, informacionet aktuale duhet të korrigojen/përditësohen, ose duhet të merren masa të reja për përshtatjen.

- c) Kontraktori duhet të garantojë përdorim dhe mirëmbajtje të rregullt të makinerive dhe pajisjeve, me qëllim minimizimin e emetimeve të gazrave në ajër.

VII. REKOMANDIME ME FOCUS - ASETET MATERIALE

1. Gjatë zhvillimit/detajimit të masave të propozuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet duhet të shqyrtohen mundësitë për të minimizuar gjenerimin e mbetjeve dhe përdorimin e burimeve.
2. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus Faktorët Asetet materiale:
 - a) Përpara nisjes së punimeve do të kryhen konsultime dhe studime mbi shtrirjen e rrjetit të kablove elektrikë dhe shërbimeve publike (furnizim me ujë, kanalizime, etj.).
 - b) Hartimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut.
 - c) Komunikimi/konsultimi me kompanitë e shërbimeve publike lidhur me gërmimet dhe punime të tjera.
 - d) Projekti i zbatimit do të synojë të minimizojë mbetjet dhe të maksimizojë ripërdorimin e materialeve të përshtatshme në vend.
 - e) Do të hartohet dhe zbatohet Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, aty ku kërkohet.
 - f) Për të minimizuar mbetjet, aty ku kërkohet për rrugët e aksesit dhe zonat e punimeve, dherat e sipërme do të skarifikohen përpara punimeve dhe do të grumbullohen në vend. Pas përfundimit të ndërtimit, ato do të rikthehen në vendin e mëparshëm dhe për këtë arsye asnjë shtresë e sipërme e dheut nuk do të hiqet nga zona e punimeve.
 - g) Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i mbetjeve do të bëhet në zonat e caktuara dhe të licencuara nga autoritetet vendore
 - h) Marrja e tokës (e përhershme apo e përkohshme) do të minimizohet sa më shumë që të jetë e mundur.
 - i) Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, e cila (qasja) kontribuon në përdorimin efikas të burimeve ekonomike dhe synon të mbrojë investimin brenda zonave të rrezikuara nga përmbytjet, duke garantuar që janë aplikuar masat e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të zbutur dhe menaxhuar rreziqet e përmbytjeve.
 - j) Autoritetet lokale si dhe kompanitë e shërbimeve publike do të konsultohen dhe informojnë mbi devijimin e transportit në zona të paprekura dhe menaxhimin e shërbimeve publike përgjatë periudhës së ndërtimit, me qëllim minimizimin e ndërprerjes së shërbimeve.

VIII. REKOMANDIME ME FOKUS TRASHËGIMINË KULTURORE

1. Efektet e mundshme negative në trashëgiminë kulturore mund të zbuten përmes identifikimit të çdo elementi të trashëgimisë (përfshirë arkeologjinë) dhe vlerësimit të tyre që në fazat e para të detajimit dhe zbatimit të masave të propozuara për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.
2. Shkalla e ofrimit të përfitimit neto mjedisor duhet të përfshijë edhe aspektin historik/kulturor. Gjithashtu, kjo do të ndihmonte që zbatimi i masave dhe arritja e objektivave të planit të reflektojnë të gjitha aspektet përkatëse mjedisore dhe të qëndrueshmërisë.
3. Përfshirja e kërkesave për masat e mbrojtjes nga përmbytjet në standardet e ndërtesave dhe materialeve ndërtimore, duhet të marrë parasysh edhe ndjeshmërinë e ndërtesave historike.
4. Angazhimi në nivel lokal duhet të përfshijë aktorët kryesorë të interesit, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal/lokal. Kjo do të ofronte mundësinë për të përdorur një sërë të dhënash të disponueshme për mjedisin historic, gjë që informon dhe ndihmon në vendimmarrje. Kjo përfshin të dhëna edhe për karakterin e peizazhit historik dhe atij urban.
5. Masat mund të përmirësohen duke përfshirë njohjen e qartë të rolit të aktorëve të interesit, lidhur me në mbështetjen dhe kontributin për reagimin dhe rikuperimin e çdo incidenti.
6. Rekomandohet që elementët e trashëgimisë kulturore të përfshihen në trajnime në të ardhmen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe në bashkëveprimin me komunitetet. Gjithashtu duhet të merren parasysh në zhvillimin e aftësive praktike dhe burimeve në të gjithë sektorin. Kjo përfshin edhe këshillimin me ekspertë të fushës si arkeologë dhe specialistë të trashëgimisë kulturore.
7. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus Faktorët Trashëgiminë kulturore:
 - a) Kontrata e ndërtimit duhet të përfshijë masat e përgjithshme që do të zbatohen nga Kontraktori për të mbrojtur karakteristikat dhe zonat e interesit të njohura dhe të panjohura.
 - b) Në rast se nevojitet, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, do të kërkohen shërbimet e një arkeologu apo eksperti të trashëgimisë kulturore.
 - c) Do të mbahen konsultime të rregullta, që në fazat e hershme të studimit dhe projektimit të masave të propozuara, me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si organ statutor në këtë fushë.
 - d) Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, e cila (qasja) kontribuon në ruajtjen e arkeologjisë dhe trashëgimisë ndërtimore.
 - e) Roli i autoritetit përgjegjës për situatën e përmbytjeve do të promovohet vashdimisht, përfshirë edhe shpërndarjen e informacionit tek komunitetet e rrezikuara, lidhur me vetë-veprimin e tyre dhe adoptimin e pronave/ndërtesave për t'u mbrojtur nga

- përmblytjet.
- f) Do të hartohet një plan veprimi në rast përmblytjesh për ndërtesat historike dhe monumentet e kulturës. Gjithashtu, duhet të sigurohen edhe mjetet dhe burimet e nevojshme (njerëzore, ligjore/institucionale, financiare) për ta zbatuar këtë plan.
 - g) Nëse artefaktet/reliket do të ruhen/depozitohen, duhet të identifikohet fuqi punëtore dhe një vend i sigurt për t'i paketuar dhe zhvendosur ato, përpara njoftimit për evakuim.

IX. REKOMANDIME ME FOCUS - PEIZAZHIN

1. Efektet e mundshme negative në peizazh duhet të adresohen gjatë detajimit/projektit të zbatimit të masave të propozuara për menaxhimin e rrezikut nga përmblytjet.
2. Rekomandohet konsultimi me autoritetet mjedisore dhe komunitetet e prekura.
3. Mundësitë për përmirësimin e peizazhit lokal dhe hapësirave publike duhet të merren parasysh duke përfshirë zgjerimin e infrastrukturës së rrjetit të gjelbër, aty ku është e përshtatshme. Masat që lidhen me fushat lymore/ujëmbledhëse duhet të identifikojnë edhe mundësitë e përmirësimit të peizazhit.
4. Do të ishte e dobishme të qartësohej shkalla e ofrimit të përfitimit neto mjedisor, që mund të përfshijë përfitime edhe për peizazhet urbane dhe rurale. Kjo do të ndihmonte që zbatimi i masave dhe arritja e objektivave të planit të reflektojnë të gjitha aspektet përkatëse mjedisore dhe të qëndrueshmërisë.
5. Rekomandohet që t'i kushtohet më shumë rëndësi kontekstit urbane dhe mënyrës sesi karakteri i peizazhit mund të përmirësohet nëpërmjet mënyrave që, gjithashtu ndihmojnë në uljen e rrezikut nga përmblytjet. Kjo mund të përfshijë, për shembull, përmirësimin e rrjeteve të infrastrukturës së gjelbër dhe futjen e sistemeve të qëndrueshme të kullimit që përdorin hapësirën e gjelbër.
6. Rekomandohet që elementët e peizazhit të përfshihen në trajnime në të ardhmen dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si dhe në bashkëveprimin me komunitetet. Gjithashtu duhet të merren parasysh në zhvillimin e aftësive praktike dhe burimeve në të gjithë sektorin. Kjo përfshin edhe këshillimin me ekspertë të fushës si arkitektë dhe projektues të peizazhit.
7. Masa zbutëse të detajuara lidhur me zbatimin e secilës prej masave të propozuara në PMRRP me focus Faktorët Peizazhin:
 - a) Në dokumentat e kontratës së punimeve do të parashikohet edhe plani i restaurimit të peizazhit të prekur/ndyshuar/dëmtuar.
 - b) Në zonat ku është skarifikuara bimësia dhe është prekur peizazhi, bimësia do të zëvendësohet dhe do të bëhen mbjellje me bimë të zonës, me qëllim përmirësimin dhe integrimin e peizazhit dhe elementëve pamorë.
 - c) Dheu i gërmuar dhe depozituar do të ripërdoret në mënyrë që të minimizohet ndërhyrja tek elementët pamorë.
 - d) Në zonat e kanaleve apo ku ka tombino do të aplikohen elementët peizazhistikë

me qëllim integrimin në peizazhin e zonës.

- e) Elementët e projektimit duhet të promovojnë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel pellgu ujëmbledhës, për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, e cila (qasja) kontribuon në mbrojtjen e mjedisit natyror.
- f) Roli i autoritetit përgjegjës për situatën e përmbytjeve do të promovohet vashdimisht, përfshirë edhe shpërndarjen e informacionit tek komunitetet e rrezikuara, lidhur me vetë-veprimin e tyre dhe adoptimin e pronave/ndërtesave për t'u mbrojtur nga përmbytjet.

MASAT ZBUTËSE QË DUHET TË MERREN PËR MBROJTJEN E MJEDISIT.

(referuar Deklaratës Mjedisore të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit)

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të Projekt-planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme:

- Masat e propozuara dhe aktivitetet e parashikuara në PMRRP të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri në parandalimin dhe reduktimin e riskut ndaj përmbytjeve;
- Gjatë planifikimit të projekteve duhet t'i jepet përparësi rindërtimit të infrastrukturave ekzistuese para ndërtimeve të reja;
- Në kuadër të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmbytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve të tokës nga përmbytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësisë autoktone që i rezistojnë edhe përmbytjeve);
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore që gjenden në territoret ku do të zbatohet ky plan;
- Projektet që do të shfrytëzojnë burimet ujore nuk duhet të çenojnë statusin ekologjik të rrjedhave ujore apo nuk mund të zhvillojnë aktivitete që reduktojnë zonat e mbajtjes së ujit dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës;
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmanget në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral;
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me AKZM-në për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave;
- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve apo planeve specifike individuale të Planit, duhet të përfshihen masa që do të mundësojnë ruajtjen e korridoreve të

- kafshëve migratore, sidomos në rastin kur projektet që do të zbatohen mund të prekin zona të mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre;
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar "best practices". Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nën mbrojtje;
 - Plani duhet të nxisë realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjerë duke e shtrirë këtë masë edhe në aktivitete të tjera industriale që krijojnë shkarkime ujërash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukturë bashkëkohore dhe afatgjatë e kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane;
 - Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore;
 - Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standardet e ruajtjes së peizazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësisë së mjedisit, të jenë parësore duke aplikuar "best practices";
 - Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse të propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis;
 - Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjisllacionit mjedisor në fuqi;
 - Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj;
 - Nëse pasojat në mjedis dhe shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëherë ministria merr masat e duhura për shmangien/minimizimin e ndikimeve negative ose të vlerësohet edhe ndryshimi i PMRRP me qëllim që të përmbushen standartet mjedisore;
 - Nëse Autoriteti Përgjegjës për zbatimin e planit vlerëson se gjatë zbatimit të tij, mund të ketë mundësi reale për të ndikuar negativisht në mjedisin e shteteve fqinje apo ka të dhëna për ndikime konkrete dhe pasoja në mjedis për atë shtet, atëherë të njoftojë menjëherë Ministrinë përgjegjëse për mjedisin, që të nisin procesin dhe konsultimin me palën e prekur nga ky plan dhe të ndërpresë zbatimin e tij deri në përfundim të konsultimeve ndërkufitare;
 - Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjisllacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore dhe nënligjore;

Shtojca F

Hartat e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet në zonën e Shkodrës

Hartat e detajuara mund të gjenden këtu:

<http://kadastrajore.gov.al/>